# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| Numri rendor | Data e regjistrimit te kerkesave | Objekti | Data e kthimit te pergjigjes | Statusi i kerkeses | Tarifa ne leke |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 23.02.2017 | Arsyeja e ketij e-maili eshte kerkesa jone kundrejt jush,per te na ndihmuar me nje database lidhur me pjesen me te madhe te hoteleve ne Shqiperi.<br>Ne do te zhvillojme Panairin Nderkombetar te Mobilerise 2017 ,per te 14-in vit i cili do te zgjas 4 dite dhe do te marrin pjese mobileri nga vendi dhe jashte tij.<br>Qellimi jone,pervec te tjerash,eshte te ftojme dhe nje pjese te madhe te Hoteleve nga vendi ,te cilat mund te kene nevoj per informacione,rimobilime,rikonstruksione te ambjenteve te tyre. | Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës). | Perfunduar | Nuk ka |
| 2. | 23.02.2017 | Kerkese nr.2738 prot, date 23.02.2017 ku kerkohet informacion mbi sherbimet dytesore, konkretisht mbi aktivitetin ekonomik mbi te gjitha subjektet e regjistruara prane QKB-se | 28.02.2017<br>Qendra Kombëtare e Biznesit është njohur me shkresën tuaj, protokolluar me tonën me nr.2738 prot., datë 23.02.2017, në të cilën kërkoni informacion për të gjithë subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju sqarojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br><br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br>Gjithashtu, lutem specifikimin e kerkeses tuaj (objektin ne te cilen behet kjo kerkese), pasi nuk mund te gjenerohet e gjithe databaza e Regjitrit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Tregtar.<br><br>Pergjigja ju eshte kthyer dhe ne menyre zyrtare. | | |
| 3 | 1.03.2017 | Ne lidhje me kerkesen e dates 23.02.2017, ashtu edhe sic eshte e shenuar ne kerkese, neve na duhen kodi ekonomik NVE i te gjithe subjekteve te regjistruara ne QKB. Pra kerkojme numrin e NIPT dhe kodin NVE te aktivitetit te subjektit per te gjithe subjektet.<br><br>Pagesen per kete sherbim do e bejme nga jashte SHqiperie, dhe ju lutem me dergoni te dhenat (IBAN) te QKB-se ku mund te kryej pagesen per kete sherbim. | 07.03.2017<br><br>Në vijim të komunikimit lidhur me kërkesën për lëshimin e informacionit që disponohet nga QKB referuar kodit të nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE për të gjithë subjektet e regjistruara në Regjistrin Tregtar, ju sqarojmë se:<br><br>Mbështetur në pikën 8 të VKM nr. 863, datë 21.10.2015 "Për krijimin e Bazës të të dhënave Shtetërore të Qendrës Kombëtare të Biznesit, Regjistri Tregtar", Qendra Kombëtare e Biznesit është administratori i vetëm i Regjistrit Tregtar dhe përgjegjëse e drejtpërdrejtë për strukturën e bazës të të dhënave, anën funksionale dhe operacionale.<br><br>Gjithashtu, referuar pikës 9 të këtij vendimi, Qendra Kombëtare e Biznesit përfaqëson autoritetin e vetëm, i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimit në bazën e të dhënave elektronike të Regjistrit Tregtar.<br><br>Konformë parashikimeve të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave me propozim të ministrit që mbulon çështjet e ekonomisë.<br><br>Lista e shërbimeve të tjera funksionale ( dytësore) është ajo që i'u është vënë në dispozicion. Kërkesa juaj lidhur me këto shërbime duhet të specifikohet në përputhje me shërbimet e ofruara. Nëse kërkohet " Raport mbi aktivitetin ekonomik (objektin e aktivitetit) të subjekteve të regjistruara në QKB" (shërbimi nr.7) atëherë duhet të përcaktohet lloji i veprimtarisë konkrete për të cilën kërkohet ky informacion.<br><br>Vetëm pas këtij përcaktimi do t'ju bëhet e mundur menjëherë raporti i kërkuar | Perfunduar | Nuk ka |
| 4 | 23.02.2017 | Për arsye mësimore kam bërë një studim të faqes së internetit të Qëndrës Kombëtare të Biznesit dhe kam gjetur mangësi në përputhje me ligjin nr 119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Programin e Transparencës. Bashkangjitur këtij emaili është ankesa dhe kopja e kartës time të identitetit. | 01.03.2017<br>Përshëndetje,<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit tashme ka implementuar faqen zyrtare te re (www.qkb.gov.al) Portali i ri i QKB-së përmbledh dhe shkrin funksionalitetet ekzistuese të portalit të QKL dhe QKR.<br><br>Bejmë me dije se, faqja e re është në përditësim e sipër me informacionet e nevojshme të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e saj.<br><br>Duke ju falenderuar për interesin e shfaqur dhe përcjelljen e shqetësimit tuaj, lutemi mirëkuptimin lidhur me këtë problematikë e cila do të zgjidhet | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | në një kohë mjaft të shkurtër. | | |
| 5 | 20.03.2017 | Jam nje shoqeri aksionare. Kam aplikuar per nje licence dhe eshte aprovuar por statuti i saj eshte Ne pritje te pageses. Mund te me thoni cfare pagese duhet bere , ku ta dergoj konfirmimin sa me shpejt te jete e mundur. | 20.03.2017<br>Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet që mund t'u shkaktojnë palëve të treta, duhet që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të kërkesës për pajisjen me licencë, të paraqesin dokumentin përkatës( police sigurimi per kapacitete depozituese) në QKB. Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së këtij dokumenti në QKB. | Perfunduar | Nuk ka |
| 6 | 20.03.2017 | Kam nje servis autoveturash (mekanik) jam per son fizik cfar duhet te bej qe te rregjistrohem nga qkr ne qkb | 20.03.2017<br>Kalimi nga QKR ne QKB eshte bere automatikisht nga sistemi ne momentin e krijimit te QKB. Nese ju nevojitet extract I ri mjafton te paraqiteni prane sporteleve tona.<br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 7 | 21.03.2017 | Ju shkruaj nga Bashkia Tropoje ne lidhje me nje VKM Nr.970 date b2.12.2015 " Per procedurat e e dhenies licensave per tregtim naftes..." desha te dije sa i perket licensave te tregtimit me pakice qe eshte kopetence e pushteit vendore sa eshte afati i ketyre licensave pasi qe nuk ka nje percaktim mbi afatet ne VKM. | 21.03.2017<br><br>Nga QKB-ja , trajtohen vetem licencat per: Tregtim me shumice i naftes,gazit ,nenprodukteve perfshire dhe ato bio si dhe lendet djegese, Kategoria VIII.1.A.<br><br>Per licencat e tregtimit me pakice, referojuni legjislacionit perkates .<br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 8 | 30.03.2017 | Pershendetje,<br>Prane shoqerise permbaruese eshte regjistruar parktika permbarimore, me pale kreditore dhe pale debitore P.F.<br>Kane nisur procedurat për titullin ekzekutiv "Vendim Gjobe 26 datë 28/04/2015" per te cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit datë 18/04/2016 nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tiranë".<br>Per palen debitore nuk disponojme gjeneralitete (atesi, datelindje).<br>Per vijimesine e procedurave permbarimore në mbështetje dhe ne zbatim të Ligjit nr. 10031, date 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", neni 31/b, kerkojme nga ana juaj te na vendosni ne dispozicion informacion te sakte per gjeneralitetet (atesi, datelindje, numer personal ID) per debitorin P.F.<br><br>Faleminderit per bashkepunimin! | 30.03.2017<br><br>Ne pergjigje te email-it tuaj, Ju bëjmë me dije se, në bazë të nenit 61 të ligjit Nr.9723/ 2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas ligjit, regjistron në regjistrin tregtar dhe publikon të dhënat në faqen zyrtare të internetit www.qkb.gov.al, lehtësisht të aksesueshme, ku mund të gjeni informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për çdo subjekt në kohë reale.<br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 31.03.2017 | Dear Madam or Sir,<br><br>Could somebody help me urgently,<br><br>many thanks and kind regards | Dear Sir,<br><br>Thank you for your request.<br>Could you please specify in details , what kind of activity you would like to open in Albania.<br><br>In attach we are sending you, all the criteria you must fulfill to registrate an activity in Albania according to the Law.nr.9723 date 03.05.2007, as per following:<br><br>1. Branches and representative offices of foreign companies.( attachment 6)<br><br>2. Initial Registration partner with foreign Legal Person. ( attachment 7)<br>SH.P.K + JSC.<br><br>Please do not hesitate to contact us for any questions or need of clarification.<br>Best regards | Perfunduar | Nuk ka |
| 10 | 04.04.2017 | Pershendetje, po kerkoj nje model statuti per shpk, megjithese kem te vitit 2014, dhe mendoj se mund te kete ndryshime sepse athere ka qene QKR dhe tani edhte QKB . | 04.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me kerkesen tuaj, ju bej me dije si me poshte:<br>Statut tip gjeni ne faqen tone te internetit<br>http://www.qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-biznesit/statute-tip/<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 11 | 04.04.2017 | Kam pasur nje lokal nga tetori 2012 deri ne janar 2013, pastaj e kam mbyllur, por e kam statusin aktiv akoma, kam bere dhe mbylljen ne QKB ne ate kohe, por nuk kam ber pagesat pran bashkise, qeveria nxori nje ligj qe fal detyrimet, un perfshihem ne kete skem? Faleminderit, kalofshi mire! | 04.04.2017<br>Pershendetje,<br>Nese ju ne momentin e kerkeses per cregjistrim rezultoni debitor ndaj organeve vendore dhe atyre tatimore aplikimi per cregjistrim refuzohet. Per sa i takon perfitimit nga ligji i faljes duhet ti drejtoheni organeve kompetente per te verifikuar nese perfitoni dhe ne cfare mase perfitoni nga ky ligj.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 12 | 10.04.2017 | Pershendetje,<br><br>Une qe po ju shkruaj jam nje qytetar qe studioj,jetoj dhe punoj ne Gjermani. Se pari dua tju pergezoj juve dhe Qeverine per lehtesirat qe ju keni krijuar qytetareve ne lidhje me sherbimet qe atyre ju nevojiten per Bizneset e tyre.Fale dixhitalizimit nepermjet te cilit qytetaret mund te kene akses ne disa sherbime , shkrirjes se QKR-QKl si dhe shume te tjera lehtesira. Por sic e thote dhe Kryeministri "ka nevoje dhe per shume permiresime" | 13.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me shqetësimin e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon:<br><br>Nga verifikimi i kryer në Regjistrin tregtar rezulton se për subjektin juaj, person fizik ka kryer aplikimin me datën 26/07/2016.<br>Pas shqyrtimit, me datën 27/07/2016 aplikimi është kthyer i paplotë (pezulluar) me arsyen që prokura nuk është depozituar e plotë.<br>Në kushtet kur aplikanti nuk ka plotësuar të metat që pengonin miratimin e aplikimit (nuk është paraqitur e plotë prokura), Qendra Kombëtare e Biznesit me datë 05/09/2016, në bazë të nenit 57 të Ligjit 9723 datë 03/05/2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar ka vendosur | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Arsyeja qe po ju shkruaj eshte : Ne Korrik te vitit 2016 isha ne shqiperi per pushime dhe u paraqita ne zyren e QKB ne Korce per te pezulluar Aktivitetin e vellait tim. Pasi i paraqita punonjeses se sportelit te gjitha Dokumentat qe me kerkoi per pezullimin e Aktivitetit si (ID karte, Prokure ,Pagese..etj) te cilat ajo i skanoi, me dha Dokumentin Konfirmimit te Pezullimit te Aktivitetit me vulen e Institucionit qe thote i PEZULLUAR. Nje kopje me tha qe duhet ta dorezoja ne Komunen perkatese Libonik ku dhe e dorezova.<br><br>Nga kjo dite Aktiviteti i vellait tuaj eshte i pezulluar dhe nuk keni pse vini me ketu, munnd te largoheni i qete ne Gjermani me tha ajo duke me dhene Dokumentin Konfirmimit te Pezullimit te Aktivitetit . Por ne Mars te Vitit 2017 paraqitemi prane zyrave te QKB-se dhe me rezulton qe subjekti im nuk eshte pezulluar.<br>Faleminderit, | refuzimin e aplikimit me arsyen:<br><br>Çeshtja refuzohet bazuar ne Ligjin Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, neni 57, subjekti nuk ka plotesuar brenda afatit ligjor 21 ditor, elementet qe pengojne regjistrimin, konkretisht: Te depozitohet e plote prokura.<br><br>Sqarojmë që vërtetimi të cilit ju i referoheni, i cili është lëshuar në momentin e aplikimit nga punonjësi i sportelit, vërteton vetëm kryerjen e aplikimit nga ana e juaj dhe jo miratimin e tij.<br>Bazuar në nenin 54 të Ligjit 9723 datë 03/05/2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar çdo aplikim kalon në fazën e shqyrtimit.<br><br>Faleminderit, | | |
| 13 | 11.04.2017 | Pershendetje, Kam nevoje per nje informacion ne lidhje me rregullat dhe ligjet e regjistrimit ne QKB. Pyetja ime konkretisht eshte kjo: A ka ndonje ligj apo rregull qe denon dike i cili eshte i regjistruar per nje lloj aktiviteti ne QKB dhe kryen nje lloj tjeter aktiviteti? Pyetja e dyte : A eshte e ndaluar luajtja online e lojrave te fatit? | 12.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ligji detyron subjektet tregtare te regjistrojne prene QKB te gjitha aktivitetet qe kryejne si dhe vendet ku I kryejne keto aktivitete.<br>Persa i takon pyetjes se dyte , nuk eshte nje informacion qe mund te marre pergjigje nga ky institucion. Ju sugjerojme ti drejtoheni organeve kompetente<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 14 | 11.04.2017 | Ju lutem,Kemi aplikuar per emrin tregtar per sa dite marrim njoftim? | 11.04.2017<br>Pershendetje ,<br>Pergjigjet per aplikimet merren Brenda 24 oreve nga momenti i aplikimit. Kjo pergjigje mund te shihet on line ne www.qkb.gov.al ose prane cdo sporteli te QKB.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 15 | 12.04.2017 | Pershendetje, si mund te dorezojme online bilancin e kompanise. Apo dorezohet vetem dorazi.<br>Faleminderit, | 12.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Kompanite me ortake shqiptare e bejne aplikimin per dorezimin e bilancit vetem on-line. Per te kryer kete aplikim duhet te keni nje llogari ne site e-albania.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 13.04.2017 | Pershendetje, doja te pyesja per tregtimin e lendeve drusore, qymyr dhe pelete duhet te paisem me leje dhe nese po kujt ministrie i takon dhe cfare procedure ka. Faleminderit paraprakisht. | 13.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne rastin e tregtimit te lendes drrusore , pellet dhe qymyr nuk eshte e nevojshme pajisja me licence apo leje te vecante.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 17 | 18.04.2017 | Pershendetje!<br><br>Ju lutem nuk e di nese me informoni<br><br>Kam bere nje aplikim per shtyrje afati ne dt 12/04/2017 por shoh ne sistem nuk eshte bere ndryshimi | 18.2017<br>Pershendetje,<br>Aplikimi juaj eshte kthyer ne status "I Paplote". Aplikanti , Kejdi Xhemollari eshte sqaruar paraprakisht nga sportelisti per mosperpuethshmeruine e datave ne vendim ku shprehet shtyrja e afatit per 5 vjet por ne dat rezulton 4 vjet.<br>Ju lutem sillni sa me shpejt vendimin me datat e korigjuara per te mundesuar vazhdimin e procedurave.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 18 | 18.04.2017 | kam bere kerkese per crecistrim 2 here,ne 2016 dhe 25 janar 2017 . Ne statusin e "Shiko licensat aktive" dal si bisnes qe nuk kam licence,ne ekstraktin historik dal ende si "Aktiv". ju luetm kam likujduar te gjitha detyrimet dhe ne Drejtorine e tatim taksave dal me zero detyrime . nuk e kuptoj pse dal akoma aktiv tek ju ? pres pergjigje. Faleminderit. | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Pas verifikimeve te bera ne Regjistrin Tregtar rezulton se aplikimi juaj per crregjistrim eshte refuzuar. Aresyet e refuzimit I gjeni ne file bashkengjitur.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 19 | 19.04.2017 | Pershendetje,<br>ne kuader te nje studimi tregu qe po kryer per efekt te studimeve te doktoratures ne te drejten tregtare (prane Universitetit Europian te Tiranes), ju lutem mund te mundesoheni informacioni si me poshte:<br>- numri total i bizneseve te regjistruara ne qytetin e Gjirokastres<br>- nje ndarje ne perqindje ose numer sipas llojit te aktivitetit te tyre.<br><br>Mbetem me shprese se kerkesa ime do te merret ne konsiderate.<br><br>Faleminderit, | 20.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.<br><br>Bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br>Faleminderit, | | |
| 20 | 20.04.2017 | Per efeket dokumentacioni subjektesh shendetesore, ju lutem kam nevoje per nje info te thjeshte ne lidhje me licencen QKL,kjo licence a eshte e barasvlefshme me licencen pas krijimit te QKB-se? | 20.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nga viti 2016 QKL dhe QKR jane shendruar ne QKB dhe ligji per krijimin e QKB thote se te gjitha aktet e leshuar nga QKL dhe QKR para bashkimit do te jene ste vlefshme deri ne daten e vlefshmerise se tyre. | Perfunduar | Nuk ka |
| 21 | 20.04.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem mund te me ndihmoni me dicka. Kur ishte faqja e vjeter e QKB kishit nje vend ne faqe ne te cilen shikoje dhe gjeje te gjitha aplikimet qe ishin bere ne nje date te caktuar : aplikimet e reja , ndryshimet e mundshme si dhe mbylljet qe beheshin nga subjekte te ndryshime. Me kete faqen e re nuk po orientohem dot. Egziston me kjo pjese?Si mund ta gjeje?<br>Faleminderit | 21.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me problemin e raportuar ju njoftojme qe aktualisht ne momentin kur klikoni mbi linkun www.qkb.gov.al ju shfaqet imazhi, si ne dokumentin e bashkengjitur. Nese klikoni mbi “Buletini i Regjistrimeve” do te mund te merrni informacionin e kerkuar.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 22 | 21.04.2017 | Pershendetje, Per te kontrolluar licensat aktive, eshte sistemi i azhornuar apo duhet te drejtohemi me shkrese zyrtare. Ju faleminderit | 21.04.2017<br>Licencat active mund ti kontrolloni ne kohe reale ne www.qkb.gov.al<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 23 | 21.04.2017 | Pershendetje, Per te ndryshuar emrin tregtar per nje subjekt (person fizik) cfare dokumentash duhet te sjell ne QKB, dhe a mund te behet pa ardhur vete administratori aty? Faleminderit | 24.04.2017<br>Pershendetje,<br>Per te bere ndryshimin e Emrit Tregtar te nje subjekti (Person Fizik) mjafton te paraqiteni prane sporteleve te QKB me nje dokument identifikimi (ID ose pasaporte). Nese titullari I NIPT-it e ka te pamundur te aplikoje vete ai mundet te autorizoje dike tjeter me Prokure per te aplikuar.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 24 | 21.04.2017 | Pershendetje,<br>Jam nje studente nga fakulteti i ekonomise dhe po realizoj si teme diplome: Tregu i Sigurimeve ne Shqiperi. Po ju shkruaj se me nevojiten bilancet fitim-humbje, per secilen prej kompanive nga viti 2006-2016 dhe shoh se nuk jane te gjitha, si mund ti aksesoj keto te dhena???<br><br>Faleminderit. | 11.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me email e derguar ju njoftojne qe QKB nuk mund t'ju ndihmoje me kerkesen tuaj pasi ne disponojme vetem bilancet e shoqerive, duke mos bere ndarjen e tyre ne fitim-humbje. Ne lidhje me te dhenat e kerkuara mund ti drejtoheni Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve pasi ato mund te disponojne nje informacion te tille.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 25 | 22.04.2017 | Pershendetje!<br>Po ju dergojme dokumentacionin e vitit 2016<br>Pune te mbare | 24.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Bilanci dhe Pasqyrat financiare te subjekteve tregtare shqiptare dorezohen on-line nga subjekti dhe jo me email.<br>Subjekti duhet ti ngarkoje on-line ne portalin e e-Albania. | Perfunduar | Nuk ka |
| 26 | 23.04.2017 | Pershendetje Ju lutem me dergoni formularet qe duhet te plotsoj per krijimin e nje biznesi. 1- akti themelimit 2- statuesi 3-rrehjistrimi | 24.04.2017<br>Pershendetje ,<br>Statuti dhe Akti Themelimit jane akte qe krijohen nga vete subjektet tregtare.<br>Statute Tip gjeni ne faqen tone te internetit www.qkb.gov.al<br>Per sa i takon Formularit te Aplikimit ai plotesohet nga sportelisti I QKB ne momentin e aplikimit.<br><br>Me respect | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 27 | 23.04.2017 | Pershendetje! Jam nje. Me duhen disa te dhena per disa biznese te caktuara per qellime studimi. Si mund te perfitoj informacion per studimin ... | 25.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.<br><br>Bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 28 | 24.04.2017 | Pershendetje, Po tentoj te aksesoj ne qkr per ekstrakt me nipt , por nuk me jep asnje rezultat. Faleminderit. Pune te mbare. | 26.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me problemin e raportuar, lutem na specifikoni numrin e NIPT-it dhe vendin ku po kryeni kerkimin ne web.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 29 | 25.04.2017 | Pershendetje,<br><br>Do te doja nje database ne exel file te kopmanive te biznesit qe operojn ene territorin Shqipetar. A mund te di nese mund te me ndihmoi me nje kopje me email apo nje menyre per ti bere download ne websiten tuaj?<br><br>Ju Faleminderit! | 25.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br><br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br><br>Gjithashtu, lutem specifikimin e kerkeses tuaj (objektin ne te cilen behet kjo kerkese), pasi nuk mund te gjenerohet e gjithe databaza e Regjitrit Tregtar.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 30 | 26.04.2017 | Kerkoj te hap faqen zyrtare per Demetyrimet per t"u paguar dhe nuk me hapet Nr i Licenses time.<br>Faleminderit. | 26.04.2017<br>Pershendetje.<br>QKB nuk ka informacion mbi detyrimet e subjekteve. Ju lutem kontaktoni Drejtorinr r tatimeve dhe portalin e-Albania.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 31 | 26.04.2017 | Pershendetje!<br>Identifikimi per sherbimin e ngarkimit on-line te pasqyrave financiare<br>eshte i pamundur.<br>Me sqaroni si ta realizoj pasi une shenova Nipti-in dhe Paswordin dhe<br>nuk arrij te identifikohem<br><br>faleminderit! | 26.04.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lutem ti drejtoheni institucionit pergjegjes qe miremban portalin www-e-albania.al, pasi QKB nuk mund t'ju jape te dhenat per akesimin e portalit e-albania apo te kontrolloje per problematika te mundshme mbi llogarite e biznesit/individit ne kete portal.<br>Bashkelidhur po ju dergoj manualin per resetimin e passwordit.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 32 | 27.04.2017 | Pershendetje . A eshet e pranueshme qe nje drejtues didaktik te drejtoje dhe nej qender tjeter per kurse te formimimit profesional? Lutemi na ktheni pergjigje | 27.04.2017<br>Pershendetje,<br>Licenca e "Formimit Profesional " nuk parashikohen qe drejtuesi didaktik te punoje me kohe te plote. Per kete aresye Drejtuesi Didaktik mund te punoje ne me shume se ne nje qender.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 33 | 28.04.2017 | Dua te rregjistroj nje adrese te re per aktivitet sekondar ne Peze e Vogel ,si dhe te mbyll nje adrese zyre qe nuk e disponoj më. Ju lutem me informoni per dokumentet qe duhet te paraqis prane QKB. Faleminderit | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nese subjekti juaj eshte person fizik mjafton te paraqiteni me karten e identitetit ne sportelet e QKB dhe te beni aplikimin. Nese subjekti eshte "SH.P.K" atehere duhet qe administraatori I kompanise te beje nje kerkese me shkrim drejtuar QKB per hapjen e adreses ( apo mbylljen e adreses).<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 34 | 29.04.2017 | Përshëndetje,të hapet një biznes i vogël nga një student ka suportim nga QKB? Faleminderit! | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br>QKB suporton ne menyre te njejte te gjithe aplikantet qe paraqiten prane sporteleve per te aplikuar.<br>Aplikimet prane sporteleve te QKB kryhen lehtesisht duke u paraqitur me nje karte identiteti.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 35 | 29.04.2017 | Përshëndetje jam i imteresuar të vetëpunësohem si bojaxhi çfar veprimesh duhet të bëj dhe a më duhet kasa fiskale? Faleminderit. | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br>Per te punuar si i vetepunesuar ju duhet teaplikoni e te pajiseni me NIPT. Per sa I takon faktit nese ju duhet ose jo kasa fiskale per kete duhet te pyesni organet taimore.<br><br>Me respekt , | Perfunduar | Nuk ka |
| 36 | 02.05.2017 | Ne cilesine e subjektit permbarimore qe ka si qellim ekzekutimin e titujve ekzekutive, per shkak te detyres kerkoj akses ne kerkimin e te dhenave te subjekteve me adrese ne Shkoder | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lutem dergimin e NIPT-it te subjektit tuaj ne menyre qe tju ndihmojme.<br>Ne lidhje me publikimet mbi zyrat permabrimore mund ti gjeni ne linkun http://www.qkb.gov.al/shpallje/njoftime-nga-zyra-permbarimore/.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 37 | 02.05.2017 | Pershendetje a mund te vendoset adresa e shtepise si seli ne qrk, pasi veprimtaria eshte ambulant per sherbime dhe qarkullon me makine nuk ka nje vend stabel Faleminderit | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br>Po, adresa e shtepise mund te perdoret si adrese selie.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 38 | 02.05.2017 | Isha i interesuar per informacion rreth Prodhimit te Lengut te Cigareve Elektronike. A eshte ky aktivitet subjekt i ndonje license te vecante? Ne qofte se po me orientoni ju lutem se kush nga licencat eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti. Faleminderit! | 02.05.2017<br>Pershendetje,<br>Tregtimi I duhanit dhe I nenprodukteve te tij nuk eshte nje licence qe jepet nga QKB. Duke qene se ky product I nenshtrohet pageses se aksizes duhet ti drejtoheni Ministrise se Financave per me shume informacion.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 39 | 03.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam nje shtetas i huaj qe kam nje bisnes ne Hungari, nderkohe qe dua te hap nje filial ne Shqiperi. Cfare procedurash duhet te ndjek? Faleminderit! | 11.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Te gjitha informacionet e nevojshme mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshem per hapjen e nje biznesi ne Shqiper I gjeni lehtesisht duke vizituar faqen tone web : www.qkb.gov.al<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 40 | 03.05.2017 | Pershdendetje!<br>Une ju shkruaj nga zyra tregtare e ambasades amerikane. Kam nje kompani amerikane qe eshte e interesuar per nje list me 15-20 kompanite me te medha call center. Ne mungese te plote te databazave te kompanive sipas profilit, do ta vleresoja nese do te mund te me benit me dije nese ju mund te na ndihmoni me nje liste te tille.<br>Ne pritje te pergjigjes nga na juaj. | 03.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 41 | 03.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Uroj te jeni sa me mire!<br><br>Ju lutem nese keni mundesi mund te me informoni, se per te kaluar ne rregjistrin pasiv duhet bere nje kerkese apo me vendim asambleje?<br><br>Ju falenderoj, | 03.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Per te kaluar nje subject ne status "Pezulluar" mjafton qe administrator (apo nje person I autorizuar prej tij) te paraqese ne sportelet e QKB nje kerkese te firmosur dhe vulosur nga administrator.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 42 | 04.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Tentoj te dergoj bilancin online dhe me del nje ceshtje e hapur . Ju lutem me beni te mundur aksesin per te derguar bilancin online.<br>Faleminderit | 05.05.2017<br>Pershendetje,<br>Ju lutem na dergoni NIPT-in per te pare nese keni ceshtje te hapur dhe pse. Sistemi nuk lejon qe subjektet te hapin nje ceshtje te dyte pa mbyllurr ato qe jane te hapura.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 43 | 04.05.2017 | Pershendetje,si mund te me ndihmoni me dispozitat ligjore dhe dokumentat qe me duhen peer te hapur nje biznes?lloji i biznesit "dyqan pike shitje servis telefonash tabletash kompjuterash. Faleminderit. | 11.05.2017<br>Pershendetje ,<br>Te gjitha informacionet mbi menyren dhe procedurat per regjistrimin e nje biznesi i gjeni ne faqen tone web : www.qkb.gov.al<br><br>Me respekt, | Perfunduar | Nuk ka |
| 44 | 04.05.2017 | Pershendetje, Ne rradhe te pare pergezime per punen e mire qe keni bere me faqen e re te QKB. Pyetja ime ishte si mund te vendos ne fushen e kerkimit te Aksionerit apo te Emrit Tregetar nje emer qe permban karaktere te vecanta si "ç", "ë" apo "." etj. Me nxjerr mesazh "Vlera e dhene ka karaktere te palejueshme". Nderkohe ne fushen Emri i subjektit i pranon keto karaktere. Do me ndihmonit shume nese me jepnin nje pergjgje. Faleminderit dhe pune te mbare . | 24.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me problemin e raportuar ne kerkimin ne webiste, perkatesisht nen “Kerko per subjekt”, ju njoftojme qe aktualisht eshte mundesuar kerkimi me karakteret speciale si ‘ë’ dhe ‘ç’.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 45 | 05.05.2017 | Tek aplikimi per QKL ,tek vetdeklarimi duhet te shkruajme nr e leternjoftimit apo nr personal (me dy shkronja anash) | 08.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne aplikime nese ju kerkohet numri I kartes se identitetit ju duhet te shkruani numrin personal ( ne fund te kartes, djathtas )<br><br>Me respek. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 46 | 07.05.2017 | Te nderuar ,<br>Jam nje aksioner me kuota te uleta ne nje kompani, pas ndarjeve te saj nuk jam njoftuar dhe nuk e di asgje per statusin e pronesise.<br><br>Ju lutem me udhezoni ku te gjej ne cilen pjese jam pronar si aksioner i ligjshem me letra bono privatizimi para shume viteve.<br>Kini miresine te me dergoni nje pergjigje<br>Me respect. | 08.05.2017<br>Pershendetje,<br>Te gjitha informacionet mbi ndryshimet ne shoqerite tregtare I gjeni ne extraktin historik te subjektit te cilin mund ta gjeni ne faqen tone on line www.qkb.gov.al<br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 47 | 07.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Si mund te kerkoj subjektin ne regjistrin tregtare?<br><br>Faleminderit, | 08.05.2017<br>Pershendetje ,<br>Te gjitha informacionet per subjektet tregtare i gjeni ne faqen www.qkb.gov.al<br>Per te kkerkuar per NIPT ndiqni : http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 48 | 07.05.2017 | Pershendetje Do te doja te dija cfare procedure duhet te ndjek ne rastin e nje personi fizik i ciki ka kaluar nga biznes i vogel ne biznes te madh per shkak te xhiros. Nuk e kam te qarte si duhet te hartoj statutin per te ndryshuar te dhenat nga person fizik ne juridik. Ju lutem nese eshte e mundur te me sqaroni cfare duhet bere? Pune te mbare! | 09.05.2017<br>Përshëndetje,<br><br>Lidhur me pyetjen tuaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:<br><br>Pergjegjësia tatimore nuk lidhet me formën ligjore të subjektit, dmth një subjekt person fizik mund të jetë subjekt i tatim fitimit (biznes i madh) ose subjekt i tatimit të thjeshtuar (biznes i vogël). Kategorizimi nga ana e organeve tatimore për përgjegjësinë tatimore të subjektit si biznes i madh ose i vogël bëhet në bazë të xhiros vjetore të subjektit.<br><br>Nuk kërkohet ndryshimi i formës ligjore për shkak të ndryshimit të përgjegjësisë tatimore.<br><br>Sqarojmë se, nuk mund të bëhet “shndrrimi” i personit fizik në juridik. Nëse individi dëshiron të ushtrojë aktivitetin në person juridik (shpk, sha, ose në format e tjera), duhët të aplikojë për regjistrim fillestar sipas kërkesave të ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 49 | 08.05.2017 | Prsh, ju lutem kam aplikuar per regjistrimin e nje biznesi te ri dhe sjoh qe eshte e pranuar, aplikimi eshte bere me 03.05.2017. Doja te dija se kur del NIPT zakonisht. FLM | 08.05.2017<br>Pershendetje.<br>Pergjigja e aplikimit del jo me vone se 20 ore nga momenti qe eshte kryer ky aplikim.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 50 | 08.05.2017 | Pershendetje zonje/zoteri,<br>Jam i interesuar te di: per zhvendosje biznesi BV (ndryshim adrese), me duhet te aplikoj te zyrat tuaja? Nese Po, cfare dokumentash duhet te sjell.<br>Ju faleminderit!<br>Gjithe te mirat<br>Armand | 09.05.2017<br>Pershendetje,<br>Nese subjekti eshte "Person Fizik" mjafton te paraqitet prane sporteleve te QKB titullari I NIPT (ose dikush I autorizuar prej tij me prokure) e te aplikoje per ndryshim adrese, nese subjekti eshte "Person Juridik" dhe ndryshon vetendin e ushtrimit te aktivitetit ( adresen kryesore) duhet te paraqitet prane sporteleve te QKB administrator (apo dikush I autorizuar me shkrese prej tij) dhe te depozitoje Vendimin e Ortakeve per ndryshimin e adreses.<br><br>Per cdo paqartesi mos hezitoni te na kontaktoni.<br><br>Me respect, | Perfunduar | Nuk ka |
| 51 | 08.05.2017 | Pershendetje, Kemi hapur nje aktivitet "Pastrim Kimik", ka nevoje te pajisemi me licence nga QKL? Faleminderit, | 09.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Aktiviteti "Pastrim Kimik " nuk eshte aktivitet I cili ka nevoje te pajiset me Licence sipas Ligjit 10081 date 23.02.2009.<br>Ky aktivitet duhet te aplikoje prane zyrave te QKB per pajisjen me "Leje Mjedisore te Tipit C ". Bashkengjitur gjeni dokumentat e nevojshme.<br><br>Per cdo paqartesi mos hezitoni te na kontaktoni<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 52 | 09.05.2017 | Pershendetje,<br>Ju kontaktojme nga nje Subjekt ne Tirane ,I rregjistruar me dy adresa active prane qkb.<br><br>Se fundmi jemi pajisur me nje mjet transporti mallrash , tip furgon.<br><br>Deshiroja te dija se cfare dokumentash duhet te paraqisim per rregjistrimin e mjetit si adrese NIPT.<br><br>-Kerkese nga Administratori<br>-Kontrate Shitje ku thuhet targa e m jetit<br><br>Mbetem ne pritje, | 09.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Per te regjistruar adresen dytesore ju duhet te paraqitni kerkesen me shkrim te administratorit. Kerkesa mund te paraqitet nga vete administrator ose nga nje person i autorizuar prej tij.<br>Aplikanti duhet te kete me vete dhe karten e identitetit.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 53 | 09.05.2017 | Pershendetje,<br>ne vitin 2008 kam pas regjistruar biznesin tim ne Tirane, si qender interneti me vendim gjykate nen emrin tim dhe pas 3 muajsh mu desh ta shisja biznesin si rrjedhoje e te ardhurave te pa mjaftueshme... Edhe un si shume te tjere qe ska pas dijeni ne menyren se si funksionojne procedurat e detyrimeve | 09.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Per te cregjistruar nje subject ne QKB duhet te paraqiteni ne sportelet e QKB per te bere nje aplikim per cregjistrim. Paraprakisht duhet te siguroheni qe detyrimet tuaja ndaj organeve tatimore (qendrore dhe vendore ) te jene te shlyera.<br>Per sa I takon ligjit te faljeve, per te pare se sa ky ligj do te aplikohet ne rastin tuaj, duhet ti drejtoheni organeve tatimore. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | financiare, nuk kam bere asnje hap apo kerkese per ta mbyllur si regjistrim dhe per cudi detyrimet kane ecur edhe pse duhet te ishte verifikuar biznesi a egziston apo jo!!<br>Me keto faljet e fundit qe jene bere, a perfitoj ndonje gje? Nese po, si te veproj qe te fshij emrin tim ne listen qe shfaqet si biznes ne faqen e qkb.gov.al ?<br><br>Faleminderit me rrespekt,<br>Kreshnik Pacara | Me respekt | | |
| 54 | 09.05.2017 | Pershendetje, ju kam kontaktuar para ca ditesh me email, te lutem cfar lloj dokumentash me duhen per ndertim nje hotel afer rinasit, un e kam token time me letra vec dua te dij cfar procedure duet te mar per licensimin me ndertu dhe te hap biznes. te lutem me kontaktoni | 10.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit nuk ka informacion mbi dokumentacionet e nevojshme per te bere ndertime. Per me shume drejtohuni institucioneve pergjegjese.<br><br>Per sa I takon hapjes se biznesit ju mund te gjeni informacionin e nevojshem ne faqen tone zyrtare : www.qkb.gov.al<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 55 | 09.05.2017 | Pershendetje<br><br>Ju uroj nje dite te mbare.<br><br>Jam studente doktorature ne programin polis shqiperi -ferrara Italy dhe per momentin punoj si kerkuese prane fakultetit te urbanistikes dhe banesave ne Rotterdam.<br><br>Jam duke mbyllur temen time te doktoratures qe ka lidhje me zhvillimin e mobilimit brenda banesave neper vite dhe neper zona te ndryshme te Shqiperi dhe kam nevoj per mbeshtetjen e insitucionit tuaj per te ndertuar nje harte digitale per shqiperine .<br><br>Sipas studimit hipoteza ime qendron tek lidhja qe kane zhvillimet e prodhuesve shqiptar te vegjel mesem te medhenj ne shqiperi per te cilen kam nevoj per nje informacion te kompanive shqiptare qe jane legale me nipte mund te jene edhe | 10.05.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit është njohur me kerkesen Tuaj, në të cilën kërkoni informacion për të gjithë subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju sqarojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | person individ fizik, keshtu un mund te ndertoj harten te dicitalizuar te vendosdhjes se tyre neper shqiperi pra info ne file exceli un e vizatoj ne sisteme e perkthej ne nje ne hartem e shqiperise.<br><br>Nqse institucioni juaj ka interes per kete harte mund tua siguroj edh ejuve ta keni sapo ta kem mbaruar tezen brenda nentorit te 2017 . Pasi ajo do ndertohet me shume pergjegjesi dhe profesionalizm .<br><br>Do e vleresoja shume mbeshtetjen tuaj nqse me dergoni informacionit:<br><br>emri kompanie , addresat (qytet mjafton) , dhe lloji i veprimtarise ( prodhues mobiljes, shites akseosresh, fason qepje tekstili etj etj ) | arsyeja e kryerjes së pagesës).<br><br>Gjithashtu, lutem specifikimin e kerkeses tuaj (objektin ne te cilen behet kjo kerkese), pasi nuk mund te gjenerohet e gjithe databaza e Regjitrit Tregtar.<br><br>Faleminderit, | | |
| 56 | 08.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Po ju shkruaj, sepse doja te merrja informacion ne lidhje me informacionet e publikuara nga qendra kombetare e biznesit.<br><br>Jam studente ne Universitetin e Tiranes, Fakulteti i Ekonomise, Master Shkencor Kontabilitet dhe ne kuader te nje studimi qe dua te kryej per pergatitjen e temes se diplomes me nevojiten te dhena te viteve te fundit nga Pasqyrat Fianciare te kompanive te ndryshme. Kerkova ne Ekstaktin historik te kompanive jane te publikuara pasqyrat e viteve 2008-2009.<br><br>Doja te dija si mund te marr informacion te perditesuar lidhur me Pasqyrat e kompanive meqe jeni i vetmi burim publik i ketij informacioni.<br><br>Faleminderit! | 09.05.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 57 | 10.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Po ju shkruaj ne emer te kompanise pasi jemi te interesuar per shtimin e nje adrese sekondare( nje adrese te dyte pervec kesaj ekzistueses) persa i perkete vendit te kryerjes se veprimtarise. Do doja te dija se cilat jane dokumentat e nevojshme per kete ndryshim dhe dhe si funksionon si proces? Tjetra qe doja te dija eshte qe gjithashtu duam te ndryshojme dhe shtojme drejtuesit teknik per kategorine e farave dhe pesticideve, cilat jane dokumentat e nevojshme ne kete rast dhe si funksionon si proces?<br><br>Dite te mbare, | 10.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Per te shtuar adrese dytesore , Administratori I kompanise (ose nje person i autorizuar prej tij) paraqesin nje kerkese me shkrim per shtimin e adreses dytesore. Aplikanti duhet te kete me vete dhe nje document identifikimi.<br><br>Per sa I takon ndryshimin e Drejtuesit teknik duhet qe Administratori i kompanise (ose nje person i autorizuar prej tij) te aplikoje per ndryshim prane sporteleve te QKB. Aplikanti duhet et kete me vete dokumentin e identifikimit dhe te paraqese prane QKB dokumentat lidhur me Drejtuesin teknik (Diplomen dhe kontraten e punes)<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 58 | 10.05.2017 | Pershendetje, Ne interes te disa ceshtjeve qe kemi ne shqyrtim me nevojiten te dhenat (ekstraktet) e disa shoqerive. Pas kriptimit qe i keni bere sistemit e kam te pamundur te aksesoj ekstraktet. Ju lutem mund te me orientoni se si mund te aksesoj elektronikisht ekstraktet? | 11.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj mbi aksesimin e ekstraktit te nje subjekti, lutem te shkoni ne menune “Kerko” dhe te ndiqni hapat si ne imazhin bashkelidhur.Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 59 | 11.05.2017 | Pershendetje, doja te merrja nje Ektrakt te thjesht per kompanin ku punoj sepse ma kerkuan ne ambasaden italiane, te lutem mund te me njoftoni se cilat jane procedurat per te terhequr nje dokument te tille. Faleminderit | 11.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Per te terhequr Extraktin e nje subjekti mjafton te paraqiteni prane cdo sporteli QKB I pajisur me karte identiteti. Beni pagesen prej 100 lekesh dhe terhiqni extraktin. Me respect | Perfunduar | Nuk ka |
| 60 | 15.05.2017 | Pershendetje, doja te dija rreth kapitalit themeltar te Sh.p.k ka qene jo me pak se 100.000 Leke , por kam lexuar diku qe eshte bere jo me pak se 100 leke ? nje konfirmim ju lutem ? | 16.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Bazuar nr Ligjin 9901 date 14.04.2008 Neni 70, ju konfirmojme se :<br><br>"Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar nuk mund te kene nje kapital me te vogel se 100 leke."<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 61 | 15.05.2017 | Pershendetje, Jam i interesuar per te shtuar nje sherbim te ri ne licencen ekzistuese. Per proceduren duhet te jete prezent patjeter atministratori apo mund te behet me nje autorim? | 16.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nese subjekti eshte "Person juridik " personi I autorizuar paraqitet prane sporteleve te QKB I pajisur me karten e identitetit dhe nje autorizim me firmen dhe vulen e administratorit te kompanise.<br><br>Nese subjekti eshte "Person Fizik" atehere personi I autorizuar paraqitet prane sporteleve te QKB I pajisur me karten e identitetit dhe Prokure per te kryer aplikimet prane sporteleve te QKB.<br><br>Me respect, | Perfunduar | Nuk ka |
| 62 | 15.05.2017 | Jemi nje OJF e regjistruar ne gjykate dhe duam te aplikojme per NIPT. Donim te dinim paraprakisht cfare dokumentash duhet te dorezohen dhe ku? | 16.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>OJF nuk marrin NIPT ne QKB por ne Drejtorine e Tatimeve. Per me shume informacion mbi dokuymentacionin e nevojshem ju sugjerojme te kontaktoni istitucionin e siperpermendur..Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 63 | 16.05.2017 | Pershendetje! Nga PF (person fizik) ne Shpk egziston mundesia te kthehet biznesi? Faleminderit | 17.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nje NIPT I hapur si "Person Fizik" nuk mund te tjetersohet, pra nuk munt te kalohet nje shoqeri nga "Person Fizik " ne SH.P.K<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 64 | 17.05.2017 | Pershendetje QKB!<br><br>Duke ju uruar pune te mbare doja te dija ne lidhje me mundesine e te marrit kontaktet telefonike te disa bizeseve qe jane te regjistruar ne QKB.Ju lutem me thoni si duhet te veproj?<br><br>Falemnderit | 18.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj ju njoftoj qe ne faqen e web www.qkb.gov.al ne menune “ Kerko” mund te kerkoni duke plotesuar nje nga fushat dhe te merrni informacionin e kerkuar. Perkatesisht si ne imazhin me poshte:<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 65 | 17.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam nje subjekt i regjistruar prane QKB, icili deshiron te kryej aplikimin per Leje IV.4.A - "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare", duke iu bazuar faqes online per kriteret e aplikimit, ndermjet dokumentave te kerkuara specifikohet Çertifikatë për Drejtuesin Teknik leshuar nga MEI (METE), por nuk specifikohet nese duhet fotokopje (noterizuar ose jo) apo origjinal per tu verifikuar nga ana juaj.<br><br>Duke ju falenderuar per mirekuptimin, mbetemi ne pritje te pergjigjes tuaj.<br><br>Gjithe te mirat, | 18.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Bashkengjitur gjeni nje kopje te listes me dokumentat e nevojshme per licencimin ne kategorine IV.4.A. Ne fund te kesaj liste gjeni te shkruar<br><br>"Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Këto dokumenta skanohen dhe ju kthehen kur mbaroni aplikimin " . Dhe ne rastin e certifikates se Drejtuesit teknik vlen fakti qe mund ta sillni origjinal ose fotokopje e noterizuar. Gjithsesi dhe ky document nuk do te mbahet nga sporteli, vetem do te skanohet e do t'ju rikthehet menjehere.<br><br>Me respect | Perfunduar | Nuk ka |
| 66 | 18.05.2017 | Pershendetje! kam nje pyetje, a mund te marre nje vertetim nga QKB per nderrimin e emrit te nje biznesi? per shembull eagle mobile eshte tashme albtelecom, a mund te me vertetoni me vertetim ndryshimin e emertimit te nje biznesi? ju faleminderit | 18.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Te gjitha ndryshimet qe kryejne subjektet tregtare duhet detyrimisht ti pasqyrojne ne extraktin historic te subjektit. Per te patur informacionin e nevojshem ju mjafton te kontrolloni extraktin historic te subjektit ne faqen tone te internetit www.qkb.gov.al Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 67 | 19.05.2017 | Mirëdita,<br><br>Po ju shkruaj këtë email sepse dëshiroja të më jepnit disa informazione për regjistrimin e personave fisik.<br>-Në qoftë se një person fisik punon si bashkëpuntor i jashtëm i shoqërisë tonë dhe ne e paguajmë mbi basën e faturës që na bën për shërbimin e kryer, duhet të jetë i regjistruar ne QKR dhe të ketë nr personal të identifikimit për te deklaruar të ardhurat?<br>- Taksat që një puntor i ketij tipi(dmth jo i varur me kontratë pune por i vetëpunësuar) paguan mbi të ardhurat që fiton në vit janë vetëm sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe përqindja mbi të ardhurat sipas ligjit shqiptar? Apo egsistojnë taksa të tjera të detyrueshme që ne nuk i njohim?<br>Ju falenderoj dhe uroi punë të mbarë | 19.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Per sa I takon regjistrimit ne QKB personat qe gjenerojne te ardhura dhe leshojne fatura kane detyrim ligjor te jene te regjistruar ne QKB , te pajisen me NIPT.<br><br>Per sa I takon te dhenave te tjera duhet ti drejtoheni Drejtorise se Tatimeve pasi eshte ai institucioni qe mund t'ju informoje.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 68 | 23.05.2017 | Persshendetje! Jam nje biznes i vogel. Kam kerkuar tek Tatimet te behet ndryshimi i statusit nga "I vetepunesuar (i vetem)" ne "I vetepunesuar me punemarres". Per kete ndryshim a duhet te paraitem edhe prane sporteleve te QKR-se, te bej azhornimin? Apo nuk eshte e nevojshme? Faleminderit! | 23.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Nuk eshte e nevojshme te paraqiteni ne QKB per kete ndryshim<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 69 | 23.05.2017 | Kemi aplikuar per ndryshim objekti te veprimtarise duke paraqitur vendimin e ortakeve dhe brenda tij edhe autorizimin perkates per kryerjen e procedurave prane jush. Na eshte refuzuar me pretendimin se autorizimi per aplikantin duhetnte jete ne perputhje ne nenin 72 te Kodit Civil. Me duket i padrejte pasi edhe here tjeter me kete lloj autorizimi eshte aplikuar. Lutem me sqaroni pasi me duhet ekstrati shume shpejt. Faleminderit | 25.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nga verifikimi i kryer rezulton se aplikimi i kryer per subjektin tuaj figuron te jete miratuar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 70 | 23.05.2017 | Përshëndetje,<br><br>Jam një Inxhinier Informatik, duke punuar një temë diplome master në lidhje me tregtinë elektronike.<br>Nga kërkimi në faqen web të institucionit tuaj nuk arrita të gjej informacion apo të dhëna rreth ndërmarrjeve që aplikojnë (përdorin ose ofrojnë) specifikisht tregtinë elektronike në Shqipëri.<br>Dispononi të dhëna në lidhje me këtë tematikë?<br><br>Duke ju falenderuar paraprakisht, | 26.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.<br><br>Bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 71 | 25.05.2017 | Pershendetje,<br><br>1- Nese rregjistroj nje biznes te vogel, a del NIPTI me emer tregtar qe dua ta quaj, apo me emer personal?<br><br>2- Nese pergjigjja eshte me emer personal, a mund te rregjistrohem SHPK biznes i vogel? Pasi xhiro nuk kalon si fillim 2 milion leke te reja? Dhe ne kete rast mund te dali me emer tregtar?<br><br>Faleminderit, | 25.05.2017<br>Peshendetje,<br><br>Regjistrimi si "Person Fizik " ben qe NIPT te lidhet ngushtesisht me emrin e personit. Subjekti ka te drejte te kete dhe Emer Tregtar i cili mund te jete i njejte ose i ndryshem nga emir i lidhur me NIPT-in.<br><br>SHPK mund te jene biznes i madh ose i vogel. Ndryshimi vjen nga xhiro vjetore e aktivitetit. NIPT nuk eshte i lidhur detyrimisht me emrin e personit, pra mund te dale vetem me Emer Tregtar<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 72 | 25.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Uroj qe ky email tju gjeje mire.<br>Interesohem te di cfare procedure dhe dokumentash me duhen per te hapur nje aktivitet si shpk per perpunim ushqimi.<br>Po ne rast se e hap biznesin si person fizik cfare dokumentash me nevojiten?<br>Nevojitet licenca e kuzhines per te hapur Nipt-in, mund te me ndihmoni me nje orientim?<br><br>Ju falenderoj paraprakisht per pergjigjen. | 25.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Bashkengjitur gjeni dokumentat qe ju duhen per te hapur nje NIPT si "Person Fizik" dhe si sh.p.k.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 73 | 25.05.2017 | Pershendetje<br>Dua te hap nje nr nipti per biznes on line sepse po hap nje dyqan online dua te di sa jan taksat faleminderit | 26.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>QKB nuk ka informacion mbi tarifat e lidhura me taksat e tatimet.<br>Per te pastur nje pergjigje per pyetjen tuaj duhet ti drejtoheni organeve pergjegjese , ne rastin konkret Drejtorise se Tatimeve.<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 74 | 25.05.2017 | Pershendetje,<br><br>Kemi nje kompani te regjistruan ne qkr dhe deshirojme qe te shtojme departamente per<br>kete nipt qe operojne me vete me emrat dhe aktivitetet e tyre. Pra jo thjesht te regjistrohen si emra tregtare.<br>A realizohet kjo forme, a regjistrohet dhe si duhet te aplikoj m ecafre dokumentash?<br><br>Faleminderit. | 30.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojme se, referuar nenit 43 te ligjit 9723 “Per regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse lidhur me vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.<br><br>Nese, jemi ne rastin e nenit te sipercituar, subjekti mund te aplikoje per depozitimin e akteve perkatese ne perputhje me ligjin, prane çdo sporteli sherbimi te QKB-se.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 75 | 26.05.2017 | Pershendetje!Jam i interesuar te di si te kontrolloj ecurine e rregjistrimit sipas nr ceshtjes sic ka qene para dhjetorit2016.flm | 26.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lutem te kryeni kontrollin sipas aplikantit apo numrit te ceshtjes sipas formatit CN-******-**-**, sic eshte shkruar ne formularin e aplikimit, perkatesisht nen linkun http://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-statusin-e-aplikimit-te-subjektit/..<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 76 | 26.05.2017 | Ju lutem kam nje mbyllje aktiviteti shpk.kam filluar proceduren e likuidimit tek ju. Jam ne momentin qe me duhet te dorezoj nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne momentin e hapjes se likuidimit dhe njoftimin e pare te kreditoreve.Ju lutem do te hapet ceshtje tek ju per dorezimin apo do tu dergohen me poste.Ju faleminderit per ndihmesen dhe mirkuptimin tuaj | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Aplikimi per dorezimin e bilancit te celjes se likujdimit behet prane sporteleve te QKB.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 77 | 26.05.2017 | Pershendetje<br><br>Duke ju uruar dite te mbare doja te pyesja per :<br>Deklarimi ne QKB per audituesit e pasqyrave financiare per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar a eshte e detyrueshme me ligj<br>(psh pasqyrat financiare te vitit 2016 per shoqerine Elka Sha jane audituar nga X ekspert kontabel )<br>dhe nese po sa eshte denimi i mosdeklarimit te ketij informacioni ?<br><br>Ne pritje te pergjigjes tuaj<br>Faleminderit | 02.06.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se:<br><br>Neni 32 i ligjit 9723 "Per regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar citon: "Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:<br>a) emri;<br>b) forma;<br>c) data e themelimit;<br>ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;<br>d) selia;<br>dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;<br>e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;<br>ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.<br>f) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve."<br><br>Neni 35 percakton te dhenat shtese per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, konkretisht: "Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32, të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo." | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nderkohe ne nenin 43 citohen te dhenat e tjera te detyrueshme:<br>“1.Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III.<br>2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit, statutit ose ndryshimit të kontratës së shoqërisë së thjeshtë (kur është në formë të shkruar), depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, që pasqyron ndryshimet e mëpasshme. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë së huaj apo dokumenti ekuivalent i krijimit, sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë, që pasqyron ndryshimet e bëra.<br>3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:<br>a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;<br>b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;<br>c) emërimin e likuiduesve, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;<br>ç) aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së huaj;<br>d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;<br>dh) dokumentet, që vërtetojnë vënien e pengjeve ose garancitë e tjera për pjesëmarrjet në kapitalin e subjektit;<br>e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.<br>4. Pavarësisht nga sa më sipër, shoqëria aksionare nuk detyrohet të njoftojë çdo transferim të aksioneve. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.”<br><br>Bazuar ne sa me siper, nese e dhena qe ju kerkoni te regjistroni parashikohet ne nenet e sipercituara, eshte e detyrueshme per tu regjistruar.<br><br>Faleminderit | | |
| 78 | 26.05.2017 | Pershendetje, Mund te me dergoni listen e te gjithe subjekteve aktive qe kane per Objekt te Aktivitetit: Ruajtjen e objekteve publike dhe private? Faleminderit, | 30.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana Juaj, ju informojmë si më poshtë:<br><br>Qendra Kombetare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacionit të administruar dhe disponuar në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse, ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës.<br><br>Bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br><br>Faleminderit, | | |
| 79 | 27.05.2017 | Përshëndetje, Doja të merrja një informacion për hapat dhe dokumentacionin për të marrë liçencë për Qender kursesh Faleminderit | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Bashkengjitur gjeni dokumentat e nevojshme qe duhet tet paraqisni per tu pajisur me licence " Formim Profesional "<br><br>Diite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 80 | 29.05.2017 | Pershendetje, ju lutem si mundet te shkarkoje direkt ekstraktine QKB nga web-i juaj? Nje pergjigje sa me e shpejte do te vleresohej. FLM | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Ju mund te shkarkoni extraktin duke hyre ne faqen http://www.qkb.gov.al me pas http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/<br>Vendosni NIPT dhe me pas poshte ne te djathte keni mundesine te shkarkoni xtrakt te thjeshte ose historic.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 81 | 29.05.2017 | Pershendetje!<br><br>Jam nje shoqate Ojf nga qyteti i lezhes dhe dua te licensohem per kurse formimi profesional per elektrecist dhe hidraulik.<br>Cfare dokumentash me duhen dhe a mund ta bej aplikimin ne qkb?<br>Ju faleminderit.<br>Pune te mbare | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Per tu pajisur me licencen "Formim professional" ju duhet te aplikoni prane sporteleve te QKB. Dokumentat qe ju nevojiten i gjeni bashkengjitur.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 82 | 29.05.2017 | Kerkoj depozitimin e bilancitt te Komfort Shpk . Jam financierja | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Depozitimi I bilanceve per subjektet me administrator shqiptar behet duke u loguar me llogarine e subjektit ne portalin e e-Albania.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 83 | 29.05.2017 | Pershendetje, ju lutem si mundet te shkarkoje direkt ekstraktine QKB nga web-i juaj? Nje pergjigje sa me e shpejte do te vleresohej. FLM | 30.05.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Ju mund te shkarkoni extraktin duke hyre ne faqen www.qkb.gov.alme pas http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/<br>Vendosni NIPT dhe me pas poshte ne te djathte keni mundesine te shkarkoni xtrakt te thjeshte ose historic.<br><br>Dite te mbare | Perfunduar | Nuk ka |
| 84 | 30.05.2017 | Pershendetje, ku mund ta shikoj nje ceshtje a eshteb aprovuar apo jo se me kete faqen e re nuk e gjej dot apo duhet vetm te paraqitem ne sportele? | 30.05.2017<br>Pershendetje,<br><br>Nese keni aplikuar per tu pajisur me NIPT klikoni mbi ikonen “Kerko si subjekt”, si me poshte:<br><br>Nese doni te shikoni statusin e aplikimit per pajisjen me leje/licence kerkoni ne linkun http://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/kerko-per-statusin-e-aplikimit-per-licence-leje/<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 85 | 31.05.2017 | Pershendetje . Dua te krijoj sh.p.k ne lidhje me Ndertim IMP-EXP . Zyren do e kem ne qytetin e Peqinit . Regjistrimin dhe procedurat duhet ti ndjek tek QKR ne Elbasan ? Dhe ju lutem cfare dokumentacioni me duhet per Regjistrimin Fillestar ? | 02.06.2017<br>Pershendetje ,<br><br>Aplikimin mund ta kryeni ne cdo sportel te QKB panvaresisht vendodhjes se aktivitetit.<br><br>Dokumentat e nevojshme i gjeni ne file bashkengjitur ketij email.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 86 | 31.05.2017 | Pershendetje, Doja nje informacion ne lidhje me hapje te niptit si person fizik(i vetepunesuar,pa punojes te tjere) 1-sa jane detyrimet vjetore taksa bashkiake 2-sigurimet shoqerore shendetsore 3-a ka nje periudhe kohore per tr cilen jam e detyruar ta mbaj niptin hapur,apo mund te mbyllet ne cdo moment nga momenti i hapjes Ne pritje te nje pergjigje tuaj, Faleminderit! | 02.06.2017<br>Pershendetje ,<br><br>QKB nuk eshte institucion qe ndjek detyrimet e subjekteve tregtare. Per kete informacion duhet ti drejtoheni institucione kompetente (Bashkise dhe Drejtorise se Tatim Taksave )<br><br>Me respekt | Perfunduar | Nuk ka |
| 87 | 05.06.2017 | Pershendetje,<br><br>ju shkruaj per tu informuar rreth procedures per rritje kapitali te nje ndermarrje.<br>Eshte e vertete qe legjislacioni parashikon taksimin e ketij kapitali prej 15%<br>Ju lutem a mund te me thoni se ku mbeshtet ky ligj? Ne cilin VKM?<br><br>Ju falenderoj. | 05.06.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ju bej me dije se, referuar nenit 22, te ligjit 9723, date 03.05.2007, "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, subjektet qe detyrohen te regjistrohen ne regjistrin tregtar jane:<br><br>Subjektet tregtare;<br>Shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;<br>Personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;<br>Zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;<br>Shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;<br>Shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;<br>Çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së<br>Referuar nenit 3/f te ligjit 131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", QKB informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit.<br><br>Sqarojme se,QKB nuk mund t ju informoje rreth procedurave te zmadhimit te kapitalit te nje ndermarje, pasi ndermarjet nuk bejne pjese ne kategorine e subjekteve te cilat regjstrohen ne Regjistrin Tregtare.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 88 | 05.06.2017 | Përshëndetje,<br><br>Shpresoj e uroj të jeni mirë!<br><br>Mund të na informoni rreth hapjes së një biznesi nga jorezident, qytetar i R. së Maqedonisë?!<br><br>• 50,000-100,000€ qarkullim në vit;<br>• Export pa TVSH në R. e Maqedonisë, produkte shëndeti e bukurie (nga distrib. LR Health & Beauty Albania, Tiranë);<br>• Sektori i shërbimit, adresë virtuale<br><br>Poqese duhet të dhëna tjera, na informoni!<br><br>Ju falënderit për kohën e konsideratën!<br><br>Gjithë të mirat, | 07.06.2017<br>Pershendetje,<br><br>Personat fizikë regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas ligjit 9723, Date 03.05.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar .<br><br>Referuar nenit 30 te ligjit 9723, date: 03.05.2007 " Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme këto të dhëna:<br><br>a) të dhënat e identifikimit;<br>b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë;<br>c) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;<br>ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik<br><br>Aplikimi për regjistrim fillestar (person fizik), kryhet nëpërmjet plotësimit të një formulari aplikimi pranë c do sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 89 | 05.06.2017 | Pershendetje, kam aplikuar per nipt me date 02.06.2017<br>Paraqitur nga Arnis kerbizi person fizik me numer ceshteje<br>CN-316027-06-17. A ka dal nipti? | 07.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se kerkesa juaj per nipt eshtemiratuar. Ju mund te paraqiteni prane QKB-se per te terhequr certifikaten e regjistrimit. Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 90 | 05.06.2017 | Pershendtje<br><br>Ne dt,01.06.2017 kemi bere nje aplikim per ndryshime adresash sekondare me numer CN-308978-05-17 por ende ceshtja eshte ne proces.Keto adresa sekondare na nevojiten sa me shpejt sepse po na pengojne ne mbarvajtjen e punes per kete arsye na duhet nje pergjigje per ceshtjen. | 07.06.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se aplikimi me numer CN-308978-05-17 eshte miratuar. Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 91 | 06.06.2017 | Ju lutem me informoni lidhur me problemin e regjistrimit te subjektit ROYALL GENERAL TRADING shpk, si me poshte !Subjekti i sipercituar eshte regjistruar prane QKB, me numer NIPT L71712012J, date 12.05.2017. Ne vijim kemi tentuar te logohemi ne sistemin e tatimeve dhe nuk kemi arritur. Per kete arsye, ne date 22.05.2017, u paraqitem prane DRT,tek 21 Dhjetori, per t'u pajisur me passwordin e subjektit, ku na informuan se subjekti RGT shpk nuk figuron aktiv ne sistemin e tyre, pasi QKB-ja nuk ka komunikuar aplikimin e subjektit ne fjale. nga verifikimet prane DRT, ne sistemin e tyre rezutonte qe QKB-ja i ka komunikuar DRT aplikimet e subjekteve te tjera me numra fundore te NIPT-eve ….011 dhe….013, por jo aplikimin e subjektit tone,RGTshpk, me numrat fundore 012 (NIPT L71712012J). jemi informuar se ky mund te jete nje problem i komunikimit dhe dergimit te te dhenave midis institucioneve.Ne keto kushte, ju lutemi te na ndihmoni per te zgjidhur situaten e krijuar dhe te na informoni sa me shpejt.Faleminderit, | 08.06.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me problematiken per subjektin Royal General Trading, nga ana e QKB ju informojme se cdo gje eshte zgjidhur.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 92 | 06.06.2017 | Pershendetje Per zmadhimin e kapitalit cfare dokumentash duhen ? Eshte detyrim raporti i ekspertit kontabel apo mund ta beje dhe nje kontabel i miratuar? | 08.06.2017<br>Bashkelidhur po ju dergojme pergjigjen e pyetjes suaj.<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 93 | 06.06.2017 | Pershendetje<br>Ju lutem te na sqaroni per CN-316180-06-17 per subjektin Aurora Konstruksion K02017003I sepse ne sistem eshte bosh arsyeja e ceshtjes<br>Faleminderit | 08.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se aplikimi me numer ceshtje CN-316180-06-17, eshte miratuar.<br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 94 | 06.06.2017 | Kerkoj ekstarakt te shoqerise Krasniqi me nipt K326274018M. | 08.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se, mund te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se per teheqjen e ekstraktit kundrejte pageses perkatese nese I deshironi me vule te njome. Kopje ekstrakti mund te terhiqni ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 95 | 07.06.2017 | Pershendetje...bera nje aplikim per biznes te ri dje dhe (CN-320551-06-17) sot me derguan pezullim per aplikim" por pa arsyetim...kuadratet bosh...cfare duhet te bej? | 08.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se, aplikimi me numer ceshtje CN-320551-06-17, eshte miratuar. Verifikimin mund ta kryeni ne faqen www.qkb.gov.al | Perfunduar | Nuk ka |
| 96 | 07.06.2017 | Pershendetje,<br><br>Ne date 06.06.2017 kam kryer aplikimin me nr CN-320095-06-17 per subjektin 23OPTION shpk, me NIPT L62025015J.Nga verifikimi ne faqen e QKB, statusi i aplikimit, rezulton akoma “In Process Registrar”, edhe pas kalimit te afatit 24 ore. ju lutem, me informoni rreth këtij aplikimi | 08.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se aplikimi I kryer me numer ceshtje CN-320095-06-17, rezulton i miratuar me date 07.06.2017.<br>Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 97 | 08.06.2017 | Dua te shikoj ekstratin historik te shoqerise metal resouces company | 10.06.2017<br>Pershendetje, ju mund te shikoni ekstraktin e shoqerise suaj ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 98 | 08.06.2017 | Pershendetje, ne momentin qe hap nje nipt, me duhet te rregjostrohem per menaxher futbolli, cfare detyrimesh kam te tatimet dhe te bashkia? Ju flm | 10.06.2017<br>Lutemi te drejtoheni drejt organeve tatimore, me qellim informimin tuaj sa me sakte. | Perfunduar | Nuk ka |
| 99 | 08.06.2017 | Pershendetje ,<br><br>Bashkelidhur do te gjeni formularin e ankeses se shoqerise GALA shpk ne lidhje me aplikimin per regjistrim te dhenash ne regjistrin tregatre me nr. CN-292390-05-17 date 18/05/2017 . | 10.06.2017<br><br>Pershendetje,Nga verifikimi i kryer ne Regjistrin Tregtar, në subjektin “GERMAN ALBANIAN LOGISTICS AGENCY”, me NUIS L11423506M, është kryer aplikimi nga z.Julian Kapllanaj me numër çeshtje CN-292390-05-17, datë: 18.05.2017. Në këtë aplikim janë paraqitur për depozitim aktet e mëposhtme: 1. DeklaratëNoteriale,2. Autorizimi,datë18.05.2017,3. Formulari i aplikimit, 4.Mandati i kryerjes së aplikimit. Nëpunësi i autorizuar, pas marrjes në shqyrtim të aplikimi ka vendosur miratimin e aplikimit.Sqarojmë se, aplikimi me numër çështje CN-292390-05-17, në subjektin “GERMAN ALBANIAN LOGISTICS AGENCY”, me NUIS L11423506M është pasqyruar në bazë të akteve të depozituara. | Perfunduar | Nuk ka |
| 100 | 09.06.2017 | Kërkesë për info perkompanitë Greke dhe Greko-Shqiptare me aktivitet në Shqipëri .Lutemi të na dërgoni një listë me të dhënat(emërtimi, aktiviteti, NIPT, tel,email, adresë) të 521 shoqërive aktive greke dhe greko – shqiptare të regjistruara deri në fund të vitit 2016, si per shoqëritë greke dhe greko – shqiptare per 2017 e sot. | 10.06.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme informoacionin e kerkuar.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 101 | 10.06.2017 | Dua te depozitoj nje vendim por nuk po mundem. Ju lutem me ndihmon. | 12.06.2017<br>Pershendetje, per depozitimin e vendimit mund te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 102 | 10.06.2017 | Pershendetje.<br>jam,studente ne Fakultetin e Ekonomise, Universiteti i Tiranes, Master i Shkencave ne Kontabilitet dhe Auditim. Aktualisht po punoj temen e diplomes e cila eshte " E drejta e Perdorimit te Lojtareve". Ne studim kam marre disa skuadra te huaja dhe per rastin e Shqiperise kam marre klubin e Skenderbeut dhe Partizanit. Ne mungese te informacionit ne faqen zyrtare te klubeve vendosa tju shkruaj ju ne email. Ju lutem brenda mundesise se plotesimit te kerkeses time, dhe gjithmone brenda parimit te konfidencialiteti,duke ju siguruar qe te dhenat do te perdoren vetem per realizimin e nje punimi diplome, mund te me jepni informacion lidhur me pasqyrat financiare qe kane dorezuar klubet?<br><br>Ne pritje te nje pergjigjeje pozitive nga ana ju.<br><br>Gjithe te mirat. | 14.06.2017<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br><br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse. | Perfunduar | Nuk ka |
| 103 | 11.06.2017 | Si mund ta nxjer ekstraktin historik K81616019N.Faleminderit | 14.06.2017<br>Pershendetje,<br>Ju bejme me dije se per te terhequr ekstrakt historic mund te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se ose mund te aplikoni online nepermjet portalit zyrtar e-albania.<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 104 | 11.06.2017 | Lutemi na njoftoni dhe na shpjegoni si te veprojme sepse sipas jush ceshtja cn-305398-05-17 (sqarimi juaj) eshte pasqyruar dorezimi i bilancit 2016 ne fakt nuk eshte pasqyruar ne ekstrat e subjektit Mobileri Halili H .Lutemi | 14.06.2017<br>Verifikimin e pasqyrave fianciare te depozituara mund ta beni ne faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 105 | 11.06.2017 | Pershendetje Nese eshte e mundur do te doja te me ndihmonit me raportin e auditit te subjektit ALBtelecom | 14.06.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Raportet e audimit apo pasyqrat financiare te cdo subjekti jane te reflektuara ne ekstraktin e tij.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 106 | 12.06.2017 | Ju lutem me dergoni licencen e subjektit MPI | 15.06.2017<br>Pershendetje,<br><br>Ju mund te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se per tu pajisur me titullin e license nese jeni personi i autorizuar nga perfaqsuesi. | Perfunduar | Nuk ka |
| 107 | 12.06.2017 | Kerkoj ekstratin historik te subjektit "metal resources company" me nr nipti k82205014f | 14.06.2017<br>Pershendetje,<br>Ju informojme se ekstraktin historic te shoqerise qe kerkoni mund ta terhiqni prane sporteleve tona ose mund te aplikoni online ose nese iu duhet pa vule te njome mund ta gjeni ne faqen tone zyrtare www.qkb.gov.al<br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 108 | 12.06.2017 | Pershendetje.<br><br>Jam nje specialist ne Gjykaten e Larte.Per efekt te procedures se zhvillimit te nje tenderi me duhen emrat e 5 subjekteve te cilat kane mare lishence per riciklim te mbetjeve te pajisjeve elektronike.Emrat e tyre me duhen per tu derguar ftese per ofert<br><br>Do me beni shume pune nese do me ndihmoni me emrat e ketyre 5 subjekteve. Duke shpresuar ne mirekuptimin dhe bashkepunimin tuaj,<br>Faleminderit | 14.06.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga kontrolli i regjistrit kombetar te lejeve/licencave/autorizimeve ,rezultojne subjekte te licencuara per aktivitetin per te cilen interesoheni( bashkelidhur tabela).<br>Nderkohe po ju dergoj listen e subjekteve qe jane pajisur me licencen me **kodin III.2.B**: Veprimtari te tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis- Grumbullim, transportim,ruajtje,riciklim, perpunim apo asgjesim te mbetjeve te llojeve te ndryshme.<br>Nese keni ndonje paqartesi mos hezitoni te na kontaktoni.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 109 | 13.06.2017 | Kam bere dorzimin e bilanceve online qe me date 31/05/2017 per subjektet Promontel me Nipt J61901508F dhe Promontel &Arbri me Nipt K51619501H per keto nuk ka ardhe miratimi. | 15.06.2017<br>Pershendetje, ju bejme me dije se pasqyrat financiare te shoqerive Promontel dhe Arbri shpk, jane miratuar.<br>Verifikimin mund ta kryeni ne faqen tone zyrtare www.qkb.gov.al | Perfunduar | Nuk ka |
| 110 | 13.06.2017 | pershendetje a eshte e mundur te behet kerkim i subjekteve sipas aktivitetit qe kryejne? faleminderit | 15.06.2017<br>Pershendetje,<br>Lidhur me pyetjen tuaj ju informojme se mund te beni kerkimin e subjekteve ne faqen tone zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 111 | 14.06.2017 | Pershendetje doja tju pyesja ne lidhje me faljen e gjobave kur hyne ne fuqi dhe si duhet te veprojme? | 15.06.2017<br>Pershendetje,<br>Lidhur me pyetjen tuaj ju informojme se nga ana e QKB-se nuk aplikohet falja e gjobave, per me shume informocion ne lidhje me faljen e gjobave lutemi te drejtoheni drejt organeve tatimore.<br>Faleminderit. | Perfunduar | Perfunduar |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 112 | 14.06.2017 | Prsh..jam nje cun me dukumenta ne itali dhe desha te informohem se a eshte e mundur per hapjen e nje firme pune ne shqipri dhe qfar taksash dhe detyrimesh ka..dhe a kam te drejt te punoj dhe ne itali dhe si funksionojne procedurat..flm | 15.06.2017<br>Pershendetje,<br>Lidhur me pyetjen tuaj per detyrimet tatimore, Lutemi te drejtoheni drejt organeve tatiomore me qellim informimin tuaj sa me sakte.<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 113 | 15.06.2017 | doja tju pyesja ne lidhje me gjobat une qe e kam paguar para dy ditesh si mund te veproj ? | 19.06.2017<br>Pershendetje,<br>Lidhur me pyetjen tuaj ju informojme se nga ana e QKB-se nuk aplikohet falja e gjobave, per me shume informocion ne lidhje me faljen e gjobave lutemi te drejtoheni drejt organeve tatimore.<br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 175 | 15.08.2017 | Pershendetje,<br><br>Kemi bere aplikimin ne date 07/08/2017 me numer ceshtje: CN-421601-08-17 dhe nga ana Juaj eshte kthyer nje pergjigje ku bejne me dije se "**a**. Kontrata e transferimit te kuotava nuk eshte e plote dhe **b**. ka kaluar afati Ligjor per regjistrimin e kontrates, dhe per kete denohesh me gjobe". Duke pare kete kalvar kaq te gjate, Ju lutem te beni menjehere regjistrimin e kalimit te kuotave, pasi aplikimi yne eshte ne konform te gjitha rregullave dhe legjislacionit ne fuqi. | 15.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojme si me poshte:Aplikimi me numer CN-421601-08-17 figuron te jete pezulluar me arsyen:1. Te depozitohet e plote kontrata e transferimit te kuota (nga pika B.2 e kontrates kalohet ne piken B.4).<br><br>2. Bazuar ne nenin 22 teLigjit Nr. 9723 "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, ka kaluar afati ligjor per regjistrimin e kontrates date 07.02.2015. Moskryerja e detyrimit per regjistrimin e saj, brenda afateve ligjore, perben kundervajtje administrative dhe denohet me gjobe, Neni 74, Ligji 9723<br><br>Per sa me siper, referuar pretendimit tuaj lidhur me kontraten e paraqitur ne aplikim, mund te deklaroni ne formularin e aplikimit qe kontrata eshte e plote dhe perbehet nga 2 faqe. Gjithashtu per piken e dyte duhet te paraqitet ne aplikim mandati i pageses se gjobes qe keni paguar.<br><br>sa me siper duhet te plotesohen prane çdo sporteli sherbimi te QKB brenda afatit ligjor 21 ditor | perfunduar | Nuk ka |
| 176 | 15.08.2017 | Ne daten 22 Qershor 2017 kam dorezuar prane zyrave Tuaja ne QKB Aplikimin per C'REGJISTRIM, dhe ne te njejten dite jam informuar qe procedura ne fjale zgjat rreth 30-35 dite.<br><br>Sot evidentoj qe Subjekti me NIPT-in e lartpermendur rezulton akoma me statusin AKTIV | 15.08.2017<br><br>Pershëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojme se, aplikimi per çregjistrim i kryer per subjektin me NUIS (NIPT) L12105023N figuron te jete miratuar dhe aktualisht subjekti figuron me status: Çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare: www.qkb.gov.al. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 177 | 15.08.2017 | Pershendetje ne dt 7.08.2017 subjekti Medicare shpk me nipt K12113004a ka aplikuar pran jush per mbyllje adrese sekondare.ceshtja eshte aprovuar por akoma nuk eshte ekspozuar ne ekstratin historik te kompanise.kjo gje na na ka penguar per procedura tw metejshme qe te paraqitemi ne DT T tirane .ju lutemi na ktheni nje pergjigje.flm | 15.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me problematiken e raportuar per pasqyrimin e ceshtjes CN-422125-08-17, ju njoftojme qe aktualisht eshte zgjidhur.<br><br>Gjithashtu u verifikuan te gjitha hapat ne lidhje me transmetimin e te dhenave drejt DPT dhe APP. Nga verifikimi rezulton se te dhenat jane transmetuar ne rregull me date 09.08.2017.<br><br>Ju kerkojme ndjese per shqetesimin e krijuar.<br><br>Bashkelidhur nje ekstrakt nga web per shoqerine "M E D I C A R . | Perfunduar | Nuk ka |
| 178 | 15.08.2017 | Sot isha ne zyren tuaj sepse nuk arrij te aksesoj dot regjistrin e licencave te leshuara per ndermjetesim punesimi dhe formim professional qe jane te publikuara ne website-in e QKB. | 15.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me informacionin e kerkuar, bashkelidhur do te gjeni ne dy file Excel materialin e kerkuar ne lidhje me licencat e llojit "Formim profesional" dhe "Ndërmjetësim në tregun e punës".<br><br>Gjithashtu kete material mund ta gjeni dhe ne likun http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ . | Perfunduar | Nuk ka |
| 179 | 18.08.2017 | pershendetje, Kam bere nje aplikim per regjistrim biznesi nga portali e-albania dhe me eshte refuzuar per arsye se ska dokumenta bashkengjitur. Une dok i kam bashkengjitur po sistemi nuk i ka marr. Ca duhet te bej? | 18.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lutem paraqitjen edhe njehere prane cdo sporteli te Qendres Kombetare te Biznesit. | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 180 | 18.08.2017 | Pershendetje, kemi bere nje aplikim me CN-425560-08-17, prej dates 11 Gusht dhe akoma nuk kemi marr pergjigje. | 18.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se aplikimi me numer CN-425560-08-17 eshte miratuar.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 181 | 21.08.2017 | Ne kete web, duhet te krijohet edhe nje rubkrike ku per cdo biznes te evidentohet fakti se ka aplikuar per pezullim, mbyllje. Pasi nuk evidentohet nese nje subjekt tregtar ka kerkuar mbylljen dhe ne cfare faze eshte ? | 21.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj, ju njoftojme qe aktualisht ne webiste e QKB eshte mundesia e kerkimit te statusit te aplikimit te subjektit, perkatesisht nen linkun http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-statusin-e-aplikimit-te-subjektit/ . Per te pare statusin e aplikimit lutem te vendosni emrin e aplikantit apo te numrit te ceshtjes qe eshte aplikuar | Perfunduar | Nuk ka |
| 182 | 21.08.2017 | Pershendetje Qendra,<br><br>Perseri dicka nuk shkon! Ne lidhje me licensat, keni akses vetem permes kerkimit te avancuar, ndersa me kerkim te thjeshte, nuk kalon me shume se 1 faqe. Pastaj me tregon dy shirita te kuq.<br><br>E dyta, kam nje pyetje. Si mund te kerkoj ne dataset, per lejet/licensat e dhena, - nga kjo date deri ne kete date? | 21.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Kerkojme ndjese pasi webiste aktualisht nuk jua mundeson kerkimin ne periudha te caktuara.<br><br>Ne rast kerkimi te nje nenkategorie te caktuar, psh “Peshkimi dhe forma të tjera të shfrytëzimit të faunës ujore të egër”, lutem kerkimin me emertimin e kerkuar dhe me pas gjenerimin e tyre duke klikuar tek “Eksporto te dhenat ne excel”, si ne imazhin me poshte: | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 183 | 21.08.2017 | Pershendetje, Per licencen per kategorine "Sherbime te tjera shendetesore e kurative" kerkohet "Çertifikatë e drejtuesit teknik (sipas specialiteteve)", ne rastin e nje studioje fizioterapie, cfare dokumenti sherben si certifikate? Ju falenderoj parapraktisht! | 21.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Persa i perket pyetjes suaj ne lidhje me çertifikaten e drejtuesit teknik: kjo çertifikate leshohet nga “Urdheri i Infermierit” me titullin “Fizioterapeut” pas aplikimit te personit te interesuar prane ketij urdheri. Ne rastin tuaj: kete certifikate mund ta kete vete administratori i studios, pra vete administratori merr persiper rolin e drejtuesit teknik, ne rast te kundert administratori emeron nje drejtues teknik me kontrate. | Perfunduar | Nuk ka |
| 184 | 22.08.2017 | CN-268921-05-17, K31616519P Fatbardh Agolli Cancellation Çregjistrim ne Pritje DPT 03.05.2017 ka kaluar gjithe afatet kohore dhe pa asnje pergjigje.ju faleminderit | 22.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se subjeki Fatbardh Agolli, me NUIS K31616519P u çregjistruar. | Perfunduar | Nuk ka |
| 185 | 22.08.2017 | Pershendetje, subjekti "Ilira Gjika" person Fizik ka bere nja aplikim per mbyllje biznesi me date 27.06.2017, me ceshtje CN-986761-10-16. Deri tani nuk ka asnje pergjigje. Ju lutem, a mund te dime se kur eshte e mundur te kemi nje pergjigje? Faleminderit Elida Maku (Pajovi) Financiere e subjektit "Ilira Gjika" - PF | 22.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se subjeki Ilira Gjika me NUIS K92404012J u çregjistruar. Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 186 | 24.08.2017 | Dear all, Since I haven’t received a response from you about the email I’ve sent before, I would like to ask if you can inform me whether you can help me with my earlier request or not | 24.08.2017<br><br>Dear Magdalena. We want to inform you that our Institution has no information on the income of the companies that are registered in here. It’s the institution of “General Directorate of Taxes” (https://www.tatime.gov.al/eng/) that can help you with this info. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 187 | 24.08.2017 | Pershendetje ,kam aplikuar ne daten 18 .08.2017 per shoqerine CENO pran zyrave tuaja ne Vlore me nr aplikimi LC-3193-08-2017 dhe akoma ska dale nje pergjigje .Ju lutem mund te jepni informacion rreth situates? Ju faleminderit! | 24.08.2017<br><br>Aplikimi juaj është refuzuar për arsyet e mëposhtme:<br><br>1)Dokumenti i pronësisë nuk i përket objektit ku ushtrohet aktiviteti. Çertifikata e pronësisë është lëshuar për llojin e pasurisë truall.<br><br>2)Projekti teknologjik i depove është paraqitur i pavulosur dhe i pafirmosur. | Perfunduar | Nuk ka |
| 188 | 28.08.2017 | Jam Mark Zefi likujdator i subjektit Alba Food Eksport shpk me NITP L48318502P.<br>Me date 16.08.2017 kam derguar Njftimin e pare per te bere shpalljen per krediroret.<br>Konfirmim mga posta me ka ardhe se shkres eshte marre nga ana e juaj. Njoftimi nuk eshte publikuar akoma. | 28.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ftesa e pare per kreditoret eshte publikuar, lutem gjeni bashkelidhur dhe printscreen nga faqja web e Qendres Kombetare te Biznesit.<br><br>Dite te mbare ! | perfunduar | Nuk ka |
| 189 | 28.08.2017 | Doaj nje informim nga ana juaj se perse nuk me eshte pranaur bilanci i subjektit Gida Oil nga ana juaj?Tek njoftimi me njoftoni qe duhet ngarkuar i plote Bilanci por nuk me saktesoni se cfare dokumentash me mungojne sepse duke ber rishqyrtim perseri nuk me rezulton t ekem len ndonj dokument mangut pa ngarkuar>>Kerkoj shpjegim nga ana juaj se perse sme keni njoftuar brenda afateve ligjore kur se pranaut Bilancin?flm | 28.08.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga verifikimi i kryer ne Regjistrin Tregtare, me date 24.07.2017, me numer aplikimi CN-396999-07-17 eshte kryer aplikimi ne subejktin “GIDA-OLI”, me NUIS L53225216N per depozitimin e pasqyrave financiare te vitit 2016. Nepunese i autorizuar pas shqyrtimit te aplikimit me date 25.07.2017 ka vendosur refuzimin e aplikimit me arsyen *“ Te ngarkohet i plote bilanci i vitit 2016”*.<br><br>Nga verifikimi i kryer rezulton se pasqyrat financiare te depozituara nuk rezultojne te jene te plota, pasi mungon pjesa hyrese e pasqyrave financiare dhe pjesa mbyllese e pasqyrave financiare e cila permban nenshkrimin e pasqyrave financiare nga perfaqesuesi i shoqerise dhe hartuesi i pasqyrave financiare (eksperti kontabel). Formati elektronik i ruajtjes së pasqyrave financiare, duhet të jetë në PDF. Per sa i perket njoftimit te refuzimit te aplikimit, ju bejme me dije se vendimarrja nga Qendra Kombetare e Biznesit eshte bere me date 25.07.2017, ne | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | perputhje me afatin ligjore te shqyrtimit te aplikimit, te parashikuar ne dispozitat e ligjit 9723, date 03.05.2007 " Per regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar. Falminderit! | | |
| 190 | 28.08.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem mund te na ndihmoni me nje liste te sherbimeve dytesore te QKB dhe tarifat perkatese.<br><br>Faleminderit, | 28.08.2017<br><br>Pershendetje, Bashkelidhur eshte lista e sherbimeve dytesore per gjenerimin e raporteve statistikore si dhe fatura e arketimit perkatese.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 191 | 30.08.2017 | Pershendetje . Jam i interesuar per te blere nje kompani . Pasi te kem blerjen me kontrate noteriale cfare hapash me duhet te ndjek per te bere ndryshimet ne QKR ? | 30.08.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Përsa i përket kalimit të pronësië, ju bëjme dije se akti për kalimin e pronësisë (kontrata) duhet të depozitohet në Regjistrin Tregatr per të pasqyruar gjëndjen e shoqëris sipas aktit të transferimit të kuotave.<br><br>Mbështetur në nenin 20, pika 1 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.<br><br>Sa më sipër, për të bërë të mundur ndryshimin e gjëndjes së shoqërisë, përfituesi i kuotes (blerësi ose administratori i shoqërisë), duhet të paraqitet pranë ç do sporteli shërbimi të QKB-së për të bërë depozitimin e akteve. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 192 | 30.08.2017 | Pershendetje,<br><br>Ne mbeshtetje te kerkeses per cregjistrim te ISIDA LOHJA, P.F. te dates 28.08.2017, po ju dergoj vertetimin e leshuar nga Bashkia Shkoder per shlyerje te taksave dhe tarifave vendore. Ju lutem, gjeni te bashkengjitur dokumentin e siperpermendur dhe vertetimin e kryerjes se aplikimit per cregjistrim prane zyres QKB Shkoder. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder me ka konfirmuar dergimin me poste ne adresen tuaj QKB Tirane, vertetimin e mungesave te detyrimeve tatimore. Shpresoj qe ne prani te ketyre dokumenteve, te lehtesohet procesi i cregjistrimit. A mund te me jepni nje kohe te perafert, brenda se ciles pritet pergjigja juaj? | 30.08.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer per subjektin ISIDA LOHJA (person fizik) është miratuar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 193 | 31.08.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam i interesuar per hapjen e nje aktiviteti 3D ( Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) por nuk e di se cfar dokumentash duhen per te mare licensen per ushtrimin e aktivitetit ne kete fushe.<br><br>Ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj.<br><br>Me respekt | 31.08.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim të kërkesës suaj, bashkëlidhur do të gjeni listën e dokumentacionit të nevojshëm për të bërë aplikimin pranë sporteleve të QKB.<br><br>Për çdo sqarim të mëtejshëm mund të paraqiteni tek zyra e informimit ose vizitoni faqen zyrtare të QKB.<br><br>www.qkb.gov.al | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 194 | 31.08.2017 | Pershendetje<br><br>Dua tju dorezoj kerkesen per informacion ne baze te "Programit te Transparence". Ne email keni formularin e kereses si attach ne formatin PDF. Kerkesa ka te beje me adresat e subjekteve qe ushtrojne si veprimtari sherbimet financiare , auditimi , konsulenca dhe fusha te tjera te lidhura me te . Gjithashtu nese eshte e mundur te kete dhe email ose nr celulari bashkengjitur emrit te subjektit , NIPT-it dhe adreses. Nese duhet mund te vij ta dorezoj kerkesen vete prane QKB. | 31.08.2017<br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 195 | 04.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme ankesn tone, shpresoj ne nje zgjidhje te problemit. | 04.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Vendimi për refuzimin e regjistrimit të pasqyrave finaciare të vitit 2015, për subjektin Dario Group wshtw marrë në datën 19.07.2016. Mbështetur në nenet 21 e 61 të ligjit "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, çdo regjistrim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur nga data e publikimit. Subjekti i sipërcituar, vlerësohet se ka marrë dijeni për refuzimin e aplikimit që më datë 19.07.2016. Në nenin 71, pika 1 e ligjit "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, është parashikuar se, çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së për regjistrimet dhe publikimet, sipas dispozitave të këtij ligji. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftimin për pranimin apo refuzimin e regjistrimit, sipas këtij ligji, ose nga data kur regjistrimi është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit. Për sa më sipër, ankesa juaj lidhur me vendimin e refuzimit për çështjet | Perfunduar | Nuk ka |

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | me numër CN-827734-07-16 është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 71 të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Faleminderit | | |
| 196 | 04.09.2017 | Kam aplikuar dy here, ne muaj maj dhe qershor te 2017 per mbylljen e biznesit i cili nuk funksionon qysh nga viti 2009. Nuk kam marre asnje lloj pergjigje. Ju lutem me ndihmoni qe ta mbyll kete proçedure. | 04.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e duhur per te kryer cregjistrimin e biznesit tuaj. | Perfunduar | Nuk ka |
| 197 | 04.09.2017 | Pershendetje ! Kam aplikuar per mbyllur licencen qe ne fillim te qershorit dhe jemi ne muajin shtator dhe licenca figuron ende aktive pasi i kam paguar te gjitha detyrimet dhe kam edhe nje procesverbal per kete nga inspektori juaj. Ka mundesi te me shpjegoj dikush kete gje? Nipti im eshte : L42011022M. Faleminderit | 04.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju bejme me dije se, aplikimi per çregjistrim i kryer per subjektin me NUIS (NIPT) L42011022M eshte miratuar. Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 198 | 05.09.2017 | Desha te dija nga ana Juaj, cfare dokumentacioni duhet te dorezoj prane QKB ne menyre qe te kaloj Shoqerine nga statusi "Aktiv" ne statusin "Pasiv"?<br><br>Mbetem ne pritje te pergjigjes Suaj | 07.09.2017<br><br>Pershendetje<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e duhur per te kryer cregjistrimin e biznesit tuaj. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 199 | 05.09.2017 | Pershendetje. Nje shoqeri e Huaj, deshiron te bleje 40% te kuotave te nje shpk shqiptare. Shoqeria e huaj eshte e detyruar te hape nje dege ne Shqiperi fillimisht qe te bleje kuotat e shoqerise shqiptare, apo mund ta beje direkt edhe pa hapur dege ne Shqiperi ? | 07.09.2017<br><br>Pershendetje, Nje shoqerie e huaj mund te bleje kuotat e nje shoqerie shqiptare pa qene nevoja per tu regjistruar ne regjistrin tregtare si dege e shoqerise se huaj.<br>Pas blerjes se kuotave te shoqerise shqiptare, shoqeria e huaj per te pasqyruar blerjen e bere ne regjistrin tregtare, pervec kontrates se transferimit te kuotave, i nenshtrohet dhe zbatimit te nenit 28/29 teligjit 9723, date: 03.005.2007 " Per Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar. | perfunduar | Nuk ka |
| 200 | 06.09.2017 | Kam nje deklarate noteriale njohje detyrimi ndermjet dy paleve. Nje nga Palet eshte subjekt tregtar ndersa pala tjeeter individ. Pala subjekt tregtar nuk deshiron te beje veprime ne QKB. Dhe sot kemi marre komunikimin se subjekti tregtar deshiron te tjetersoje shoqerine . Ju lutem kerkoj informacion nese mund ta regjistroje kete deklarate noteriale, une pala individ. | 07.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Referuar nenit 19 të ligjit 9723, datë 03.05.2007 " Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar "*Regjistri Tregtar duhet të permbajne te dhena qe i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.*"gjithashtu bejme me dije se, QKB-ja referuar nenit 45 te ligjit 9723, date 03.05.2007, regjistron në regjistër dhe publikon, kryesisht ose me kërkesë nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e subjektit.<br><br>2. Kërkesës për regjistrime nga personat e interesuar i bashkëlidhet vendimi përkatës<br><br>Sa me siper, deklarata noteriale qe ju permendni nuk bën pjesë në kategorinë e të dhënave për regjistrim në regjistrin tregtar.<br><br>Gjithashtu referuar nenit 26/3 të ligjit 9723, datë 03.05.2007 " Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar "Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 201 | 06.09.2017 | Pershendetje, Bashkengjitur do te gjeni kerkesen e bashkepunimit si edhe pagesen e bere per 5 raportet e kerkuara ne vleren 17,500 leke. Ju lutem na njoftoni se kur mund te jene gati si raporte. | 07.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj, ku kerkoni te dhena lidhur me Regjistrin Tregtar, lutem dergimin ne menyre zyrtare te kerkeses dhe mandatin e pageses. Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 202 | 06.09.2017 | Kerekoj te di ne çdo kohe listen e subjekteve qe ushtrojne aktivitet ne teritorin e bashkise Kuçove ( ne Njesite administrative Kuçove, Kozare, Perondi, Lumas), per te ditur gjendjen e tyre se kush aktivizohet e kush pezullohet per ti lidhur me detyrimet e bashkise , pasi te dhenat na vijne nga QKB por me vones ne kohe. Ju faleminderit per mirekuptimin. | 07.09.2017<br><br>Pershendetje ,<br><br>Referuar marreveshjes qe ka Qendra Kombetare e Biznesit me Bashkine Kuçove , dergohet informacion ne periudhe periodike cdo fillim muaji nga data 1-10 te çdo muaji pasardhes, mbi Regjistrimet , Ndryshimet dhe Cregjistrimet.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 203 | 06.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam i interesuar per hapjen e nje aktiviteti 3D ( Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) por nuk e di se cfar dokumentash duhen per te mare licensen per ushtrimin e aktivitetit ne kete fushe | 07.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj. Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 204 | 06.09.2017 | Pershendetje, Une kam aplikuar ne muajin Maj per Crregjistrimin e Subjektit, me kane dale si gjoba dhe detyrime ne sistemin e tatimeve , te cilat i kam pagur qe ne fillim te muajit gusht ! Ka mbi 15 dite qe tatimet me kane thane se ia kemi nis QKR shkresen per lejimin e mbylljes se aktivtetit tim ! Une kam kontrolluar disa here Faqen tuaj si dhe jam | 07.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëj me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) K47214074B është miratuar dhe subjekti aktualisht ka statusin: Çregjistruar. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | interesuar tek dega juaj ne shkoder, por Nipti nuk eshte mbylluar akoma ! Ju lutem na ndihmoni dhe informoni per rastin ?! | Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare:www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | | |
| 205 | 08.09.2017 | Pershendetje, Kam bere nje aplikim per cregjistrim biznesi qe ne date 20 Korrik dhe sipas stafit tuaj duhet te merrja nje konfirmim brenda 30 ditesh. Ky afat ka kaluar prej me shume se 15 ditesh. Ju lutem nje konfirmim kur mund te marr nje pergjigje.Emri i aplikimit eshte Mino Angjellari. | 11.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi i kryer për çregjistrim lidhur me subjektin (person fizik) Mino Angjellari është miratuar dhe subjekti aktualisht figuron me status: çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 206 | 08.09.2017 | Interesohem per subjektin fizik qe ka aplikuar per crregjistrim a ka ardhur tek ju shkresa nga DRT DURRES me Nr.prot 5532/1,dt.18.05.2017 qe subjekti nuk ka detyrime sepse vazhdon te jete aktiv. | 11.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) K61425505S është çregjistruar.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 207 | 08.09.2017 | Ky pyetësor realizohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros, për vlerësimin e kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës së informimit, sa i përket pozitës së tyre brenda institucionit, burimeve dhe infrastrukturës ekzistuese në mbështetje të detyrës së tyre, si dhe aftësive profesionale. | 11.09.2017<br><br>Lidhur me plotesimin e pyetesorit, u plotesua nga une, Kordinator per te Drejten e Informimit per Njoftim dhe Konsultim Publik.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 208 | 08.09.2017 | Kemi aplikuar me dt 06.09.2017 per riemerim administratori Z. Fadil Sinani dhe emerim administratori Z. Islam Liçi . nr ceshtjes se aplikimit eshte CN-451855-09-17 dhe nuk kemi marre pergjigje cfar na ben pengese ne per te marre pjese ne procedurat e prokurimit . Ju lutemi na ktheni pergjigje | 11.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-451855-09-17 figuron të jetë miratuar. Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 209 | 12.09.2017 | Subjekti ALBA FOOD EXPORT shkp me NIPT L48318502P ka filluar procedurat e likujdimit.<br>Me date 28.08.2017 ka derguar njoftimin e pare per kreditoret. Me date 29.08.2017 shkresa eshte marre ne dorezim nga ana e juaje.<br>Akoma nuk eshte bere shpallja nga ana e juaj.<br>Ju lutemi te beni shpalljen ne faqen Zyrtare QKB te ketij njoftimi Ju faleminderit per bashkepunimin<br>Likujdatori mark zefi | 14.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Referuar kerkeses tuaj , njoftimi eshte publikuar dhe bashkelidhur gjeni printscreen nga kerkimin ne faqen zyrtare te QKB-se .<br><br>Pune te mbare !<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 210 | 12.09.2017 | Shoqeria "FRIGO BEAIR TECHNOLOGY" SHPK me nipt: L51416006U merret me ndertimin, projektimin dhe administrimin e impianteve frigoriferike industriale, ( shiko objektin e aktivitetit).<br><br>Une doja informacion nese me duhet leje per ndertimin e dhomes frigoriferike te mjeteve te transportit levizese qe merren me transportin e produkteve qe duhet te ruhen ne kushte frigoriferike. | 14.09.2017<br><br>Pershendetje<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj per informacion po ju bej me dije se:<br><br>Ndertimi, projektimin dhe administrimin e impianteve frigoriferike industriale eshte nje aktivitet qe nuk perfshihet ne asnje nga veprimtarite qe kane nevoje per licence, qe leshohen nga ose nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit ( shtojca e ligjit 10081 date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise). | Perfunduar | Nuk ka |
| 211 | 12.09.2017 | Une qe po ju shkruaj jam ekonomistja e nje subjekti Misha shpk me NUIS J91801501S i cili ka eshte i pezulluar nga Prill i vitit 2012 qe nuk ka asnje lloj trasnaksioni.<br>Duke qene se i ka mbaruar afati i emerimit te administratorit dhe do te riaktivizojne aktivitetin jane bere veprimet perkatese ne zyrat e Deges QKB Durres ,dhe sot vjen refuzimi per mos dorezim bilanci kontabel te vitit 2016 .Pyetja eshte nje Subjekt i pezulluar ka detyrim ligjor te dorezoje Bilanc ne QKB | 14.09.2017<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojme si me poshte:<br><br>Bazuar ne nenin 43 te ligjit 9723 "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, çdo subjekt që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë dhe aktet përkatëse, si pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.<br><br>Nga sa me siper, subjektet duhet te regjistrojne pasqyrat financiare raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme.<br><br>Gjithashtu ju bejme me dije se, QKB kryen verifikimin e subjekteve qe kane detyrimin per mbajtjen e pasqyrave financiare vjetore mbi bazen e te dhenave të derguara ne QKB, nga organet tatimore. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 212 | 13.09.2017 | Pershendetje<br><br>Desha te di per nje subjekt shpk me 2 ortake : 96 % njeri dhe 4 % tjetri , cfare procedurash duhet te kryhen qe nje biznes ne Zvicer te bleje shumicen e aksioneve te subjektit ne fjale ( 80 % ) ?<br><br>Cilat jane dokumentacionet qe duhet te dorezohen ?<br><br>Faleminderit | 14.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj po ju dergojme bashkelidhur dokumentacionin e duhur per aplikim prane sporteleve te QKB-se.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 213 | 13.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Mua me duhet te zgjas kohezgjatjen e keshillit mbikqyres dhe administratorit te firmes, gje qe une e kam bere gjithemone duke depozituar prane QKR-se nje vendim te asamblese se pergjithsme te ortakut.<br><br>Por kete here kam nje ndryshim nga vitet e meparshme. Njera prej antareve te keshillit mbikqyres ka ndryshuar mbiemer meqenese gjate kesaj kohe eshte martuar. Nuk e di se cfare do te me duhet te depozitoj ne QKR per shtimin e afatit te antarit te keshillit mbikqyres. A mund ta shtoj kohezgjatjen e antares se keshillit mbikqyres vetem me vendim asambleje te ortakut duke specifikuar mbiemrin e ri dhe ne kllapa mbiemerin e vjeter apo do te me duhet dicka tjeter | 14.09.2017<br><br>Nisur nga e-maili juaj ju sqarojme si me poshte:<br><br>Për të bërë ndryshimin e mbiemrit të njërës prej antëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, në aplikimin përaktës duhet të depozitoni dhe çertifikatën e zonjës e cila vërteton ndryshimin e mbiemrit.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 214 | 13.09.2017 | Nje shoqeri e huaj kerkon te regjistrohet me nipt sekondar ,dua te njehem me procedurat dhe dokumentacionin ,kushtet qe duhet te plotesoj dhe te tjera me qellim qe te realizoj regjistrimin si subjekt me nipt sekondar ,pasi veprimtarin me niptin kryesor e kryen jashte Shqiperise,nuk eshte nenshtetas shqiptar. | 14.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e duhur per aplikim prane sporteleve tona.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 215 | 13.09.2017 | Te nderuar QKR,<br>doja te doja nese ndermjet sherbimeve statistikore qe ju i ofroni kompanive, keni mundesine te sherbeni me pagese listen e kompanive te hapura ne Shqiperi dhe te rregjistruara prane jush ne tre muajt e fundit se bashku me emailin dhe numrin e telefonit. Nese po doja te doja sa eshte kostoja e sherbimit. | 14.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme listen me sherbimet dytesore qe ofron institucioni yne, sebashku me tarifat perkatese.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 216 | 13.09.2016 | Pershendetje, Une jam Eliverta Sinoimeri- likujdatore e zyre se perfaqesimit: CEFC China Energy CO ltd m nipt L42029003E. Shoqeria e ka mbushur afatin perfundimtar te parashikuar nga ligji per tu çregjistruar por deri me sot QKB nuk ka bere cregjistrimin. Ju lutem te meren masat Ju faleminderit | 14.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim me numër CN-407419-07-17, i kryer për subjektin CEFC China Energy CO ltd me NUIS (NIPT) L42029003E është refuzuar, pasi QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, ne baze e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, dhe Ligjit Nr.9920, datë 14.05.2008, "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 45. Sipas shkresës nr.152185/1-152209/1, datë 24.08.2017, ardhur nga Bashkia Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 44.995 leke. | perfunduar | Nuk ka |
| 217 | 13.09.2017 | Pershendetje. Quhem Amner Bekteshi dhe kam ushtruar nje aktivitet si agjensi funerale me NIPT L56616003M. Kam mbyllur aktivitetin qe ne mars te v 2017. Aktiviteti ka mbetur pa u mbyllur per nje gjobe prej 10 000 leke te hedhur gabimisht ne | 14.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) NIPT | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | sistemin tatimor. Kjo gjobe eshte falur ne fund te qershorit 2017 dhe ne gjyse te korrikut DRt shkoder ka lajmeruar QKB se nuk kemi detyrime. Qe nga ajo kohe mgjs ka kaluar cdo afat ligjorQKB nuk e mbyll aktivitetin tim | L56616003M është çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik te subjektit.<br><br>Faleminderit | | |
| 218 | 13.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ne mars/2017 dorezuam prane qkb bilancin paraprak te 2015 gjithashtu dhe gjoben e paguar per vonesen. Para nje jave bem aplikim per dorezimin e bilancit perfundimtar te 2015 nepermjet portalit e-albania dhe na u refuzua aplikimi me arsyen qe: bilanci i 2015 eshte depozituar nje her ne 03/2017.Si mund te veprohet per depozitimin e bilancit te plote dhe perfundimtar te 2015 | 14.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Referuar emailit tuaj, për kryerjen e verifikimit, lutemi të na bëni me dije numrin e aplikimit të kryer ose të dhënat e subjektit, si NUIS (NIPT)-in etj.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 219 | 13.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem kerkojme informacione sa i perket subjektit Laurus Sh.p.k me NIPT K67101005J ne lidhje me dorezimin e pasqyrave financiare te vitit 2014. Laurus Sh.p.k ka kerkuar prane sporteleve te QKB Shkoder, zmadhimin e kapitalit te kompanise, gje e cila nuk eshte lejuar nga sistemi i QKB me arsyetimin e mosdorezimit te pasqyrave financiare te vitit 2014.<br><br>Realisht dorezimi i pasqyrave ne fjale eshte realizuar , gje te cilen e vertetojne edhe e-mailet bashkengjitu ketij e-maili dhe gjithashtu kemi realizuar zmadhim kapitali edhe ne vitin 2015 krejt normalisht , pa patur | 14.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojmë si më poshtë:<br><br>Pas verifikimit të kryer rezulton që, subjekti "LAURUS" sh.p.k. me NUIS (NIPT) K67101005J ka aplikuar më datë 03.08.2015, për depozitimin e Bilancit të vitit 2014 me aplikimin me numër CN-189860-08-15.<br><br>Aplikimi me numër CN-189860-08-15 pasi është shqyrtuar, është refuzuar sepse subjekti ka aplikuar për depozitimin e bilancit të vitit 2014 jashtë afatit ligjor (31 Korrikut të vitit 2015), duke ju bërë me dije nëpërmjet vendimit të refuzimit datë 04.08.2015, se “aplikimi refuzohet, pasi subjekti nuk ka shlyer sanksionin administrative përkatësisht gjobën në masën 15.000 lekë të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të Ligjit Nr. 9723, datë | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ndonje problem.<br><br>Ju lutem shqyrtojeni rastin tone duke i dhene sa me pare nje zgjidhje. | 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Për depozitimin e dokumentave të sipërcituata për vitin 2014, duhet të riaplikoni përsëri duke bashkëlidhur në aplikim edhe mandatin e pagesës së gjobës së derdhur në një nga bankate nivelit të dytë, mandat i cili për tu klasifikuar si i vlefshëm duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë: - Emrin e subjektit; -Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS/NIPT; - Përshkrimi (Depozitimi i pasqyrave financiare, raportit të auditit dhe veprimtarisë pranë QKR për vitin 2014). Të dhënat për kryerjen e pagesës janë: Dega e Thesarit 3535 Kodi i Institucionit 1004093 Llogaria Ekonomike 7113099"<br><br>Verifikimi lidhur me gjendjen e aplikimeve mund të bëhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. | | |
| 220 | 13.09.2017 | Pershendetje. Jemi Firma e Ndertimit Derveni-1 Shpk. Para 2 muajsh, ne daten 11-07 2017 kemi bere 2 aplikime per leje mjedisi per fabrike asfalti e fabrike betoni. Nga kontrolli qe bejme ne internet del qe leja eshte qe eshte akoma ne proces. Duam te dime cila eshte arsyeja qe po vonohet kaqshume. | 14.09.2017<br><br>Përshëndetje, Nga verifikimi në sistem Subjekti Derveni -1 Shpk me NIPT K49322548U ka aplikuar më datë 17.07.2017 për çështjet LC-2611-07-2017 dhe LC-2614-07-2017, për të cilat më datë 08.09-2017 është marrë vendimi i Refuzimit nga Institucioni tjetër (Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedist), bashkëlidhur po ju dërgojmë Aktet e Refuzimit. Ju faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |
| 221 | 13.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Kerkesa eshte dorezuar ne Qendren kombetare te biznesit nderkohe po ju nisim me poste edhe urdher transferten e ekzekutuar<br><br>Faleminderit<br><br>Aulona | 14.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Referuar kerkeses tuaj , ju informojme se jemi duke punuar per te dhenat statistikore te cilat kerkohen nga ju.<br><br>Lutemi ju kerkojme ndjese , pasi numri i bilanceve (pika 4 ne raport), ka madhesi te madhe te dhenash, si rrjedhoje mund te paraqiteni diten e premte rreth ores 11, me nje USB 16 GB , ose Hard disk te jashtem , per shkak te madhesise te te dhenave, prane institucionit tone per te marre te dhenat e kerkuara ne te peste | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | raportet.<br><br>Duke ju falenderuar per bashkepunimin,<br><br>Ju urojme dite te mbare !<br><br>Faleminderit, | | |
| 222 | 14.09.2017 | pershendetje . ju lutem nese eshte e mundur te me shpejtoni proceduren e mbylljen e aktivitetit pasi jam paraqitur ne qkb elbasan dhe me thone qe eshte ne proces por kam disa jav qe paraqitem dhe akoma skam mbaruar .<br><br>ASTRIT LILA me nr nipti L59521102P | 18.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se subjekti me NUIS (NIPT) është çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 223 | 15.09.2017 | Si jeni? Nese dua te mbyll nje shoqeri sh.p.k ku une jam ortake, si mund ta bej? une jam nje nder ortaket e shoqerise e cila nuk kryen aktivitet prej muajsh. | 18.09.2017<br><br>Pershendetje,Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e duhur me qellim kryerjen e aplikimit per cregjistrim.Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 224 | 15.09.2017 | Pershendetje, A duhet te pajisen me licence kompanite te cilat kane si aktivitet primar dhenien me qera te automjeteve në zbatim të Ligjit te ri Nr. 9573, datë 03.07.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to. | 18.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Kompanitë të cilat kanë si aktivitet primar dhënien me qera të automjeteve **nuk pajisen me liçencë**.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 225 | 15.09.2017 | Jam i interesuar per hapjen e nje aktiviteti 3D ( Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) dhe dua te di a mund ta mar licencen duke qene vet drejtues teknik vetem me nje certifikate trajnimi si kimist pasi diploma ime eshte e fushes se finances | 19.09.2017<br><br>Lidhur me shqetësimin e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon:<br><br>Në udhezimin nr. 184, datë 16.06.1998 janë përcaktuar dokumentet që duhet të paraqesë subjekti për të përmbushur kriterin e përshtatshmësë së njohurive dhe eksperiencës së personelit. Për ushtrimin e aktivitetit "Shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore", drejtuesi teknik duhet të jetë:<br><br>-epidemiolog (mjek)<br><br>-higjienist (mjek)<br><br>-biolog<br><br>-kimist<br><br>Bashkëlidhur, do të gjeni Udhezimin nr. 184, datë 16.06.1998 | Perfunduar | Nuk ka |
| 226 | 15.09.2017 | Mirëmëngjesi,<br><br>jam duke aplikuar online për hapjen e nje sh.p.k-je. Por kur dërgoj aplikimin (butoni "nënshkruaj dhe dërgo"), sistemi më thotë që aplikimi nuk u dërgua për faj të një gabimi në të dhëna. Ju lutem me ndihmoni | 19.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojmë se, informacionin për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar si dhe për plotësimin e Seksionit D (deklaratë të detyrueshme për qëllime tatimore, të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe **të punës)**, mund ta merrni në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, si dhe në portalin e-albania (regjistrimi fillestar i biznesit (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 227 | 18.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem mund te me ndihmoni duke me derguar Bazen Ligjore per rastet kur ç'rregjistrimi i NUIS kryhet nga organet tatimore dhe jo nga QKB?<br><br>Ne pritje te pergjigjes tuaj. | 19.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije bazën ligjore për çregjsitrimin e biznesit;<br><br>Ligji 9920, datë 19.05.2008 " Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".<br><br>Udhezimi Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, Për Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 228 | 18.09.2017 | Kam ushtruar aktivitetin me nr nuis L02602402O, ne muajin korrik kam aplikuar per cregjistrim. Interesohem te Drejtoria e Tatimeve Fier dhe me thone nuk ka ardhur shkresa nga QKB. Desha te di se ne cfaze ndodhet aplikimi. | 19.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) L02602402O është refuzuar, pasi QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, në bazë e per zbatim të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" dhe Ligjit Nr.9920, datë 14.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 45. Sipas shkresës nr.11980, datë 01.08.2017, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 129 861 leke.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 229 | 18.09.2017 | Kam bere nje aplikim per mbyllje biznesi me date 10.02.2015 dhe nje riaplikim me daten 27.06.2017 dhe nuk po marr pergjigje per mbylljen e biznesit tim me nr ceshtje CN-347946-06-17, gje e cila po me penalizon per daljen ne asistence. Ju lutem me ndihmoni. Faleminderit | 19.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim me numër CN-347946-06-17 është miratuar dhe subjekti aktualisht figuron me status: çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 230 | 18.09.2017 | Pershendetje<br><br>Ne pergjigje te detyrimit ligjor per te depozituar pasqyrat financiare te subjekti Misha shpk NUIS J91801501 Si depozitova dt.12/09/2017 dhe sot me vjen refuzimi se i ka kaluar afati administratoreve. Me falni po une kerkova te zgjas afatin e adminitratoreve me refuzuat se nuk jane dorezuar pasqyrat financiare dhe te vendimi i ortakut eshte bere nje lapsus per vitin si dhe ju bej te ditur dhe njehere qe shoqeria eshte pa aktivitet i pezulluar nga viti 2012 | 19.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Aplikimi i kryer për subjektin Misha shpk NUIS J91801501S figuron të jetë miratuar.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 231 | 19.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem mund te me dergoni elektronikisht te gjitha vendimet gjyqesore per riorganizimine shoqerive tregtare, pasi me duhen per punimin e temes sime te diplomes.<br><br>Ju faleminderit paraprakisht! | 19.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme listen me sherbimet dytesore qe ofron institucioni yne sebashku me faturat perkatese.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 232 | 20.09.2017 | Pershendetje,<br><br>ne emer te eproreve te mi Ju lutem te me siguroni te dhena se cilat jane firmat qe perfaqesojne 10 shqiptaret me te pasur per vitin 2016 ne Shqiperi dhe konkretisht:<br><br>Samir Mane<br><br>Shefqet Kastrati<br><br>Vasil Naci<br><br>Behar Cukaj<br><br>Tom Doshi<br><br>Rrok Gjoka<br><br>Grigor Joti<br><br>Idajet Ismailaj<br><br>Vilma Nushi<br><br>Pellumb Salillari<br><br>-Cfare forme koorporate kane keto firma sha. apo shpk.<br><br>-Si dhe sasia e kapitalit neto te secilit prej tyre.<br><br>Ju falenderoj shume per ndihmen paraprake. Gjithe te mirat | 22.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Lidhur me informacionin e kërkuar, jeni të lutur të aksesoni në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në linkun: http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/. Në këtë link mund të gjeneroni lehtësisht informacionin duke përdorur si kriter kërkimi emrin e ortakur/aksionarit.<br><br>Të dhënat lidhur me subjektet, ku individët e përcaktuar në listën e dërguar nga ana juaj janë ortak/aksionarw, janë lirisht të aksesueshme në ekstraktin historik të subjektit. Këto të dhëna përfshijnë si formën e organizimin të shoqërisë, përqindjen e pjesëmarrjes në kapital, vlerën përkatëse. Gjithashtu në ekstraktin historik mund të shkarkoni pasqyrat financiare të subjekteve, në rast se këto pasqyra janë publikuar nga subjekti, dhe të merrni informacion të detajuar lidhur me fitimin e subjekteve.<br><br>Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 233 | 20.09.2017 | Përshëndetje; Ju shkruaj për një problem; Ka vdekur ortaku i nje shoqerie edhe , eshte depozituar ne QKB deshmia e trashegimise. QKB ka bere pjestimin e kuotave . Kërkohet te depozitohet certifikata e martesës mes trashegimlenesit edhe bashkëshortes se tij. Kjo per te caktuar "BASHKESINE LIGJORE" , pra tashme bashkeshortja trashegimtare te pajiset me titull pronësie për kuotat edhe kapitalin e shoqërisë ; Pyes; 1- Meqenëse, nuk është bere pjesëtimi i kuotave nga bashkëpronaret e rij Trashëgimtare a vlen marrëveshja e trashëgimtareve pa noter ? 2- Dy nga trashëgimtaret janë te mitur mbi 14 vjeç; a VLEN PER Ju, miratimi i nenës ( trashegimtare edhe kjo , poer qe i rritet pjesa ) paraprak siç e përcakton Kodi Civil neni 6 ? Faleminderit | 22.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga marrja në shqyrtim e përmbajtjes së e-mailit tuaj nuk është e qartë se ku konsiston konkretisht kërkesa juaj adresuar ndaj institucionit tonë.<br><br>Referuar nenit 66 e 136 të Kodit të Proçedurave Administrative, kërkesa duhet të përmbajë ndër të tjera: "...*c) shpjegime në lidhje me faktet rreth të cilave bëhet kërkesa, si dhe kur është e mundur, bazën ligjore për këtë kërkesë; ç) shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet*".<br><br>Bazuar në neni 68 të K.Pr.A, lutemi saktësimin e kërkesës, në mënyrë që të merret në trajtim shqetësimi juaj, brenda parashikimeve ligjore.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |
| 234 | 20.09.2017 | Pershendetje, Nje subjekt juridik, i cili eshte i huaj, ka bere nje kontrate shitjesh kuotash prane nej zyre noteriale ne shqiperi. Mirepo u largua diten tjeter ne memngjes dhe nuk e di kur mund te vij. Per shkak se ka nje afat ligjor ne depozitimin e ndryshimeve qe ben nje biznes, mund tua nisim me poste kontraten e shitjes? Ose te skanuar?Se nuk kam prokure per te depozituar dokumenta ne llogari. | 22.09.2017<br><br>Pershendetje, Referuar ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimine e Biznesit" i ndryshuar, neni 20/26 *Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre.Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksioneri, të cilit këto i përkasin".Sa më sipër, për të bërë depozitimin e kontratës së shitjes, aplikimi duhet te kryhet nga përfaqësuesi i shoqërisë, përfituesi i kuotave ose ç do person i autorizuar prej tyre pranë çdo sporteli shërbimi të QKBsë.* | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 235 | 21.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem mund te kemi nje pergjigje se kur mund te paraqitemi per te marre raportet Pagesa per kete sherbim eshte kryer ne date 04/09.<br><br>Faleminderit | 25.09.2017<br><br>Pershendetje ,<br><br>Referuar emailit tuaj , lutemi te paraqiteni diten e neserme , rreth ore 11:00 per te marre te dhenat e kerkuara nga Regjistri Tregetar.<br><br>Lutem te keni me vete nje nje HDD , per shkak se bilancet zene hapsire te madhe.<br><br>Duke ju falenderuar, | perfunduar | Nuk ka |
| 236 | 21.09.2017 | Prsh, Kam aplikuar per crregjistrim nipti qe me date 27.06.2017 dhe akoma nuk kam nje pergjigje. Nipt : L61516007J . Person fisik . Tirane . NGa zyrat e QKR me thone qe ti drejtohem zyrave tuaja per nje pergjigje . A eshte e mundur te di se pse nuk po mare nje pergjigje ,positive apo negative qoft ajo ?? Duke ju uruar nje dite te mbare shpresoj ti pergjigjeni kerkeses time | 25.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se subjekti me NUIS (NIPT) L61516007J figuron të jetë çregjistruar.<br><br>Verifikimin mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 237 | 22.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Per arsye te ndryshme nje shoqeri aksionare (sha me nje aksionar te vetem) kerkon te shnderrohet ne shpk. desheroj te informohem:- A eshte i mundur te kryhet teknikisht ky shnderrim? - Nese jo, cfare zgjidhje alternative sugjerohet | 25.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nje shoqeri aksionere mund te shenderrohet ne shpk ne perputhje me dispozitat e nenit 228 e ne vijim te ligjit 9901, date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.<br><br>Aplikimi kryhet prane ç do sporteli sherbimi te Qendres Kombetare te Biznesit. Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 238 | 22.09.2017 | Jemi ne pritje te pergjigjes se shkreses me Nr. Prot. Hyres 976, date 24.01.2017 lidhur me afatin e vlefsmerise te licences me Nr. LN-2298-11-2017, te subjektit “ARBA” Sh.p.k. e cila eshte me afat 1(nje)vjecar | 25.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj, ju njoftojme qe licenca juaj LN-2298-11-2016 i eshte perditesuar afati ne Regjister.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 239 | 22.09.2017 | Pershendetje !<br><br>Faleminderit per pergjigjen ne te cilen perfshihet dhe arsyetimi i refuzimit lidhur me aplikimin per licence.<br><br>Duke qene se dokumenti i pronesise qe eshte ne rastin ne fjale vertetim nga Zyra e Legalizimit Kavaje eshte ne emer te Z. Anastas Jorgji Mihani i cili eshte babai im dhe objektin ne te cilin ndodhet Fabrika e perpunimit te qumeshtit Kati i Pare i godines eshte aplikuar per Leje Legalizimi ne emer te babait tim ( objekt me funksion kombinuar ( banim + aktivitet ekonomik).<br><br>Ne kete rast meqe jemi ne pritje te Legalizimit , a mund te paraqesim kontrate qeraje per kete objekt per te bere zgjidhje konform ligjeve ne fuqi . | 25.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Si formë dokumenti pronësie që vërteton përdorimin e objektit nga subjekti që ju përfaqësoni mund të pranohet çdo akt marrëveshje si psh:<br><br>1)- kontratë qiraje mes pronarit të objektit (i cili rezulton në vetëdeklarimin e ALUIZNI-t)dhe subjektit të përfaqësuar nga ju ose;<br><br>2)-kontratë huapërdorje mes dy palëve.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 240 | 22.09.2017 | Pershendetje , jam juriste ne shoqerine AGI KONS shpk . ne date 19.09.2017 eshte aplikuar Vendimi i ortakut te vetem per riemerimin e administratorit te shoqerise . Ne ekstratin qe kemi marre pas aplikimit , rezulton se ne piken 11 , kufizime te kompetencave rezulton se nuk eshte ndryshuar afati i | 25.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nga verifikimi i kryer rezulton se, për subjektin AGI KONS sh.p.k. me NUIS (NIPT) K21622001M, tek Seksioni 11.1: Kufizim i kompetencave të administratorit figuron shënimi: “Administratori | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | i emerimit te administratorit , i cili ka ngelur date 19.09.2017 , nderkohe duhet te ishte 19.09.2020. Falemnderit ! | i vetem i shoqerise me te drejta te plota dhe te pakufizuara deri ne daten18.09.2020.”.<br><br>Verifikimin mund të kryeni duke gjeneruar Ekstraktin e subjektit ne faqen zyrtare: www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | | |
| 241 | 26.09.2017 | Me daten 24.07.2017 eshte bere dorezimini online i Bilancit per vitin 2014 per subjektin Scutari Distribution Shpk L46407010M, CN 168461 0715<br><br>Ne esktraktin Historik nuk rezulton i derguar Bilanci per kete vit. ju lutem a mund te na ndihmoni me sqarimin e rastit ? | 26.09.2017<br><br>Pershendettje ,<br><br>Aresyeja pse ju nuk shihni ne extract dorezimin e bilancit me CN-168461-07-15 pasi ky aplikim eshte refuzuar. Bashkengjitur gjeni nje kopje te aktit te refuzimit. | perfunduar | Nuk ka |
| 242 | 26.09.2017 | Pershendetje! Ceshtja 380153-07-17 aplikuar dt 17.07.17,megjithse ka kaluar afati i pritjes lene akoma ne pritje, lutemi nderhyni .flm | 26.09.2017<br><br>Aplikimi me numer CN-380153-07-17, date 17.07.2017 u procesua. QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, ne baze e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45. -Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr. 6055/1Prot., datë 02.08.2017, ardhur nga Bashkia Elbasan, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 2500Leke. | Perfunduar | Nuk ka |
| 243 | 26.09.2017 | Pershendetje.Jam pronare e nje lokali (ish riparim sherbimet). Per arsyen se duhet te ve sahat te ri te energjise elektrike( lokali ka qene i pafunksionushem prej 22- vitesh) duhet te pajisem me nr. NIPT jo fiktiv(kjo sepse nuk do te hapet aktivitet por do te leshohet me qira | 26.09.2017<br><br>Pershendetje, lidhur me emailin tuaj ju sqarojme se:<br><br>Për sa i përket pajisjes me NUIS NIPT jo fiktiv ky koncept nuk njihet nga Qëndra Kombëtare e Biznesit.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 244 | 26.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Vendosa tju kontaktoj pasi me nevojitet nje dekument qe verteton nese familjaret e mi posesojn aktivitet privat ose jo ,dhe nese po sa jan te ardhurat vjetore ne vitin 2015.I vetmi person qe poseson biznes eshte mamaja ime Shege Sinani, biznesi me NIPT: L42304505D.Problemi qendron se jam jasht shtetit dhe ne pamundesi per te ardhur ne Shqiperi nuk di si ta mar vertetimin. | 26.09.2017<br><br>Pershendetje!<br><br>Referuar e-mailit tuaj, për tu pajisur me informacionin qe ju kerkoni, duhet ti drejtoheni me shkrese zyrtare Qendres Kombetare te Biznesit.<br><br>Faleminderit! | perfunduar | Nuk ka |
| 245 | 26.09.2017 | kam pothuaj 10 vjet qe e kam mbyllur aktivitetin.kur shoh emrin tim me del qe duhet te paraqitem prane sporteleve te qkb.mund ta di arsyen | 26.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Per te bere te mundur shqyrtimin e kerkeses suaj, ju lutem na vini ne dispozicion te dhena me te detajuara ( NUIS NIPT, Nr. Vendimit te gjiykates, etj).<br><br>Faleminderit! | perfunudar | Nuk ka |
| 246 | 26.09.2017 | Me date 22 Gusht 2017 eshte hapur ne QKB Person Fizik me NIPT L72022033Q "Flogert Cani". Qe nga data 24 Gusht e ne vijim jam munduar te bej deklarimin e personit fizik per veten por me jep nje error dhe nuk me lejon te bej kete deklarim | 26.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lutemi te paraqiteni prane sporteleve te QKB per te bere nje perditesim(ndryshim) qofte edhe te te dhenave vullnetare ne menyre qe te transmetohen serisht te dhenat drejt DPT me te NID e korrigjuar.<br><br>Faleminderit! | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 247 | 27.09.2017 | Pershendetje jam antonio pica kam bere nje aplikim me dt.07.07.2017 per crregjistrim dhe akoma nuk me ka dale pergjigjja , ju lutem me thoni cfare duhet te beje. | 27.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi i kryer për çregjistrim lidhur me subjektin me NUIS (NIPT) L62002505J është miratuar.<br><br>Verifikimin mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 248 | 27.09.2017 | pershendetje!kam aplikuar me dt.21/09/2017 per administratorin e shoqerise Haidshpk prane qkb dega kruje,me thane se nuk keni dorezuar bilancin e vitit 2014 dhe bashke me te duhet paguar dhe gjoba .me dt.25/09/eshte bere pagesa dhe dorezimi i bilancit2014 gje qe eshte pasqyruar dhe ne extrakt ndersa ndersa aplikimi i dt.21 nuk eshte pasqyruar. JU lutem te behet ky ndryshim pasi po me nxjerr shume pengesa. Me respekt | 27.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, në menyrë që të kryhet verifikimi duhet të na dërgoni të dhënat e aplikimit që keni kryer (numrin e aplikimit) ose të dhënat e subjektit për të cilin është kryer aplikimi.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 249 | 28.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergoj, formularin e ankeses sime kundrejt QKB-se.<br><br>Faleminderit. | 28.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Referuar ankesës tuaj ardhur me email, ku citoni se QKB duhet të bëjë njoftimin në drejtorinë rajonale Tatimore Vlorë për aplikimin për çregjistrim të kryer nga Viron Xhaferri me Nr. Çështje Cn-421066-08-17, i kryer më datë 07.08.2017, ju sqarojmë se, me aplikimin me numër CN-421066-08-17 miratuar më datë 08.08.2017, është aplikuar për fillim procedure likuidimi për shoqërinë "C.F.L Industries" sh.p.k. me NUIS (NIPT) L66515203R dhe jo për çregjistrimin e subjektit.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 250 | 28.09.2017 | Pershendetje! Lutemi shihni ceshtjen CN-339215-06-17,pasi duhej te na ishte dhene pergjigje , afati 45 dite ka kaluar.flm | 28.09.2017<br><br>Pershendetje,aplikimi për çregjistrim me numër CN-339215-06-17 është refuzuar, pasi rezulton se me CN-213202-10-13, datë 07.10.2013 është kryer depozitimi i Urdhrit Nr.54/1 Regj., datë 04.10.2013, lëshuar nga permbarues gjyqesor "ALDO F.GJEVORI" ku është urdhëruar:"Vendosja e masës së sekuestros konservative në aktivet e palës debitore subjekti me Nipt L03321207P. Aktivet e mësipërme do të qëndrojnë të sekuestruara deri në një urdhëresë të dytë". Per kete arsye nuk mund te kryhet. | Perfunduar | Nuk ka |
| 251 | 29.09.2017 | Pershendetje! Kam nje shoqeri qe do te shesi kuotat e saj, por shoqeria eshte pasive per momentin, sipas nje kerkese me vendim te bordit dretues te shoqerise. Klienti eshte interesuar sot prane QKB, dhe i eshte thene qe mundet te behet shitja e kuotave te shoqerise,eshte ne kete gjendje. ju lutem me ktheni nje pergjigje per kete rast, | 29.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Një shoqëri me status Pasiv mund te kryej veprime normalisht ne përputhje me dipozitat ligjore ne fuqi.<br><br>Faleminderit! | perfunduar | Nuk ka |
| 252 | 29.09.2017 | Pershendejte, Babai im ka nje biznes ne emrin e tij si person fizik . Por me rregullin qe nxorren per naftetaret ai del ne pension tani qe mbushi 63 vjec. Doja te dija se cfare me sygjeroni te bejme ne kete rast . Duhet ta mbylli licencen dhe te hapi nje ne emer te vellait qe e kam pa siguracione ???. Do me ndihmonit shume nese do me jepnit nje pergjigje te sakte . Ne pritje te pergjigjes tuaj . | 29.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Përsa kërkoni nga e-maili juaj, ju bëjmë me dije se QKB nuk është organi kompetent për dhënien e përgjigjeve lidhur me siguracionet e subjekteve tregtare.<br><br>Për marjen e sakte të informacionit që ju kërkoni duhet ti drejtoheni institucioneve përkatëse.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 253 | 29.09.2017 | Peshendetje dpo shihja ne website te dhne rreth raporteve vjetore pr 2014 dhe 2015 si mund te marr te dhena per nje studim n lidhje me vitin 2016 dh 6 mujorin pare t vitit 2017? Ne pritje te prgjgjes suaj | 29.09.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me kerkesen tuaj, ju bej me dije si me poshte;<br><br>Raportet vjetore per vitin 2014 dhe vitin 2015 I gjeni ne faqen tone zyrtare, konkretisht ne menune “Newsroom”, nenmenune “Botime”. Lidhur me te dhenat per vitin 2016 dhe 2017, lutem specifikoni kerkesen ne menyre qe t’ju veme ne dispozicion informacionin e kerkuar.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 254 | 29.09.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem a mund te na thoni paraprakisht se cfare lejesh kerkohen per te filluar nje biznes te vogel per fast food dhe catering.<br><br>Faleminderit, | 29.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Për ushtrimin e aktivitetit fast food dhe catering biznes te vogel mund të aplikoni:<br><br>1)- Leje mjedisi e tipit C, për: Gatim dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.<br><br>2)- Liçence për: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.<br><br>Faleminderit ! | perfunduar | Nuk ka |
| 255 | 29.09.2017 | Pershendetje! Problemi i hasur per cesthtjen 392558-07-17, dhe i zgjidhur po nga ju shfaqet perseri ne ceshtjen CN-485051-09-17. Presim zgjidhjen e problemit. | 29.09.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se aplikimi me numer CN-485051-09-17 është miratuar. Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 256 | 02.10.2017 | DO me nevojiteshin te dhena ne lidhje me numrin e bizneseve te rregjistruara sipas kategorive ne disa vite , po te ishte e mundur qe para vitit 2014 deri ne 6 mujorin e pare te 2017 sa biznese jane rregjistruar, sa kane kaluar pasiv, sa jane mbyllur e cfare lloj aktiviteti kane, vendndodhjet e tyre, etj | 02.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne vijim te komunikimeve, ju bej me dije se, nese ju kerkoni informacion te detajuar rreth subjekteve si psh: NUIS, Emer subjekti, lloji I aktivitetit, emer administratori etj, ju duhet te beni pagese, pasi I referohet sherbimeve dytesore te cilat jane me pagese. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës). | perfunduar | Nuk ka |
| 257 | 02.10.2017 | Pershendetje!<br><br>Jam duke u perpjekur te bej shpalljen sipas manualit por me del shenimi:"Ndodhi një gabim gjatë ngarkimit të të dhënave!<br>Ju lutem provojeni përsëri pas disa minutash." sa here qe hyj.<br><br>Ju lutem me mundesoni aksesimin ne kete program pasi nuk po mundem.<br><br>Ju faleminderit | 02.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me emailin tuaj, ju bej me dije se, nga ana jone eshte duke u bere verifikimi I sherbimit dhe pas rregullimit do ju bejme me dije.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 258 | 02.10.2017 | Me qellim realizimin e ketij studimi ne vendin tone, e gjykuam te arsyeshme te kerkojme ndihmen tuaj per te na mundesuar kontaktet elektronike te te pakten 300-500 subjekte tatimore ne gjithe vendin, me xhiro me te madhe se 5 000 000 leke. Sa me i larte te jete numri i bizneseve te perfshira ne kete pyetesor, aq me afer realitetit do te jene edhe rezultatet qe do te prezantoje ky studim. | 02.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Referuar kerkeses tuaj, lidhur me subjktet e regjistruara prane Qendres Kombetare te Biznesit me xhiro vjetore mbi 5000000 leke, bashkelidhur lutem gjeni listen e plote te ketyre subjekteve.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 259 | 02.10.2017 | Te nderuar QKR,<br>doja te doja nese ndermjet sherbimeve statistikore qe ju i ofroni kompanive, keni mundesine te sherbeni me pagese listen e kompanive te hapura ne Shqiperi dhe te rregjistruara prane jush ne tre muajt e fundit se bashku me emailin dhe numrin e telefonit. Nese po doja te doja sa eshte kostoja e sherbimit dhe cilat jane modalitetet per ta patur. Mundesisht permes adreses se emailit. | 02.10.2017<br><br>Ne lidhje me kerkesen tuaj QKB ka nje liste sherbimesh qe ofrohen kundrejt nje pagese standarte sipas formatit bashkelidhur,Per kerkesen tuaj lista e kompanive te regjistruara ne QKB ne tre muajt e fundit mund ta merrni duke bere pagesen per sherbimin.<br><br>Por ju bej me dije se numrat e telefonit dhe adresat e e-mail te publikuara ne ekstraktin e shoqerise nuk mund te jepen te perpunuara ne nje format exceli ne baze te ligjit per mbrojtjen e te dhenave personale, por ju mund ti gjeni vete nepermjet kerkimit ne faqen tone. | Perfunduar | Nuk ka |
| 260 | 05.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam Person Fizik Brikena Ymeraj me NUIS L32116009M,ne Janar kam bere aplikimin prane sporteleve tuaja per ndryshim adrese me Nr. CN-097931-01-17.Ndryshimi i adreses eshte kryer, por me rezultoi ne sistemin tatimor e varur nga Drejtoria Rajonale Tirane kur ne fakt adresa e re eshte Vau Dejes Shkoder.Pas interesimeve te shumta ne Tatime me eshte kontaktuar qe per kete problematik qe te drejtohesha tek ju. Shpresoj ne zgjidhen e shpejt te ketij problemi | 05.10.2017<br><br>Ju bejme me dije se ne daten 09/01/2017 eshte transmetuar drejt sistemit tatimor, te cilin ky sistem e ka mare pa problem, te dhenat e derguara nga ana jone jane sipas aplikimit te kryer nga ana juaj dhe miratuar nga institucioni yne.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 261 | 05.10.2017 | Sipas bisedave tona nepermjet kesaj kerkese kerkojme njohjen e administratorit te falimentit ne faqen e tatimeve per shoqerin Belle Air shpk. | 05.10.2017<br><br>Pershendetje,Lidhur me kerkesen tuaj, ju bej me dije si me poshte:<br><br>Shoqeria Belle Air me date 16.03.2016, me CN-934752-03-15 eshte hapur ceshtja me arsyetimin: “Depozitimi i Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr.1267 Akti, date 29.1.2015, ku eshte vendosur: Pranimin e kerkeses. Miratimin dhe largimin e kerkueses Laureta Qorlaza nga detyra e administrators se falimentit te shoqerise "Belle Air" sh.p.k, dhe caktimin si administrator falimentimi ne vend te saj te Znj. Arjeta Çumani” . Pas raportimit te kesaj problematike, kompania e mirembajtjes se regjistrit Tregtar, ka bere te mundur verifikimin ne databaze dhe ka dal ne | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | perfundim se, kjo CN ka shkuar me date 16.03.2015 drejt tatimeve ndryshimi i administratorit te falimentit.<br><br>Bashkelidhur, lutem gjeni XML, ku verteton se kjo CN eshte transmetuar drejt tatimeve. | | |
| 262 | 05.10.2017 | Pershendetje!Ju lutem per ceshtjen me numer CN-375938-07-17date 13/7, kemi bere aplikimin per cregjistrim, kemi ndjekur detyrimet duke i bere zero,kemi aplikuar ne bashki ne date 18/9 per te riderguar shkresen tek ju . | 05.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim me numër CN-375938-07-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al. | perfunduar | Nuk ka |
| 263 | 09.10.2017 | Pershendetje,<br>Persa me lartpermendur ju lutem mund te kem nje iformacion, nese eshte i mundur aplikimi online per Licence te formimit profesional. | 09.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nepermjet portalit e-albania eshte e mundur kryerja e aplikimit per "Formim profesional". Per me shume informacion klikoni ne linkun https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=9740 .<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 264 | 09.10.2017 | Ne vijim te kerkeses se kryer nga Colombo Center ALbania SHPK prane QKL,sapo vume re se kerkesa jone per licensim eshte aprovuar.<br><br>Ju lutem mund te dime daten kur eshte dhene aprovimi per licensim ne menyre qe te llogarisim kohen brenda se ciles duhet te kryejme pagesen e nevojshme? | 09.10.2017<br><br>Aplikimi juaj me nr. LC-3417-08-2017 eshte aprovuar me "Miratim ne heshtje", Ne kuptim te ligjit 10081 date 23.02.2009 , neni 20 ,pika 8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër. Me paraqitjen e mandat pageses prane sporteleve te QKB-se behet e mundur printimi i licences.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 265 | 10.10.2017 | Pershendetje, Cfare licence duhet te marr nje klinike dialize? | 10.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Për shërbimin mjekësor të dializës, klasifikimi për licencimin kryhet sipas nënkategorisë II.6.B "Shërbime spitalore".Kriteret e detajuara të licencimit i gjeni bashkëlidhur e-mail-it. Për çdo sqarim të detajuar lidhur me formën dhe përmbajtjen e dokumentave që plotësojnë secilin prej kritereve ju lutem paraqituni pranë sportelit të informacionit në QKB.<br><br>Punë të mbarë. | Perfunduar | Nuk ka |
| 266 | 10.10.2017 | Bashkengjitur po ju dergojme ankesen.<br><br>Shpresojme ne nje zgjidhje sa me te shpejte.<br><br>Faleminderit. | 10.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Duke qenë se ankimin të cilin ju keni drejtuar me email, e keni dërguar edhe me shkresë, protokolluar nga QKB me Nr. 14227 Prot., datë 06.10.2017, do t'ju kthehet përgjigje zyrtare me shkresë.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 267 | 10.10.2017 | Pershendetje! Ju lutemi mund te me shikoni kete nipt L53227219B,pasi kam 2 muaj e gjysme qe kam aplikuar per Çrregjistrim dhe akoma nuk ka ardh konfirmimi. Ju uroj pune te mbare!!! | 10.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) L53227219B është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 268 | 10.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Ne jemi nje shoqeri e perpunimit te veshjeve te kembes (JEU sh.p.k) e krijuar ne Qershor te vitit 2014 me NUIS L41806010J me administrator dhe ortak te vetem FABIO ATTANASIO me ID H70514186C (nenshtetas shqiptar).<br>Ne rregjistrimin Fillestar ne QKB ne formularin e aplikimit, eshte zgjedhur fusha "shtetas i huaj" gje e cila na shkakton problematika te mevonshme ne disa nga procedurat si Dorezim Pasqyrash Financiare online apo perdorimi sefundmi i vertetimeve nga sistemi e-albania per institutionet shteterore si ISKSH. | 12.10.2017<br><br>Lidhur me kerkesen tuaj, ju bej me dije si me poshte:<br><br>Subjekti juaj, eshte regjistruar me CN-499718-06-14 me ortak te vetem z. Fabio Attanasio. Pas verifikimit te dokumenteve te paraqitura prane sporteleve te QKB-se per regjistrimin fillestar, rezulton te dorezuar statuti i subjektit dhe dokumenti i identifikimit per z. Fabio Attanasio, si shtetas Italian.<br><br>Persa I perket dorezimit te pasqyrave financiare, cdo subjekt I huaj ben dorezimin e pasqyrave financiare prane sporteleve te QKB-se.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 269 | 12.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem brenda mundesive me tregoni procedurat qe duhet te ndjek per te hequr emrin ne nje firme. Emri ekziston si likujdator i nje firme me dy ortake te tjere | 12.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Referuar e-mailit tuaj, per largimin e likuidatorit te shoqerise duhet te depozitohet vendimi i asambles se shoqerise i cili largon likuidatorin aktual dhe emeron likuidatorin e ri. | Perfunduar | Nuk ka |
| 270 | 12.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Do të doja të dija nëse është e mundur që detyrimet e firmës të pezullohen ose në pamundësi të pezullimit të më informonit për hapat që duhet të bëjë për ta mbyllur fare këtë aktivitet | 12.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkengjitur po ju dergojme dokumentacionin e duhur per aplikim per cregjistrim biznesi, keto jane hapat qe ju duhet te ndiqni per te kryer cregjistrimin e biznesit tuaj.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 271 | 12.10.2017 | Shoqeria Dajti fn eshte drejtuar me shkrese dhe me email QKR-se , per pranim Bilanci viti 2016 pasi eshte dorezuar ne institucionin tuaj , por nuk eshte pranuar . Kerkohet te pranohet bilanci i viti 2016 pasi eshte dorezuar brenda afateve kohore , po keshtu dhe kerkesa e ankimit eshte bere brenda muajit gusht 2017 .<br><br>Lutemi te behet verifikimi dhe pranimi i bilancit dhe te njoftohet subjekti pasi nga gushti e deri me sot nuk kemi asnje pergjigje | 16.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Lidhur me emailin tuaj ju sqarojmë se, shkresës datë 25.08.2017, drejtuar QKB-së për subjektin "Dajti FN" me NUIS (NIPT) J81913003U , i është kthyer përgjigje me shkresën tonë Nr. 12595/1 Prot., datë 11.09.2017, ku citohet se, nga verifikimi i kryer për aplikimin e kryer online me cn-376198-07-17 për depozitimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, rezuton të jenë ngarkuar pasqyrat financiare të vitit 2016 për shoqërinë "Dajti FN" me NUIS (NIPT) J81913003U, por gabimisht aplikimi është refuzuar.<br><br>Për këtë arsye duhet të riaplikoni onlinë për të depozituar pasqyrat financiare të vitit 2016, pa penalitet. | Perfunduar | Nuk ka |
| 272 | 13.10.2017 | Pershendetje! kerkoj informacion per subjektin me NIPT L57506502G rreth aplikimit me CN-363107-07-2017, pasi me daten e mesiperme jam paraqitur per te mbyllur nipt-in dytesor dhe me kane bere aplikimin per crregjistrim. Ju lutem zgjidheni. | 16.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, lidhur me kërkesën tuaj, QKB i është drejtuar me shkresë organeve tatimore, një kopje të së cilës do ta gjeni bashkëlidhur. Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 273 | 13.10.2017 | Quhem Vasil Bilero nga Gjirokastra. Kisha nje bisnes te vogel ne Sarande, te cilin e kam mbyllur qe me 30.09.2015. Kam aplikuar per çregjistrim me 29.09.2015. Po J'u dergoj ne rruge elektronike Ankese-Kerkesen. Lutemi zbriteni. | 16.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, lidhur me kërkesën tuaj, QKB i është drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale Sarandë.(Shkresën do ta gjeni bashkëlidhur)<br><br>Jemi në pritje të përgjigjes nga organi tatimor. Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 274 | 16.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Doja te me ofronit ESTRAKTIN e shoqerise "MAJFIS COMPANY.sh.p.k' | 18.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur do te gjeni ekstraktin e kerkuar.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 275 | 16.10.2017 | Pershendetje!<br><br>Ne cilesine e juristes prane shoqerise KISS FM shpk, ju kerkojme te na perditesoni te dhenat e kesaj shoqerie ne sistemin tuaj online, pasi veprimi i fundit na figuron ne dt. 13 korrik 2017, nderkohe qe realisht veprimi i fundit eshte kryer me dt. 13 tetor 2017. | 18.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ju informoj se ne sistemin e QKB dhe faqen zyrtare www.qkb.gov.al ekstrakti historic eshte I perditesuar.<br><br>Lutemi te shkarkoni ekstraktin historic ne faqen tone te internetit.<br><br>Faleminderit! | perfunduar | Nuk ka |
| 276 | 16.10.2017 | Po bej regjistrimin ne e-albania dhe nuk vazdhon me thot qe duhesh te besh rifreskime ne qkb. Me thoni si te veproj. | 18.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lutemi te paraqiteni prane sporteleve te QKB per te bere perditesimin e te dhenave me ID e kartes se identitetit.<br><br>Faleminderit! | perfunduar | Nuk ka |
| 277 | 17.10.2017 | Pershendetje une jam Edlira Daka farmaciste dhe deri ne fund te shtatorit kam qene drejtuese teknike ne farmacine eurofarma Tirane jam tehequr si drejtuese teknike e saj dhe dua te aplikoj per drejtuese teknike ne nje farmaci te re qe po e hapim dhe kemi bere dhe regjistrimin ne qkr te lutem me dergoni informacion per dokumentat qe duhen per kete | 18.10.2017<br><br>Pershendetje Znj. Edlira,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin qe duhet te plotesoni per tu pajisur me licencen: Tregtimi me pakice i barnave( Farmaci).Ne lidhje me pyetje Tuaj, per pozicionin e drejtueses teknike, duhet te beni ndryshimet perkatese tek urdheri i Farmacistit, te pajiseni me certifikate te re , per farmacine e re qe do hapni dhe pas kesaj , duhet te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se , per te dorezuar dokumentat .Afati i vendimarrjes per tu | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | procedure. Faleminderit | pajisur me licencen : Tregtimi me pakice i barnave( Farmaci) , eshte 4 dite pune. | | |
| 278 | 17.09.2017 | Mund te me informoni cfare duhet per tu rregjistruar ne QKB pasi disponoj Liçens ne Projektim kategoria 8.a per Rilevimi Inxhinerike Kadastrale. gjithashtu dua te informohem rreth vleres fknanciare qe duhe te paguaj per kete sherbim? | 18.10.2017<br><br>Pagesa e regjistrimit eshte 100 leke te reja.<br><br>Nese doni te dini kush jane detyrimet tatimore qe duhet te paguani , drejtohuni ne zyrat e tatim-taksave.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 279 | 17.10.2017 | Pershendetje!<br>Emisioni Stop ne Rtv Klan kerkon informacion ne lidhje me znj. Bruketa Zoto me profesion psikologe a eshte e pajisur me Nipt per te ushtruar aktivitetin e saj ne hartimin e raporteve paikologjike qe perdoren ne gjykate. | 18.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj ardhur me e-mail më datë 16.10.2017, ju bëjmë me dije se Nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit si kriter i vetëm kërkimi rezulton se, shtetasi me emrin Bruketa Zoto, nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin tregtar. | perfunduar | Nuk ka |
| 280 | 17.10.2017 | Drejtor ju pershendes. Kam aplikuar te henen e shkuar si Drejtues teknik i nje laboratori diagnostik me person fizim Perparim Domi, por akoma nuk kemi marr pergjigje miratuese. Falemnderit | 18.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Aplikimi Juaj eshte refuzuar. Bashkelidhur po ju dergojme arsyet e refuzimit.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 281 | 18.10.2017 | Pershendetje, Jam e interesuar ne lidhje me kerkesen time per cregjistrimin e subjektit, person fizik, Sofije Topuzi, me Nipt L22705203H. Ju lutem me informoni se ne cilen faze ndodhet duke qene se kane kaluar me shume se 30 dite nga data e aplikimit. Ju faleminderit. | 23.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti Sofije Topuzi (person fizik) me NUIS (NIPT) L22705203H është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 282 | 18.10.2017 | Kemi paraqitur aplikimet per regjistrim fillestar qe ne date 12.10. 2017. Ceshtjet nr CN- 514804 dhe CN- 512639 rezultojne te pezulluara si te paplota por nuk ka asnje aresye te shprehur, ndersa ceshtja nr. CN-512513 rezulton e pezulluar pasi imazhi nuk eshte I qarte. | 23.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, të tre aplikimet e përmendura në e-mail, janë miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 283 | 18.10.2017 | Luteni te na informoni me kerkesen per crregjistrim per Subjekin Vjosa BSK Shpk pasi kemi bere kerkesen ne dt 01.08.2017 dhe nuk kemi asnje pergjijge zyrtare. Faleminderit | 23.10.2017<br><br>Përshëndetje,Aplikimi për çregjistrim me numer CN-414121-08-17, i kryer për shoqërinë VJOSA BSK sh.p.k. me NUIS (NIPT) K81623502P është refuzuar pasi, QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, në bazë e për zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45/4. Sipas shkresës nr. 16111 Prot, date 12.09.2017, ardhur nga Bashkia Durres, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 102180 lekë | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 284 | 20.10.2017 | Te nderuar Zonja dhe Zotërinj,<br><br>Ne javet e ardhshme ne do ta hapim nje kompani ne Shqiperi "Autopjesëpartner Sh.p.k"me veprimtarin Importi i pjesëve të këmbimit, Vajrave dhe Baterive nga Evropa dhe shitje e tyre në tregun e Shqipëris. (jo naftë jo gas)<br><br>Ju lutem a keni mundesi te na jepni informacione:<br><br>A kerkohet Licenca per import te vajrave dhe sa eshte kostoja e saj per kompanin si Sh.p.k, dhe per sa vite leshohet.<br><br>Si dhe per Importin e baterive te veturave a kerkohet Licenc Importi. | 23.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nga informacioni që ju kërkoni, Qendra Kombëtare e Biznesit nuk përfshin asnjë licencë për import të vajrave apo për importin e baterive të veturave. Lidhur me veprimtaritë që licencohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit ju mund ta aksesoni lirisht në faqen tonë zyrtare të internetit www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 285 | 23.10.2017 | Pershendetje.<br><br>Lidhur me aplikimin me CN-521554 kerkoj qe te vijoje procedura e aplikimit sepse arsyeja e parashtruar nuk qenderon,zoteria ka nenshkruar perpara noterit dhe te tille e ka nenshkrimin.<br><br>Faleminderit | 25.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi i përmendur në e-mail është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryehet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 286 | 23.10.2017 | Duke ju falenderuar per bashkepunimin ju parashtroj kete kerkese.<br><br>Ne lidhje me Aplikimin CN- 523652 aplikues Torjanisa Cingo, per shkak te urgjences se Ortakut Themelues Roberto Poetto, (shtetas Italjan) nese do te ishte e mundur te perfundonim proceduren e regjistrimit sot. (ne rast se praktika ploteson kerkesat e ligjit). | 25.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se , aplikimi i përmendur në e-mail është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 287 | 24.10.2017 | pershendetje<br><br>Kur nje sh.a (aksionere) eshte e pezulluar ne QKR, a ka te drejte ne vazhdim te firmosi kontrata pelqimi? Ju flm | 25.10.2017<br><br>Përshëndetje, Referuar e-mailit tuaj,statusi i pezulluar i një shoqërie nuk përbën pengesë për lidhjen e kontratave të shoqërisë. Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |
| 288 | 25.10.2017 | pershendetje, para nje jave subjketi jorgji qeramixhi person fizik me niptL71323008B, ka bere aplikim per kalim nga statusi pasiv ne statusin aktiv. pas 24 oresh statusi eshte aktiv dhe sot ne faqen e QKB rezulton aktiv, por nga verifikimi jone tek tatimet statusi eshte akoma pasiv. pas nje komunikimi me zyren e tatimeve dhe me informacionin ne qkb na u kerkua te nisim nje mail ne kete adres me qellim qe IT e QKB te marri masat per sistemimin e kesaj situate. | 27.10.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga verifikimi ne Data Baze te QKB per Regjistrin Tregetar, kerkesa me CN-523397-10-17 eshte transmetuar drejte DPT sipas Monitorimit te Protokollit te Komunikimit.Pergjigja nga DIS QKR-se positive. | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 289 | 25.10.2017 | Pershendetje,<br><br>Jemi nje shoqeri ndertim dhe kontruksion dhe per zhvillimin e aktivitetit na eshte dashur pajisja me pompe nafte per furnizimin e makinave sepse behet furnizim ne sasi te konsiderueshme.<br><br>Ju lutem do te donim te dinim si mund te pajisemi me license,cilat jane kriteret dhe procedura qe ndiqet ne kete rast. | 27.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju sqarojmë se furnizimi me naftë në sasi të konsiderueshme nënkupton nga ju shitjen me shumicë të naftës. Në këtë rast për subjektin është e nevojshme të pajiset me licencën përkatëse dhe me leje mjedisore në varësi të kapacitetit.<br><br>Përsa i përket lejes mjedisore; duhet të bëni përcaktimet e nevojshme të kapaciteteve në mënyrë që nga ana jonë të dërgohet tabela e kritereve për lejen e duhur. Për më tepër informacion në lidhje me këtë çështje mund të paraqiteni pranë zyrës së informacionit.<br><br>Bashkëlidhur do të gjeni tabelën e kritereve të licencimit | Perfunduar | Nuk ka |
| 290 | 25.10.2017 | Jam fjolda lilaj, subjekti me niptin L51321509E<br><br>Ne baze te shkreses me nr 15781/1 prot e dates 05/10/2017 derguar nga ana e DR Tatimeve Durres, Ju eshte konfirmuar se detyrimet per subjektin tim jane Zero.<br><br>Nderkohe ne sistemin e kontrollit te statusit online te QKB dhe ne sportetlet e QKB rezulton se subjekti im eshte ende nee pritje cregjistrimi. | 27.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) L51321509E është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 291 | 26.10.2017 | Shoqeria SMARTЁORK Shpk, me (NUIS): L71928020R, me date 21.09.2017 ka vendosur me vendim te ortakut te vetem te shoqerise (Z. Andrea Ruscica) zmadhimin e kapitalit te shoqerise. QKB me date 04.10.2017 ka pezulluar per te dyten here te aplikimit te paraqitur per regjistrimin e vendimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, me numer ceshtje CN-490053-09-17, duke paraqitur si arsye nje baze ligjore qe nuk mund te zbatohet ne rastin ne fjale. | 27.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-490053-09-17, në subjektin "SMARTWORK"Shpk është miratuar me datë 25.10.2017. | Perfunduar | Nuk ka |
| 292 | 26.10.2017 | Pershendetje desha infomacion ne lidhje me nje zyre qe do te hap nje firm gjermane ketu ne shiperi zyr per kualifikim te puntorve me prefesjon hekur kthys dhe saltator si dhe rekrutimin e tyre brenda per brenda firmes me viz pune cfar hapash duhen cfar taksash ka per ket lloj biznesi cfar kushtesh duhen plotesur per te mar nje licenc te tille. | 27.10.2017<br><br>Për këtë lloji aktiviteti duhet të kryeni regjistrimin e subjektit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), nga ku do të pajiseni me një numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS/NIPT).<br><br>Pasi të jeni pajisur me një numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS/NIPT), ju duhet të aplikoni përsëri në (QKB) për tu pajisur me liçencë për kategoritë **X.2.A - Ndërmjetësim në tregun e punës (Agjensitë Private të Punësimit)** dhe/ose **X.2.B - Formim Profesional**.<br><br>Bashkëlidhur këtij e-maili po ju dërgojmë kriteret e liçencimit për secilën kategori. | Perfunduar | Nuk ka |
| 293 | 27.10.2017 | Pasi komunikuam me QKB Berat tani ne oren 12 me specialisten Irena Basko me thot qe i kam ndryshimet ne rregull ju lutem e provova perseri dhe nuk me njeh regjistrimin e biznesin ne e -albania. ju lutem shikoheni ku ngec lidhja e SIT tuaj me SIT ne e-albania qe me thot nuk je administrator. Kam komunikuar edhe me e-albanian dhe me thot eshte problem i qkb . si te | 27.10.2017<br><br>Pershendetje<br><br>Situata eshte rregulluar qe diten e djeshme ora: 13.06 | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | veproj . | | | |
| 294 | 31.10.2017 | pershendetje,<br><br>Jam administrator dhe ortak i vetem i nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (shpk).<br><br>Per arsye personale do te desha qe te kaloj shoqerine ne emrin e vajzes sime.<br><br>Meqenese vajza ime eshte ne Kanada, a mund te behet ky kalim dhe nese po, çfare dokumentesh nevojiten ? | 03.11.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se:<br><br>Në bazë të nenit 73, të ligjit 9901 për “ Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, datë : 14.04.2008, kuotat e kapitalit të një shpk-je e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;b) shitblerjes;c) trashëgimisë;ç) dhurimit;d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.<br><br>2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.Për të bërë të mundur, zëvëndësimin e ortakëve të shoqërisë duhet të depozitohet akti i kalimit të pronësisë sipas nenit 73 të sipërcituar.Akti i kalimit të pronësisë, duhet të paraqitet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, neni 162 e në vijim. | perfunduar | Nuk ka |
| 295 | 31.10.2017 | Pershendetje kemi aplikuar te premten nje shkres per heqjen e sekuestros te subjektit pali estate me nip-k74219408h kan ardhur e nga zyra permbarimore zig doja te dije a eshte hequ sekuestro.<br><br>PALI ESTATE sh.p.k, nipt; K74219408H | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se me aplikimin me numër CN-534518-10-17 datë 31/10/2017, për subjektin Pali Estate sh.p.k. me NUIS (NIPT) K74219408H figuron të jetë kryer depozitimi i Urdhrit Nr.3777-15 Regj, Nr.31866 Prot, datë 20.10.2017, "Urdhër për Heqjen e Sekuestros Konservative", lëshuar nga Shërbimi Përmbarimor FS, ku është urdhëruar: Lirimin e kuotave/aktiveve të debitorit "Pali Estate" shpk me NUIS (NIPT) K74219408H, të bllokuar me anë të shkresës Nr.18680 Prot, datë 21.04.2016, "Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative" të Shërbimit Përmbarimor FS. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik. | | |
| 296 | 31.10.2017 | Eshte bere e gjithe procedura per cregjistrim dhe nuk vjen cregjistrimi. CN=392355-07-2017 | 03.10.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Referuar emailit tuaj, ju bëjmë me dije se, aplikimi me numer CN-392355-07-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 297 | 01.11.2017 | Pershendetje<br><br>Riaplikuam perseri me dt 24.10.2017 me nr kerkese LC-4611-10-2017 dhe sot me date 30.10.2017 shohim ne sistem qe licenca eshte refuzuar. me arsytimin "Nuk janë paraqitur të gjithë dokumentet e tjera provues, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime a fshirje të pavërtetuara sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë apo është e palexueshme" ......Ne kemi riaplikuar me te njejtat dokumenta qe kishte dosja e pare pa asnje ndryshim Dosja qe e keni ju!!!!!!!! Aplikim i pare kaloj aplikimi i dyte ngec?.... | 03.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga biseda telefonike me perfaqesuesin Tuaj Z. Ardmir Doda , u sqaruan mangesite ne dokumentacionin e paraqitur nga subjekti " Qendra Sociale ne Ndihme te Njerezve ne nevoje Fushe Arrez." Subjekti do te paraqese dokumentacionin e plotesuar dhe do te aplikoje serish prane sporteleve te QKB-se.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 298 | 01.11.2017 | Pershendetje<br><br>Mund te me ndihmoni shoqerise i ka ardhur konfirmim zyrtar per miratimin e lejes se shfrytezimit dhe QKB eshte vene ne dijeni ne daten 25.10.2017 sa kohe kerkon dokumenti te hidhet qe te mund te printojme lejen e shfrytezimit ,nderkohe dhe pagesat jane kryer?<br><br>Bashkangjitur akt miratimi | 03.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Akti i miratimit eshte publikuar ne regjister sot ne daten 01.11.2017, ju lutem paraqituni prane sporteleve te QKB-se per terheqjen e titullit, se bashku me pagesat e garancive financiare(.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 299 | 01.11.2017 | Pershendetje<br><br>U vendosa ne djeni per aplikimin e realizuar ne daten 26.10.2017 se nuk eshte miratuar per arsye te paplotesisi ne mjetin e identifikimit te ortakut te shoqerise.Se pari ky problem nuk qendron pasi ne kemi depozituar gjithe aktet qe na ka kerkuar punonjesi I sportelit ,Akt themelimi, Satatut, bashkelidhur mjet identifikimiSe dyti Ky njoftim eshte bere jashte cdo afati ligjor.pasi aplikimi eshte bere ne dt26.10.2017 dhe vendimi eshte marre ne dt 30.10.2017 ne shkelje te cdo afati ligjor.Per keto arsye ju duhet ta aprovoni, bashkelidhur dhe njehere karta e identitetit te ortakut. | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi është miratuar. Verifikimin mund te kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 300 | 02.11.2017 | Lidhur me aplikimin me CN-537655 po iu bashkelidh prokuren e ortakut e cila eshte konsideruar nga ana juaj e paplote.Lutemi te vijohet me regjistrimin pasi dokumentacioni i paraqitur nga ne eshte i plote. Faleminderit | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-537655-10-17 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 301 | 02.11.2017 | Pershendetje,Jam nga Ambasada gjermane ne Tirane. Nga eproret e mi kerkohet qe te pakten cdo muaj te shoh regjistrimet e reja ne QKB te firmave gjermane, per te pare pastaj me mire fluksin e investimeve gjermane ne Shqiperi.A mund te behet kjo online? Dhe nqs. po, ku mund te kerkoj mbi keto te dhena? | 03.11.2017<br><br>Pershendetje, ne lidhje me kerkesen tuaj ju informojme qe te dhenat qe ju kerkoni perfshihen ne sherbime dyesore qe institucioni yne ofron, te cilat jane me pagese. Bashkengjitur po ju dergojme listen e sherbimeve dytesore se bashku me tarifat perkatese.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 302 | 02.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju kontaktojme nga Ambasada Hollandeze ne Tirane, zyra ekonomike dhe e tregtise. Kjo zyre eshte e interesuar te kete nje informacion mbi listen e perditesuar te bizneseve Holandeze dhe atyre Shqiptaro-Holandeze perkatesisht, te regjistruara ne Shqiperi (perfshire ndarjen e tyre ne aksione). | 03.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur gjeni subjekte aktive me pronesi Hollandeze (perfshire dhe ndarjen e tyre me aksione).<br><br>Per cdo paqartesi na kontaktoni.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 303 | 02.11.2017 | Pershendetje, jam student ne Fakultetin e Ekonomise dhe po ju kontaktoj pasi po zhvilloj nje studim lidhur me tregun e klinikave dentare dhe me duhet nje databaze te dhenash per te pare ecurine e numrit te bizneseve qe operojne ne kete fushe nder vite. Kete informacion nuk po mundem ta gjej tek faqja zyrtare QKR | 03.11.2017<br><br>Pershendetje, ne lidhje me kerkesen tuaj ju informojme qe te dhenat qe ju kerkoni perfshihen ne sherbime dyesore qe institucioni yne ofron, te cilat jane me pagese. Bashkengjitur po ju dergojme listen e sherbimeve dytesore se bashku me tarifat perkatese.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 304 | 02.11.2017 | Pershendetje! Kam bere nje aplikim per rritje kapitali per Grimer shpk me Nipt K23616201V. Aplikimi ka numrin e ceshtjes CN-523623-10-17. Aplikimi me eshte pezulluar me qellim saktesimin e raportit te Ekspertit Kontabel, pasi permban 2 data. 4/1. Po e shikoj dhe nuk po gjej dy data ne te. | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numer CN-523623-10-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 305 | 03.11.2017 | kam kryer aplikim me nr cn -533300-10-17 dhe nuk me eshte mirtuar akoma .Cila eshte arsyeja? | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëj me dije se, aplikimi me numër CN -533300-10-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 306 | 03.11.2017 | Pershendetje!<br><br>Firma Grori Konfeksion kerkon qe te behet heqja e sekustrave pasi ka sjelle dorazi leter -njoftimin nr 580-17 rregj 1677/21 dt 31/10/2017.Ju lutemi bejeni sa me shpejt zhbllokimin pasi jemi te paralizuar me punen . nuk po bejme dot veprimet ne dogane | 03.11.2017<br><br>Përshëndetje,Ju bëjmë me dije se, me aplikimin me numër CN-544431-11-17, datë 03/11/2017 figuron të jetë kryer depozitimi i urdhrit Nr. 1677/210580-17 Prot., datë 31.10.2017, lëshuar nga "Kodra Bailiff Service" sh.p.k, ku është urdhëruar: Heqja e sekuestros në kuotat/aksionet e debitorit GRORI KONFEKSION shpk me NUIS (NIPT) – L31602507P, si dhe mbi te drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave/aksioneve.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al duke gjeneruar ekstraktin historik të subjektit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 307 | 06.11.2017 | Pershendetje<br><br>Ju lutem a mund te kem nje pergjigjje persa I perket nje aplikimi qe kam bere dhe eshte plotesuar afati prej 30 ditesh qe te merrej nje shqyrtim. Eshte Aplikimi Cregjistrim personi fizik me CN-500612-10-17 dhe eshte bere qe me date 05.10.2017 sot eshte plotesuar afati. Amund te kem nje pergjigjje persa I perket pasi vazhdoj te jem ende te pritje | 06.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se aplikimi për çregjistrim me numër CN-500612-10-17 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 308 | 07.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Ekstrakti qkr per subjektet i shkarkuar me vule elektronike nga e-albania mund te perddoret per tu paraqitur ne nje tender?<br><br>Ju lutem me ktheni nje pergjigje sa me shpejt<br><br>Faleminderit, | 07.11.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju bëjmë me dije se:<br><br>Referuar nenit 5 të ligjit Nr. 10273, datë 29.04.2010 " Për Dokumentin Elektronik" *Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.* | Perfunduar | Nuk ka |
| 309 | 07.11.2017 | Pershendetje<br><br>Jemi nga Shoqeria Agri-Zoo Shpk me Nipt:K34004401E .<br><br>Ju lutemi te na zhbllokoni Qkb sepse | 07.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju bëjmë me dije se, për subjektin AGRI – ZOO sh.p.k. me NUIS (NIPT) K34004401E me aplikimin me numër CN-548252-11-17 , datë 07.11.2017 figuron të jetë kryer depozitimi i Shkresës Nr.7773 Prot, datë 05.05.2016, Kërkesë për aktivizim NIPT-i, lëshuar nga Dega Doganore Durrës, ku është | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | na keni bllokuar padrejtesisht qe prej dates 26.02.2016 leshuar nje vendim nga dega e Doganes Durres. me nr 3540. | kërkuar: Aktivizimi i subjektit "AGRI - ZOO", pajisur me NUIS (NIPT) K34004401E.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar Ekstraktin historik të subjektit. | | |
| 310 | 09.11.2017 | Per efekt te nje procesi gjyqesor, na rezulton i nevojshem nje informacion ne lidhje me Shoqerine "TRANS-CHANGE" ltd. Duke qene se kjo Shoqeri duhet te jete regjistruar perpara vitit 1995 prane Gjykates, nuk e di nese ne arkiven tuaj ka akte nga te cilat te mund te marrim informacion lidhur me statusin aktual te kesaj Shoqerie. Konkretisht kerkojme te dime nese vazhdon te kete ende personalitet juridik, apo eshte c'regjistruar nga regjistri tregtar, apo cfaredo lloj e dhene tjeter qe del ne sistemin tuaj per te. | 09.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim të kërkesës suaj, ju njoftojmë se për subjektin "TRANS-CHANGE" ltd nuk u gjet asnjë dokument apo informacion. Nga kontrolli që u bë nga ana jonë edhe në arkivin e gjykatës si për subjektin, si për Ferdinand Haxhiajn, sërish nuk u gjet asnjë dokument. | Perfunduar | Nuk ka |
| 311 | 10.11.2017 | Ndodhi një problem i paparashikuar.Mund të informoni administratorin e faqes për errorin e mëposhtëm. Ka ndodhur nje problem ...ju lutemi provoni me vone | 10.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lutem specifikimin e problematikes pasi vetem me email e derguar nuk eshte e qarte situata.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 312 | 13.11.2017 | Me falni per shqetesimin .Jam Liljana Hajdini dhe kam pas ushtruar aktivitet privat ne qytetin e Shijakut si Person Fizikme NIPT-L11320503Q.Kam aplikuar per Crregjistrim me CN-511555-10-17me date 11.10.2017.Per arsye shendetsore po dorezoj dokumentat per KEMP por me | 13.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-511555-10-17,i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) L11320503Q është miratuar dhe | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | kerkohet qe te jem e cregjistruar prane organeve tatimore. | subjekti ështrë çregjistruar.<br><br>Verifikmi mund të kryeht në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik të subjektit. | | |
| 313 | 13.11.2017 | Ju lutem kam kete pyetje: Personi i tatueshem me status juridik person fizik, a mund te bleje kuota tek nje person i tatueshem me status person juridik?<br><br>Rasti eshte: nje ortak person juridik shpk zoteron 75% te kuotave te nje tjeter personi juridik shpk. Ai deshiron t'i shese; a mund t'i bleje nje person fizik? | 13.11.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju informojmë se;<br><br>Një subjekt person fizik nuk mund të kryej transferim ose blerje kuotash te një person tjetër juridik. Blerja e kuotave kryhet nga personi individ jo nga subjekti person fizik. | perfunduar | Nuk ka |
| 314 | 13.11.2017 | Meqenese un kam qene pa aktivitet dhe kam kaluar pasiv nuk e kam pare te arsyeshme te rinovoj statusin.Ju bazoheni ne nenin 40 pika 2 dhe 3, te ligjit Nr.129/2014 per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.9901 date 14/04/2008 I cili (nenin 40 pika 2 dhe 3, te ligjit Nr.129/2014) eshte miratuar me date 2.10.2014 pra ne kohen ku ALBATROS Shpk ka pasur statusi e te qenit pasiv(ALBATROS ka kaluar pasiv me date 2.04.2014 | 13.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Lidhur, me ankesën tuaj, ju sqarojmë se, do t'ju kthehet përgjigje zyrtare me shkresë, pasi e njëjta ankesë është praqitur dhe protokolluar në QKB edhe me shkresë. | Perfunduar | Nuk ka |
| 315 | 14.11.2017 | Problematika e Shoqerise Albstar qendron se ne figurojme me dy numer Nipti ne sistemin e QKB prandaj kerkojme nga ana juaj crregjistrimin e ketij nipti NIPT K37209201G nga sistemi<br><br>Bashkengjitur eshte shkresa nga | 14.11.2017<br><br>Përshendetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se:<br><br>Në mënyrë që edhe QKB të kryejë çregjistrimin e NIPT-IT | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | tatimet Vlore e cila i kerkon Qendres Kombetare te Biznesit crregjistrimin nga sistemi. | K37209201G kërkojmë të na vini në dispozicion vërtetimin lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë e cila konfirmon çregjistrimin e subjektit në bazë të udhëzimit Nr.6, datë: 19.02.2010, "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin Nr. 24, datë: 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:<br><br>Faleminderit! | | |
| 316 | 14.11.2017 | Pershendetje! Jam interesuar prane deges se Tatimeve ne Shkoder per te marr nje vertetim se nuk kam aktivitet privat ne emrin Nikoll Pepa dhe ma kane refuzu me pretendimin se jane dy persona me te njejtin emer, nje ne Lezhe dhe nje ne Tirane qe kane aktivitet privat dhe per kete arsye nuk me japin dot vertetim. Kam kontrollu edhe vete ne sistem ne menyre qe t'ju shkarkoj ekstraktin por ka qene e pamundur. Dokumenti me duhet per te perfituar burse studimi dhe afati i fundit i dorezimit te tij eshte data 18.11.2017. Do ju lutesha qe te me jepnit nje zgjidhje sa me shpejt te jete e mundur. Pune te mbare. | 14.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të email-it tuaj, dërguar më datë 14.11.2017, lidhur me verifikimin nëse Nikoll Pepa rezulton subjekt tregtar, person fizik, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ju njoftojmë se: Nga verifikimet në regjistrin tregtar, rezultojnë dy subjekte tregtare, me NIPT-e të ndryshme, por me të njëjtin emër: Nikoll Pepa. Me qëllim, verifikimin dhe dhënien e një përgjigje të saktë, nëse personi (Nikoll Pepa) që ju i referoheni është ose jo i njëjtë me personin fizik Nikoll Pepa, që rezulton në regjistrin tregtar, ju lutemi të jepni ndonjë të dhënë më tepër, si psh: emri i atësisë, datëlindja, vendlindja etj | Perfunduar | Nuk ka |
| 317 | 14.11.2017 | prsh...kam aplikuar per mbyllje te niptin...kerkesa ka shkuar ke qkb para 2 muajsh....akoma skan kthyer 1 pergjigje....a mund ta di ca procedurash te ndjek...apo ca problemi ka.. me respekt arlind vani | 14.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, NUIS (NIPT-i) L51909026O është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik të subjektit.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 318 | 15.11.2017 | Pershendetje,<br>Kerkoj informacion per bankat ku mund te kryhet pagesa per sherbime dytesore. Ne banken Raiffeisen nuk e njihnin kodin qe keni te shkruar ne faturen e arketimit. Ju lutem, na informoni sa me shpejt si duhet te veprojme | 15.11.2017<br><br>Kerkojme ndjese. Per shkak te nje lapsusi ishte bere nje gabim ne kodin e Institucionit. Bashkelidhur do te gjeni "Faturen per Arketim" me kodin e Institucionit te sakte, pagesen e te ciles mund ta kryeni ne cdo banke.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 319 | 15.11.2017 | Kemi bere Aplikimin per shtyrjen e afatit te administratorit te shoqerise SOPI-shpk,por ndryshimi ne system nuk po behet.Nga kiontakti me punonjisin perkates na informon se nuk kemi derguar pasqyrat financiare te vitit 2016.Bashkangjitur po ju paraqesim vertetimin e juaj qe keto pasqyra jane dorezuar ne korrik 2016 .Ju lutem merrni masa te menjehereshme per cbllokimin e kesaj gjendje e cila ka ardhur per shkak te mangesiove tuaja | 15.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me aplikimin e refuzuar me numër CN-343464, të kryer më datë 22.06.2017 për depozitimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, për të cilin ju ankoheni, ju bëjmë me dije se mbështetur në nenet 21 e 61 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, çdo regjistrim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, i cili përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 21 të këtij ligji. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur nga data e publikimit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 320 | 15.11.2017 | Pershendetje,<br><br>lidhur me arsyet e paraqitura ne vendimin e pezullimit te aplikimit te cilin do ta gjeni bashkengjitur kemi nevoje per nje sqarim nga ana juaj | 15.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-546670-11-17, është miratuar pas plotësimit të të metave që pengonin regjistrimin.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 321 | 16.11.2017 | Pershendetje,<br>ju shkruaj nga kompania Gulf Group e cila eshte e specilizuar ne import eksport, per te bere aplikimin per licencen per "Shitjen me shumice e ushqimeve me origjine shtazore( per njerez)", ju lutem mund te me tregoni nese brenda listes se dokumenteve te kerkuara eshte e dosmosdoshme planimetria e ambjenteve te punes | 16.11.2017<br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju njoftojmë se planimetria e mjediseve të punës është e detyrueshme të paraqitet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Planimetria duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur nga arkitekt/inxhinier i liçensuar. Bashkëlidhur po iu dërgojmë listën e dokumentacionit për aplikimin në sportelet tona | Perfunduar | Nuk ka |
| 322 | 16.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Prane Qendres Kombetare te Biznesit eshte depozituar shkresa me numer protokolli 16024, date 15/11/2017 , ku kerkohen tre raporte statistikore per subjektet Call Center. | 16.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Bashkelidhur po ju dergojme informacionin e kerkuar.<br><br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |
| 323 | 17.11.2017 | Te Nderuar Zonja Zoterinj.<br><br>Ne jemi te interesuar lidhur me procedurat qe duhet te ndjeki shoqeria "ALBASPORT" SH.A me nipt J61904042Q e cila eshte me status "pezulluar", qe ne vitin 2009, per tu bere serisht me status aktiv si ne QKB dhe ne QRA. | 20.11.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj,<br><br>Ju bëjme me dije se, referuar nenit 20 të Ligjit 9723, datë 03.05.2007, regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.<br><br>Për sa më sipër, regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese që provojnë të dhënat që regjistrohen. | Perfunduar | Nuk ka |
| 324 | 17.11.2017 | Ju lutem te rishikohet kodi I objektit te aktivitetit ka nje mos perputhje pershkrimi I aktivitetit me objektin e komapanise .Ju lutem nje pergjigje sa me shpejte nga ana juaj brenda mundesive . | 20.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Lidhur me përditësimin e kodit ekonomik NVE referuar objektit te veprimtarisë së subjektit tregtar, duhet të paraqiteni për të | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Dite te mire . | aplikuar pranë çdo sporteli shërbimi të QKB.<br><br>Faleminderit | | |
| 325 | 17.11.2017 | Pershendetje! Ne kuader te saktesimit/perditesimit te adresave, jemi njoftuar ne dyert e biznesit tone per adresen e re. Si duhet te veproj prane QKB? Duhet te paraqes kerkese nga administratori per ndryshim selie? Faleminderit paraprakisht | 17.11.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj,<br><br>Ju bëjmë me dije se, referuar nenit 43 të Ligjit 9723, datë 03.05.2008, çdo subjekt , që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjister. Subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse për ndryshimin e selisë.<br><br>Për sa më siper, referuar nenit 81, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duhet të depozitoni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, që shprehet për ndryshimin e selisë.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |
| 326 | 17.11.2017 | Pershendetje .<br><br>Quhem Novrus MERIZAJ , dhe kam qene i rregjistruar ne QKB si person fizik me NIPT L67931801Q .<br><br>Do te doja te informohesha nga ana juaj lidhur me Aplikimin tim per Crregjistrim me CN-486259-09-17 , aplikim i kryer qe me dt.28.09.2017 | 17.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër cn-486259-09-17, i kryer për çregjistrimin e subjektit me NUIS (NIPT) L67931801Q është miratuar. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 327 | 20.11.2017 | Pershendetje!<br><br>Ne jemi **"Adriatex Shpk" NIPT J61821004R** me seli ne Tirane,nje kompani Italiane qe merret me tregtimin, riparimin, asistencen teknike dhe gjithcka ka te beje me industrine tekstile. **Adriatex Shpk**, kerkon prane institucionit tuaj mundesine e pajisjes me nje liste te te gjithe bizneseve qe operojne ne Shqiperi ne fushen e industrise tekstile e te tjere qe kane lidhje me fushen ***<u>TEKSTILEVE.</u>***<br><br>Jemi ne pritje te pergjigjes tuaj per nje liste me emra, adresa e kontakte si edhe me menyren si funksionon te pajisemi me nje liste te tille.<br><br>Pune te mbare. | 20.11.2017<br><br>Pershendetje<br><br>Bashkengjitur eshte lista e Subjekteve te kerkuar ne formatin exel.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 328 | 20.11.2017 | Pershendetje. Kam nje kopesht privat ne Durres dhe kam bere kerkesen per licensim per me shume se nji muaj dhe nuk kam marre asnje pergjigje. Kopshti quhet "28 Qershori". Ju lutem te na informoni per ndonje pergjigje. | 20.11.2017<br><br>Me qellim shqyrtimin e kerkeses Tuaj, ju lutem na jepni te dhena ne lidhje **Numrin e Aplikimit** ose numer **NIPTI** te subjektit qe ka aplikuar per tu pajisur me licence..<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 329 | 20.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Ne cfare faze eshte aplikimi im me Lc-4882-11-2017 | 20.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Aplikimi Juaj me numer LC-4882-11-2017, eshte ne statusin “Institucioni tjeter ne proces”. Afati i vendimarrjes per kete licence eshte 20 dite.<br><br>Duhet te prisni, deri ne marrjen e vendimit , brenda afateve ligjore.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 330 | 20.11.2017 | Pershendetje. Doja te merrja informacion rreth nje situate: Nje pjestar i familjes time eshte diplomuar per stomatologji dhe me licence. Do te hapi nje aktivitet ne durres dhe te ushtroj aktivitetin si dentiste. Pyetja eshte : Cfare lloj biznesi kategorizohet stomatologu edhe eshte e mundur qe te hapi dy klinika ky person? mund te hapi nje klinike ne durres dhe nje tjeter ne Tirane po themi | 20.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne lidhje me kerkesen Tuaj:<br><br>Se pari: Forma e biznesit qe ju doni te hapni, kabinet stomatologjik ose klinike stomatologjike( kur eshte me shume se nje poltron eshte klinike), mund te jete si person fizik, person juridik. Kjo varet nga ju , nuk ka kufizime per kete lloj veprimtarie.<br><br>Se dyti: Subjekti i regjistruar ne regjistrin tregtar, pra i apjisur me nje numer NUIS/NIPTI, duhet te aplikoje per tu pajisur me licence, perkatesish:<br><br>1. Kabinet stomatologjik( bashkelidhur dokumentat qe duhet te plotesoje subjekti)<br><br>2. Klinike stomatologjike(bashkelidhur dokumentat qe duhet te plotesoje subjekti)<br><br>Ligji dhe aktet nenligjore qe percaktojne kushtet e ushtrimit te aktivitetit te mesiperm, nuk e kufizojne nje subjekt qe te kete te | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | njejtin drejtues teknik , edhe tek kabineti edhe tek klinika stomatologjike.<br><br>Subjekti do te regjistroje ne regjistrin tregtar , te dyja adresat e vendit te ushtrimit te aktivitetit dhe do te pajiset me dy licenca.( nje per adresn e durresit ,te themi nje per ate ne tirane).<br><br>Per cdo paqartesi mos hezitoni te na kontaktoni.<br><br>Faleminderit | | |
| 331 | 20.11.2017 | Pershendetje ,<br><br>Doja tju pyesja per nje shoqeri qe eshte e pezulluar.Duam te bejme riaktivizimin e saj si dhe shitjen e kuotave te njerit nga ortakeve.Riaktivizimin dhe shitjen e kuotave mund ta bejme ne nje vendim ortaku? Apo ne fillim duhet te bejme riaktivizimin dhe pasi te behet miratimi i tij te bejme vendimin per shitjen e kuotave | 20.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bejme me dije se, referuar nenit 20 te ligjit 9723, date 03.05.2008, regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.<br><br>Per sa me siper, ju duhet te kryeni aplikim per aktivizim aktiviteti, te aktivitetit te pezulluar,duke depozituar prane Qendres Kombetare te Biznesit dokumentet bashkelidhur dhe pas miratimit te aplikimit per aktivizim aktiviteti, do kryeni aplikim per shitje kuotash.<br><br>Referuar nenit 27 te ligjit te sipercituar dokumentet shoqeruese duhet te dorezohen ne origjinal ose ne kopje te panjesuara me orgjinalin dhe te jene hartuar sipas formaliteteve te percaktuara nga legjislacioni perkates apo nga dispozitat e ketij ligji. Dorezimi i dokumentit shoqerues prane sporteleve te sherbimit ne kopje te panjesuara behet nen pergjegjesine e plote te personit qe e paraqet ate, i cili nepermjet aktit te dorezimit, konfirmon njesine e kopjes me origjinalin | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 332 | 21.11.2017 | Donim te dinim nese jane korigjuar te dhenat sipas kerkeses tone te meparshme! Pika 11.1 e ekstraktit ku eshte pasqyruar gabim emri i administratorit Anesti Nasi. (Te kufizimi i kompetencave). Duhet Gerta Djarmati. Eshte gabim material nga QKB! | 21.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për korrigjim i kryer për subjektin KISS FM shpk është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik | Perfunduar | Nuk ka |
| 333 | 22.11.2017 | Përshendetje, ju shkruajm nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Ne vijueshmeri të korespondencave shkresore ju bejm me dije se ju kemi kërkuar publikimin e Vendimit nr. 78, datë 28.06.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë e cila nder të tjera ka vendosur heqjen e mases se sekuestros per Shoqërine "Gjoka" sh.p.k me **Nipt K31310502F,**me seli në Sallmone, Komuna Xhafzotaj,Durrës së bashku me të gjitha asetet e saj. | 22.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>në vijim të korrenspondencës tonë, lidhur me saktësimin se ndaj cilit subjekt "Gjoka", drejtohet kërkesa për publikim i vendimit nr. 78, datë 28.06.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë për subjektin Gjoka sh.p.k, ju njoftojmë se:<br><br>Pas verifikimit të kryer, rezulton se publikimi në faqen www.qkr.gov.al, më datë 24.10.2017, i vendimit nr. 78, datë 28.06.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë për subjektin Gjoka sh.p.k me NUIS(NIPT) K31310502F, është bërë në përputhje të plotë me kërkesën tuaj.Ju faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 334 | 22.11.2017 | Prane Qendres Kombetare te Biznesit eshte depozituar kerkesa me Nr.<br>> 15843 Prot. Hyres, date 10/11/2017 e subjektit "DIAVA CONSULTING<br>> shpk". Lutem specifikimin e kerkeses tuaj, konkretisht objektin e<br>> veprimtarise si dhe periudhen kohore per te cilen kerkohen keto te<br>> dhena, pasi nuk mund te gjenerohen te gjithe te dhenat e kerkuara ne<br>> Regjistrit Tregtar, sipas listes se derguar. | 22.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me te dhenat e kerkuara, bashkelidhur eshte materiali i pergatitur ne nje file Excel, te ndare ne sheet-e te ndryshme sipas veprimtarise se kerkuar, mbi subjektet e regjistruara ne vitin 2016 ne total. Ne vijim mund te kryeni ndarjen perkatese ne nivel Bashkie, pasi po ju dergojme listen e subjekteve dhe jo te dhena statistikore te cilat jane kerkuar ne shkrese.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 335 | 22.11.2017 | Jam subjekti Eda Lleshi PF me NIPT L71509019V kam aplikuar per cregjistrim por mu refuzua nga Bashkia Tirane per vleren 200 leke .Me dt 24.10.2017 Bashkia jua ka sjell pergjigjen pasi une nuk kam detyrime .Kerkoj te me beni cregjistrimin .Faleminderit | 22.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije s,e subjekti me NUIS (NIPT) L71509019V është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 336 | 23.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Te dhenat qe kemi kerkuar jane ato te gjendjes ne vitin 2016, jo sa biznese jan regiistruat ne vitin 2016.<br><br>Pra sa eshte totali i bizneseve qe funksionojne ne vitin 2016.<br><br>Nese eshte e nevojshme ne bejme pagese tjeter per kete qellim, nese kerkesa jone nuk eshte kuptiar drejt | 23.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Referuar kerkeses qe ju keni bere dhe dhe pageses se kryer raporti I kerkuar eshte:<br><br>1 \| Raport mbi regjistrimet e reja të subjekteve në periudha të caktuara kohore;<br><br>Lista e sherbimeve qe ofrohet nga QKB nuk e permban sherbimin e kerkuar, nese deshironi te dhena te tjera, lutem saktesimin e kerkeses sipas listes bashkelidhur. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 337 | 24.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Me date 22.11.2017 prane sporteleve te QKB-se u be aplikimi per hapjen e nje shoqerie te re, me aksioner te huaj.<br><br>Ceshtja u refezua me date 23.11.2017 per shkak te emrit te ngjashem. ( Vlen te theksojme se emrin para perzgjedhjes u kontrollua ne sistemin tuaj dhe doli i lire)<br><br>Korrigjimi i emrit dhe riaplikimi eshte bere dje, dhe sot jemi ne pritje te nje pergjigje.<br><br>**CN 570607-11-17** | 24.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-570607-11-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 338 | 30.11.2017 | Pershendetjedua te bej rregjistrim online te biznesit po nuk po mundem te logohem . Lutem suportin tuaj | 30.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Per support te kredencialeve lutem dergoni email pran login@e-albania.al<br><br>Ju faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 339 | 30.11.2017 | Ju lutem me ndihmoni me nje info rreth procedures se themelimit te nje sh.p.k. Akti i themelimit dhe statutit a mund te firmoset nga personat e autorizuar nga ata qe do te jene ortake te sh.p.k? Nese po autorizimi duhet te jete i legalizuar? | 30.11.2017<br><br>Pershendetje, ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, ne mbeshtetje te nenit 28, te Ligjit 9723, date 03.05.2007, "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, shoqerite tregtare regjistrohen ne regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin per regjistrim fillestar, te plotesuar me te gjitha te dhenat e detyrueshme qe ka ligji, statutin e aktin e themelimit, ne rast se jane hartuar si dy dokumente te vecanta.Per sa me siper, ju sqarojme se, ortaket e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, mund te autorizojne persona te tjere per te firmosur aktin e themelimit ose statutin, autorizimi/prokura duhet e noterizuar sipas formes se | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | percaktuar ne nenin 72 , te Kodit Civil.Ne rast se autorizimi/prokura eshte hartuar jashte territorit te Republikes se shqiperise, duhet te jete e noterizuar dhe e legalizuar. | | |
| 340 | 30.11.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju shkruajme nga Expocity Albania, e cila eshte nje kompani qe operon ne fushen e Panaireve dhe Eventeve.<br><br>Nje nga Panairet qe ne zhvillojme eshte dhe Food & Drink Festival I cili perfshine te gjitha subjektet qe prodhojnë, përpunojnë,<br><br>eksportojnë dhe importojnë produkte ushqimore.<br><br>Per kete arsye jemi te interesuar te kemi nje liste te ketyre subjekteve te cilat jane themeluar/regjistruar 2 vitet e fundit (2016-2017) ne institucionin tuaj.<br><br>Ju lutem, nese eshte e mundur na informoni se si te veprojme per ta pasur kete database. | 30.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 341 | 30.11.2017 | Me duhet informacion per firmat emrat ose nr kontakti , qe merren me import export fruta perime ne te gjithe shqiperine.<br>Faleminderit. Pune te mbare | 30.11.2017<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit nr. në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB pagesa përkatëse., tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet | Perfunduar | Nuk ka |
| 342 | 30.11.2017 | Ju lutem mund te na ndihmoni me emrat e operatoreve qe merren me tregtim detergjent(materiale te ndryshme pastrimi) | 30.11.2017<br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit nr. në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB pagesa përkatëse., tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 343 | 30.11.2017 | Pershendetje,deshem nje informacion per gjobat qe duhet te paguajme ne lidhje me depozitimin e Bilanceve per vitet 2013 dhe 2014,per kompanine Balcan Investment Company.Ku merret fatura dhe ku paguhen gjobat,si procedohet me pas per Depozitimin e ketyre bilanceve ,pasi ky subjekt per momentin eshte i pezulluar?Duhet hartuar me pas nje vendim ? | 30.11.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, per depozitimin e pasqyrave financiare te viteve 2013, 2014 ju duhet te kryeni nje aplikim prane sporteleve te sherbimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Regjistrimi i pasqyrave financiare kryhet me dorezimin e aplikimit, te cilit i bashkengjiten dokumentet perkatese, konkretisht ju duhet te depozitoni pasqyrat financiare dhe vendimin e Asamblese se Pergjithshme i cili duhet te shprehet per miratimin e pasqyrave financiare.<br><br>Per sa me siper ju sqarojme se, depozitimin e pasqyrave financiare e kryeni me aplikim, prane sporteleve te Qendres Kombetare te Biznesit, gjithashtu prane Qendres Kombetare te Biznesit merni faturen e gjobes per mosdorzim bilanci brenda aftatit te parashikuar ne ligj, pagesen e se ciles e kryeni prane nje banke te nivelit te dyte. | Perfunduar | Nuk ka |
| 344 | 30.11.2017 | Shoqeria R&S Nova sh.p.k., ka bere kerkese per mbyllje te aktivitetit qe me date 05.10.2016, por edhe pse ka dorezuar te gjithe dokumentacionin e nevojshem dhe jane bere te gjitha verifikimet inspektuese nuk ka mundur te marre certfikaten e mbylljes se aktivitetit. | 30.11.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të email-it tuaj, ju bëjmë me dije se shoqëria "R&S NOVA", me NUIS(NIPT) L41421010D, u çregjistrua, pasi me shkresën nr. 214333/1, date 27.11.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë u konfirmua se ky subjekt nuk ka detyrime të papaguara.<br><br>Ju faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 345 | 01.12.2017 | Pershendetje, desha te di se si duhet te veproj per te bere rinovimin e nje certifikate regjistrimi? A mund ta bej nje person tjeter ne vend te personit fizik? Cfare dokumentash duhet te sjellim? Ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj Faleminderit Dorina Omeri | 01.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, bazuar ne ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, nuk parashikohet termi "rinovim çertifikate".<br><br>Lutemi, te saktesoni veprmin qe do te kryeni prane Qendres Kombetare te Biznesit, me qellim shqyrtimin sa me te sakte te kerkeses tuaj.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |
| 346 | 04.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Doja te dija per kompanin Spartaku se nuk me del ne sistem si ka mundesi? | 04.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Nga kontrolli ne website-in e QKB, bashkelidhur eshte pamja qe shfaqet. Lutem kerkoni perseri me emrin e subjektit ne linkun http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/, sic dhe eshte kerkuar ne email e derguar nga ju | Perfunduar | Nuk ka |
| 347 | 04.12.2017 | Ju lutem mund te me jepni nje shpjegim ne lidhje me ceshtjen e aplikimit numer :CN-430087-08-17 faleminderit | 04.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije aplikmi me numër CN-430087-08-17 është refuzuar, bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 348 | 05.12.2017 | Po ju veme ne dijeni per nj refuzim aplikimi qe na eshte bere nga ana juaj ,me nr cn-569086-11-17,ne date 22/11/2017.<br><br>Arsyeja e ketij refuzimi nga ana juaj eshte sepse nuk kemi bere lajmerimin e dyte ,por situata eshte krejt ndryshe sepse ne i kemi bere te dy lajmerimet nepermjet postes.<br><br>Lajmerimi i pare eshte bere ne daten 09/05/2017 nepermjet postes.<br><br>Lajmerimi i dyte eshte bere ne daten 21/08/2017 perseri nepermjet postes. | 05.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nga verifikimi i kryer rezultoi se për shoqërinë ART&HOUSE GROUP sh.p.k., me NUIS (NIPT) L51417013I në faqen zyrtare të QKB-së: www.qkb.gov.al, tek seksioni: Shpallje, nënseksioni: Njoftime për kreditorët figuron të jenë publikuar Njoftimi i pare për kreditoret datë 03.05.2017, protokolluar nga QKB me Nr. 6910 Prot., datë 10.05.2017 si dhe Njoftimi i dytë për kreditorët datë 15.08.2017, protokolluar nga QKB me Nr. 12407 Prot., datë 22.08.2017.<br><br>Përsa më sipër aplikimi për çregjistrim nuk duhej pezulluar por do të procesohet konform ligjit. Jemi në pritje të përgjigjes për detyrimet nga organet tatimore. | Perfunduar | Nuk ka |
| 349 | 05.12.2017 | Pershendetje, Kam nevoje per nje informacion ju lutem. Çfare procedure duhet te ndjekim ne rastin kur per nje shpk ndryshohet adresa e dhene ne momentin e themelimit? | 05.12.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj,<br><br>Ju bëjmë me dije se, referuar nenit 43 të Ligjit 9723, datë 03.05.2007, “Per Regjistrimin e Biznesit”, ndryshuar, çdo subjekt , që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjister. Subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse për ndryshimin e selisë.<br><br>Për sa më siper, referuar nenit 81, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, duhet të depozitoni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, që shprehet për ndryshimin e selisë.<br><br>Faleminderit! | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 350 | 05.12.2017 | Ju lutem verifikoni pse nuk eshte aprovuar ceshtja CN-422001-08-17, likuidim shoqerie e aplikuar qe ne daten 8 gusht 2017.Faleminderit | 05.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se aplikimi për çregjistrim me numër CN-422001-08-17 është miratuar dhe aktualisht subjekti figuron me status: Çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet ne faqen zyrtare: www.qkb.gov.al duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 351 | 06.12.2017 | Pershendetje ,<br><br>Per tendera mund te perdoren keto ekstraktet e nxjerra nda portali e-albania? | 06.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në pergjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si vijon:<br><br>Në mbështetje të nenit 5 të ligjit 10273, datë 29.04.2010, "Për Dokumentin Elektronik", Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 te këtij ligji.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 352 | 06.12.2017 | Pershendetje, une kam pas hapur nje dyqan me rimbushje dhe pas nje muaji une e mbylla sepse nuk kishte pune, e mbylla dhe atje tek tatimet por me erdhi nje flete nga sigurimet shoqerore thoshte qe duhet te paguaj 137.000 mij lek te vjetra une si kam paguar sepse nuk kam qene ketu ka 7 muaj nuk e di nese me vjen me gjob apo do paguaj vetem kete shifer? Ju faleminderit | 06.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju sqarojmë si vijon:<br><br>Referuar pyetjes tuaj, përsa i përket detyrimeve që ju keni ndaj Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve ju bëjmë me dije se, Qendra Kombëtare e Biznesit nuk merret me përllogaritjen e detyrimeve të subjekteve tregtare, lutemi të drejtoheni pranë organeve tatimore, me qëllim informimin tuaj sa më saktë.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 353 | 07.12.2017 | Aplikimi per c'rregjistrim e shoqerise Albaniasped shpk qe prej dates 07.11.2017. Statusi i Aplikimit eshte ende Ç'rregjistrim ne pritje DPT, nderkohe qe tatimet duhet te kishin kthyer nje pergjigje zyrtare tek ju, qe shoqeria nuk ka me detyrime, Ju lutem verifikojeni | 07.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nga verifikimi i kryer rezulton se, shoqëria Albaniasped shpk ka aplikuar për çregjistrim më datë 07.11.2017. Nga organet tatimore DRT/ bashki nuk rezulton të jete kthyer ende përgjigje lidhur me detyrimet tatimore të subjektit.<br><br>Qkb do të ndjekë procedurat ligjore lidhur me aplikimin për çregjistrim.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 354 | 07.12.2017 | Ju kontaktojme nga zyra e konsulences se subjektit Viçenzo Koçori P.F., subjekt tregtar ne QKB me Nr. Nuis L71827011K. Nga ana e ketij subjekti, ne daten 16.10.2017, eshte paraqitur nje Kerkese per Çregjistrim, ashtu siç rezulton dhe ne sistemin e Qendres Kombetare te Biznesit, me aplikimin me CN -517367-10-17. Ju lutem kryeni cregjistrimin. | 07.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim me numër CN -517367-10-17 është miratuar dhe subjekti figuron me status çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 355 | 11.12.2017 | Pershendetje! Kam pas nje biznes ne emrin Edmond Vako te cilin e kam mbyllur rreth 1 vit e gjysem me pare. Sot me njoftuan qe ky biznes qendron aktiv. Mund te me jepni nje informacion ju lutem! | 11.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se, nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezulton se subjekti me NUIS (NIPT) L62505202U, figuron me status i çregjistruar, konkretisht më datë 18.05.2016.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 356 | 11.12.2017 | Meqenese merem me prokurimet me lind nevoja qe te futem ne faqen zyrtare te QKB per te verifikuar Subjekte te ndryshme a jane aktiv apo jo.Ju lutem te me jepni nje sqarim kur, pershembull kerkimi per Subjektin X del me shkronja te kuqe(Ju lutem paraqituni prane zyrave te QKB per te plotesuar te dhenat e subjektit).Cfare nenkupton kjo?Subjekti nuk eshte aktiv?Apo duhet te paraqitet per dicka tjeter?Flm | 11.12.2017<br><br>Pershendetje,Nese gjate kerkimit te nje NIPT te nje subjekti te caktuar ju del nje tekst me ngjyre te kuqe do te thote qe te dhenat e atij subjekti duhen perditesuar. Pra vete subjekti duhet te paraqitet prane sporteleve te QKB-se qe ti perditesohen te dhenat e tij.<br>Faleminderit, | perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 357 | 11.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Sigal Uniqa Group Austria ne kuader te rrijtes se cilesise se sherbimit ndaj klienteve te saj , kerkon qe nga ana juaj te mare ne menyre periodike rregjistrin e perditesuar te bizneseve te rregjistruara dhe te c'regjistruara. | 11.12.2017<br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit nr. në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB pagesa përkatëse., tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet | Perfunduar | Nuk ka |
| 358 | 12.12.2017 | Pershendetje , Ju lutem mund te na ndihmoni me nje informacion.Ku mund te shkarkojme nje liste te bizneseve te regjistruara ne QKB qofshin keto akive apo pasiv,A egziston nje opsion ku mund te shkarkojme vazhdimisht listen e subjekteve normalisht me cdo ndryshim deri ne ate moment Faleminderit | 12.12.2017<br>Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit nr. në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.<br><br>Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individi/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave.<br><br>Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).<br>Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB pagesa përkatëse., tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 359 | 13.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Dhurimi ose shitja e kuotave te kapitalit nga nje ortak a eshte e domosdoshme te behet prane nje noteri? | 13.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br><br>Në mbështetje të nenit 20 të ligjit 129/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008”, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronesisë mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotes hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.<br><br>Për sa më sipër ju bëjmë me dije se, noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës për shitjen apo dhurimin e kuotave. | Perfunduar | Nuk ka |
| 360 | 13.12.2017 | Une subjekti Skerdi Mertika, NIPT L62413017A kam bere kerkesen e pare per Crregjisrim e cila me eshte refuzuar.<br><br>Pasi bera shlyerjen e detyrimeve ne tatime dhe ne Bashki dhe rezultoj me zero detyrime me duhet te largohesha jashte Shqiperise. Por me duhet te crregjsitroj kasen fiskale ne tatime. Kasa crregjistrohet vetem kur une crregjistrohem ne QKB. | 13.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) L62413017A është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 361 | 13.12.2017 | Quhem Romeo Cakshiri nga Durresi.Kam bere kerkese per crregjistrim me dt.02.11.2017.Shkoj e pyes te QKB Durres dhe me thone shko interesohu ne tirane.Ju lutem pres pergjigje | 13.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT)K91901501A është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | perfunduar | Nuk ka |
| 362 | 13.12.2017 | Të nderuar, Hetuesi nga Policia e Kosoves, kërkon që për nevoja te hetimit sipas autorizimit te Prokuroris Themelore ne Ferizaj PPN/II.768-7/2017 , të dhëna per Subjektin Ekonomik "CCHBC" me NIPT "K 71628019A". Nëse është e mundur te na dërgoni Ekstraktin nga QKR-ja per subjektin e lartcekur dhe dokumentacionet përcjellese qe kane sherbyer per hapjen e keti subjekti ekonomik. | 13.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju bëjmë me dije se, kërkimi i subjekteve tregtare në regjistrin tregtar , bëhet duke u mbështetur në kriteret e mëposhtme:<br><br>NUIS (NIPT)- Numri unik i identifikimit të subjektit;<br><br>Emri i Subjektit tregtar;<br><br>Numri i vendimit të regjistrimit të subjekteve në gjykatë (nëse ka të tillë);<br><br>Të dhënat (emër, mbiemër, atësi) i administratorit/ ortakut/ aksionerit aktual të shoqërisë.<br><br>Nga verifikimi i kryer mbi bazën e të dhënave të vëna në dispozicion rezulton se NUIS (NIPT-i) K71628019A nuk ekziston në regjistrin tregtar, si dhe nuk figuron i regjistruar ndonjë subjekt me emrin "CCHBC". | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 363 | 14.12.2017 | Me shkresen Tone nr. 1061 prot, date 05.12.2017 kemi kerkuar ndryshimin e emrit te administratorit per ish kampin e puntoreve "Santa Quaranta Premium Resort" sipas percaktimeve te vebndimit nr. 28, date 21.11.2017 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda.<br><br>Per sa me siper lutemi merni masat per ekzekutimin e vendimit te gjykates me qellim vazhdimin e administrimit te ketij resorti | 14.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje te e-mailit tuaj ju bëjme me dije se QKB i ka kthyer përgjigje shkresës suaj me lëndë : 'Kërkesë për Ndryshimin e Administratorit', në mënyrë që ë vijojmë me ndryshimin e administratorit na vini në dispozicion të dhënat e NUIS (NIPT-it) në të cilin duhet të bëhet ndryshimi i administratorit.<br><br>Ditë të mbarë ! | perfunduar | Nuk ka |
| 364 | 14.12.2017 | pershendetje<br><br>te lutem , cfare dokumentesh duhen qe mjeti i kompanise te pajiset me NIPT sekondar | 14.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon:<br><br>Per tu pajisur me NIPT dytesor, duhet te depozitoni prane Qendres Kombetare te Biznesit **kerkese nga administratori ose vendim te Asamblese se Ortakeve**, te cilat duhet te shprehen per hapjen e Niptit dytesor.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 365 | 15.12.2017 | Pershendetje! Kam aplikuar per nje ndryshim ne objektin e veprimtarise se shoqerise D&J shpk me nipt L41825004O; nr i aplikimit CN-586747-12-17 ne daten 11-12-2017 dhe ende nuk eshte reflektuar ne ekstratin e kompanise. Ju lutem beni te mundur realizimin e aplikimit faleminderit | 15.12.2017<br><br>Përshëndetje,Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-586747-12-17 është miratuar.Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 366 | 15.12.2017 | Pershendetje<br><br>Jam subject i interesuar per te bere pezullimin e aktivitetit me date 31.12.2017.<br><br>Data I perkon nje dite te djele dhe sherbimi I QKR-se eshte I mbyllur.<br><br>A mund te aplikoje me date 29.12.2017 per pezullim nga data 31.12.2017 ? | 15.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se, mund te kryeni aplikim prane cdo sporteli sherbimi te QKB-se, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht vendit te ushtrimit te veprimtarise, vendbanimit apo selise se aplikantit. Data e miratimit te aplikimit qe ju do kryeni, percakton edhe nisjen e periudhes se pezullimit te aktivitetit qe ju do pezulloni.<br><br>Faleminderit. | perfunduar | Nuk ka |
| 367 | 15.12.2017 | Kam bere nje aplikim per Cregjistrim PF ne date 13.10.2017 me nr ceshtje CN-514343-10-17 dhe NIPT:K31517169F Subjekti: Enkeleda Fejzulla po nuk kam marre asnje pergjigje! | 15.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-514343-10-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 368 | 18.12.2017 | Pershendetje a mund te kryhet onlne procesi i perditesimit te te dhenave te biznesit me NID nese po si | 18.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me kerkesen e ngritur ju njoftojme qe perditesimi i te dhenave te nje subjekti kryhet vetem prane sporteleve te QKB-se.<br><br>Faleminderit, | Perfunduar | Nuk ka |
| 369 | 18.12.2017 | Pershendetje,kemi nevoje te na ndihmoni me pasqyrat financiare te nje biznesi,per dy vite te njepasnjeshme pasi na duhen per nje projekt,per t'u bere analizen financiare.Faleminderit! | 18.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lutemi qe informacionin e kerkuar mund ta siguroni nepermjet faqes zyrtare www.qkb.gov.al ne linkun:<br><br>http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/<br><br>Pasi te keni kerkuar me te dhenat e subjektit qe interesoheni, lutem shkarkoni ekstraktin historik dhe me pas mund te beni download per bilancet te link-u perkates.<br><br>Pune te mbare! | | |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 370 | 18.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Jam Floreta,Likujdatore e" Shoqerise ne Likujdim e Siper "ALBA-ITAL-METAL shpk me NIPT L21804057M.<br><br>Me date 03/10/2017 kam aplikuar prane sporteleve te QKB per Çrregjistrimin e shoqerise me nr.cestjes:CN-496063-10-17.Statusi i aplikimit edhe sot eshte:Çregjistrim ne Pritje DPT, me ktheni nje pergjigje. | 18.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-496063-10-17 është miratuar dhe subjekti aktualisht ka status: Çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 371 | 19.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Donim tju pyenim per nje shoqeri qe eshte pezull per momentin mund te bejme ne te njejtin vendim ortaku?:<br><br>1- riaktivizimin e shoqerise<br><br>2- shitjen e kuotave te nje aksioneri<br><br>3-ndryshimin e administratorit<br><br>4-ndryshimin e adreses se selise | 19.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br><br>Ju bëjmë me dije se, fillimisht duhet të kryhet aktivizimi i aktivitetit të pezulluar. Në mbështetje të nenit 54, vetëm pasi kryhet shqyrtimi i çështjes nga nënpunësi i autorizuar, pas verifikimit përkatës dhe pasi miratohet aplikimi i çështjes për aktivizim të aktivitetit , mund të bëhet një aplikim i dytë për shitjen e kuotave të një aksioneri, ndryshimin e administratorit dhe ndryshimin e selisë, te cilat mund të paraqiten në të njëjtin vendim të ortakëve të shoqërisë.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 372 | 19.12.2017 | Kemi aplikuar per cregjistrim me dt.02.11.2017 me CN-543413-11-17 dhe ende nuk kemi nje pergjigje per aplikimin edhe pse kan kaluar 45 dite nga data e aplikimit | 19.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-543413-11-17 është miratuar dhe subjekti aktualisht ka status: Çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryeht në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 373 | 19.12.2017 | Pershendetje, per ceshtjen me Nr Aplikimi CN-588820-12-17, ju bej me dije se vendimi per pezullimin e aplikimit nuk eshte i sakte. Autorizimi per veprimin e aplikantit eshte dorezuar i plotesuar me nenshkrimin e themeluesve te shoqerise dhe per nenshkrimin e tyre eshte bere nje noterizim (vertetim nenshkrimi)n nga noterja. Dokumenti eshte depozituar qe ne dokumentat fillestar per aplikim. Ju lutem rishikoni brenda mundesive dokumentin e paraqitur. Faleminderit, | 19.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-588820-12-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 374 | 19.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutemi gjeni bashkelidhur printscreen te marra gjate aplikimit per leje qe na ka derguar subjekti ne fjale.<br><br>Sic mund te vihet re fushat **Prefektura/Qarku Rrethi, Bashkia, Njesia Administrative** jane boshe, ndaj nuk mund te procedohet me tej aplikimin.<br><br>Lutemi te verifikohen edhe njehere te dhenat nga ana juaj. | 19.12.2017<br><br>Mbas verifikimit te problematikes dhe diskutimit, subjekti adresen kryesore qe ka ne regjistrin tregtar e ka ate qe I eshte vendosur nga gjykata dhe importuar nga tatimet, qe jo gjithmone ka qene mapimi apo plotesimi I fushave te sakta.<br><br>Per kete arsye subjekti duhet te saktesoje adresen e sakte, ne regjistrin tregtar ne menyre qe te pasqyrohet edhe ne webservice | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 375 | 20.12.2017 | Pershendetje<br><br>Kam depozituar nje Kontrate Shitje kuoatash per nje shoqeri ME NR CESHTJE CN-595249-12-17 se bashku me kontraten edhe dokumentacionin perkates ekstarkt, vendim asambleje , karta identiteti si dhe akt themelimi e statut i ndryshuar. Me vjen nje pergjigje kontrata nuk eshte e plote. Kjo kontrate eshte e plote dhe eshte depozituar vazhdimisht per shitjen e kuoatave per individe te tjere te ndryshem, per te cilen nuk ka pasur asnje problem asnjehere , Ju lutem mund te me thoni se cila eshte mungesa ne Kontrate? | 20.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj, ju sqarojmë si me poshte:<br><br>Aplikimi me numër CN-595249-12-17 është pezulluar me arsyen: *“Te depozitohet e plote kontrata e transferimit te kuotave”*<br><br>Pas verifikimit të kryer rezulton se, kontrata e shitjes se kuotave datë 14.12.2017 nuk permban elementet e kontrates se shitjes sipas Kodit Civil, konkretisht çmimin e shitjes.<br><br>Përsa më sipër duhet të ndreqni të metën që pengon regjistrimin në përputhje me nenin 56 të Ligjit 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 376 | 20.12.2017 | Pershendetje,<br>Ju lutem me informoni lidhurme subjektin Ermir Hyra me NPIT L62402052C, nese ka nje problem qe akoma nuk eshte cregjistruar sepse te gjitha afatet kane kaluar. | 20.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin Ermir Hyra me NPIT L62402052C është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 377 | 21.12.2017 | Pershendetje, Jam Majlinda , punonjese e Egi-k shpk me nipt K77424401L. Me duhen ekstrakt i thjeshte dhe historik nga QKB origjinale. Dua te di se dokumentacionin duhet ta marrim prane sporteleve tuaja apo online te e-albania? Faleminderit | 21.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të pyetjes tuaj ju bëjmë me dije se, bazuar në nenin 67 të ligjit 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, QKB-ja konfirmon të dhënat e regjistruara nga subjektet, sipas këtij ligji, nëpërmjet lëshimit të ekstakteve në format shkresor apo elektronik. Cdo person kundrejt pagesës së tarifës perkatëse, ka të drejtë të marrë pa pengesa, në format shkresor apo elektronik, sipas dëshirës, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo subjekti.<br><br>Referuar për sa më sipër, ju informojmë se, ekstraktet mund ti merrni sipas dëshirës tuaj në format shkresor apo elektronik, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.<br><br>Faleminderit. | Perfunduar | Nuk ka |
| 378 | 21.12.2017 | Me CN-033007-11-16 daten 14.11.2016 kam aplikuar ne QKR per ç`regjistrimin e shoqerise BERDICA Z3 SHPK, me NIPT K97229004J, gjithashtu kemi marre nga D.R.T-ja Shkoder edhe shkresen qe kjo e fundit ka derguar ne adrese te QKB-se me nr.843/19 prot dt.19.06.2017 sipas te ciles subjekti nuk eshte debitor dhe sipas ligjit mund te ç`regjistrohet. | 21.12.2017<br><br>Përshendetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti BERDICA Z3 SHPK, me NIPT K97229004J u çregjistrua.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 379 | 21.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju falenderoj per emailin,<br><br>Lutemi nga ana juaj te kryheni c' rregjistrimin e shoqerise Albaniasped shpk pasi ka kaluar afati ligjor per dergimin e pergjigjes nga ana e organeve tatimore | 21.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin Albaniasped sh.p.k. është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, duke gjeneruar ekstraktin historik.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 380 | 22.12.2017 | E/I Nderuar, Zonjë/Zotëri:<br><br>Ju lutem, me anë të këtij emaili, duam të informohemi lidhur me aplikimin që kemi bërë në portalin E-Albania për regjistrimin e personit fizik Endri Prespa me numër çështje CN-601378-12-17. | 22.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-601378-12-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 381 | 22.12.2017 | Do te doja te informohesha perse nuk eshte pasqyruar ende ne sistem veprimi i dates 20.12.2017 me CN-599815-12-17 kryer nga shoqeria Progress Trust Shpk me nipt L33013601O | 22.12.2017<br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-599815-12-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 382 | 26.12.2017 | Pershendetje,<br><br>Ju lutem a mund te me informoni nese nje *“I Vetepunesuar i vetem”* duhet te paraqitet prane zyrave tuaja ne rast se statusi i tij do te ndryshoje ne *“I Vetepunesuar me punemarres te tjere”*. Nese po, ju lutem a mund te me informoni per dokumentacion e nevojshem qe nevojitet per te kryer perditesimin e statusit. | 26.12.2017<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br><br>Kalimi i statusit nga i vetpunësuar i vetëm në i vetëpunësuar me punëmarrës kryhet fillimisht pranë organeve tatimore, pasi kryhet regjistrimi pranë organeve tatimore mund të kryeni regjistrimin edhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.<br><br>Dokumentacioni i nevojshëm për të kryer këtë kalim të statusit nga i vetpunësuar i vetëm në i vetpunësuar me punëmarrës, kryhet vetëm për personat fizik dhe nevojitet vetëm mjeti i identifikimit i personit fizik në emrin e të cilit është regjistruar biznesi. | Perfunduar | Nuk ka |
| 383 | 26.12.2017 | Te nderuar zoterinj,<br><br>Kam aplikuar me CN-596184-12-17, por ka kaluar reth 1 jave dhe ceshtja vazhdon te jete ne proces regjistrimi. | 26.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-596184-12-17 është miratuar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 384 | 26.12.2017 | Jam Lindita Çerkezi,<br><br>Kam bere aplikim per mbyllje nipti (K72411012T) dhe me thane te paraqitesha per pergjigje ne daten 03.12.17<br><br>Telefonova dhe me thane qe eshte akoma ne pritje | 26.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) K72411012T është refuzuar, bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit | Perfunduar | Nuk ka |
| 385 | 26.12.2017 | Pershendetje!<br><br>me date 30 tetor eshte bere nje kerkese per mbyllje biznesi me nr aplikimi CN-536971-10-17 per niptin K91913015A nga Ali Disha. nese eshte e mundur mund te na konfirmoni crregjistrimin e aktivitetit, ose nese ka ndonje problem te na thuhet qe edhe ne te marim masa per mbylljen e tij. | 26.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-536971-10-17 është miratuar dhe aktualisht subjekti figoron me status çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 386 | 27.12.2017 | Pershendetje<br><br>Subjektit Tomorr Balla me Nipt L41427503L i eshte kthyer proçedura pasi rezultonte me detyrime.<br><br>Bashkngjitur do te gjeni vertetimin ku rezulton se subjekti nuk ka asnje detyrim tatimor . | 27.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nisur nga emaili juaj ju sqarojmë se, lidhur me subjektin Tomorr Balla me NUIS (NIPT) L41427503L, QKB i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës me shkresën Nr.17622 Prot., datë 26.12.2017, duke kërkuar informacion lidhur me detyrimet tatimore të këtij subjekti, në mënyrë që QKB të procedojë me çregjistrimin e tij.<br><br>Jemi në pritje të përgjigjes. | perfunduar | Nuk ka |

## Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 387 | 28.12.2017 | Ju lutem donim nje informacion lidhur me afatet e dorezimit te dokumentave si dhe te aplikimit te gjobave respective prane QKB-se.<br><br>- Kontrate e shitjes se aksioneve<br>- Vendimet e aksionereve per shitjen e aksioneve<br>- Vendimet e kompanise se huaj per blerje te aksioneve. | 28.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj ju infomojmë si më poshtë vijon:<br><br>Në mbështetje të nenit 22, pikën 5 të ligjit 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për tu regjistruar.<br><br>Bazuar në nenin 74, të ligjit të sipërcituar moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.<br><br>Për sa më sipër ju bëjmë me dije se, afati për dorëzimin e kontratës së transferimit të aksionit dhe vendimin e ortakëve për transferimin e kuotave për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit është brenda 30 ditëve kalendarike nga data e hartimit të akteve. Në qoftë se regjistrimi i akteve nuk kryhet brenda afateve të parashikuara nga ligji i sipërcituar, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.<br><br>Nëse ju për të njëjtin dokumentacion që doni të depozitoni në regjistër keni paguar penalitetin përkatës në një aplikim të mëparshëm i cili mund të jetë refuzuar për disa arsye të tjera, ju mund ta përdorni gjobën në aplikimin tjetër me të njëjtin dokumentacion. | Perfunduar | Nuk ka |

# Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 389 | 28.12.2017 | Pershendetje! Jam interesuar prane deges se Tatimeve ne Shkoder per te marr nje vertetim se nuk kam aktivitet privat ne emrin Nikoll Pepa dhe ma kane refuzu me pretendimin se jane dy persona me te njejtin emer, nje ne Lezhe dhe nje ne Tirane qe kane aktivitet privat dhe per kete arsye nuk me japin dot vertetim. Kam kontrollu edhe vete ne sistem ne menyre qe t'ju shkarkoj ekstraktin por ka qene e pamundur. Dokumenti me duhet per te perfituar burse studimi dhe afati i fundit i dorezimit te tij eshte data 18.11.2017. Do ju lutesha qe te me jepnit nje zgjidhje sa me shpejt te jete e mundur. Pune te mbare | 28.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim të komunikimeve tona, ju bëjmë me dije se Qendra Kombëtare e Biznesit më datë 13.11.2017, ka dërguar një shkresë me nr. 15880 prot., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, Shkodër dhe Tiranë, ku kërkojmë informacion nëse rezulton ndonjë person fizik nën emrin e z.Nikoll Mark Pepa | Perfunduar | Nuk ka |
| 390 | 28.12.2017 | Subjekti Gazment Kajolli person fizik nipti L61813007D ka aplikuar prane jush per cregjistrim nderkohe ne sistemin tuaj statusi eshte aktiv.faleminderit | 28.12.2017<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) L61813007D është çregjistruar.<br><br>Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.<br><br>Faleminderit | Perfunduar | Nuk ka |
| 391 | 29.12.2017 | Pershendetje,Ne vijim te email per formularin e pageses per aplikimin e aprovuar te subjektit “Hipermarket G & N" Sali Lika Center me nr. LC-5000-11-2017 dhe duke ju referuar email tuaj qe na orjentoni ti drejtohemi MEF ne ju paqaresim dokumentin e bashkengjitur me nr 3302/1 prot dt 12.12.2017 qe na ka ardhur drejperdrejt nga Ministria e Finances qe na nenvizon qe ai formular duhet te na leshohet nga institucioni juaj. | 29.12.2017<br><br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me shqetësimin e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon:<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit me anë të shkresave zyrtare të dërguara Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka kërkuar pajisjen e subjekteve të interesuara me formularin e mandatpagesës për pajisjen me licencë “Arsim i mesëm profesional”, me kodin IX.1.A.6 si dhe dërgimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me vlerën përkatëse të tarifës së posaçme sektoriale dhe numrin e | Perfunduar | Nuk ka |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | llogarisë bankare të minsitrisë, në të cilën subjektet do të bëjnë pagesën e kësaj tarife.<br><br>Për sa më sipër, për pajisjen me formularin e mandatit të pagesës, lutemi ti drejtoheni organit vendimmarrës i cili në rastin konkret është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjithashtu Qendra Kombëtare e Biznesit do t'ju njoftojë sapo të kemi një përgjigje nga ky institucion. | | |